

Thomas Frashëri, autori i “Frashëri i shquar, i panjohur” dhe “Princa të Lilit, bij të Arbërit, familjarë të Sulltanit”, libër për të cilin u nderua edhe me çmimin “Lumo Skëndo”, bisedon me Andreas Dushin mbi historiografinë dhe çështje të tjera të lidhura me botën e shoqërinë shqiptare.

## THOMAS FRASHËRI:

### Mendoj se në Shqipëri kemi nevojë për një “revolucion të mendësive”



Suksese  
Panairit të librit  
shqip në Shkup  
4-7 qershor 2026

Lojë mahnitëse  
e një kuinteti  
hargesh në  
Tiranë  
Nga Dr. Eno Koço

#### SHËNIME MBI LIBRAT

Botimet Nikas, Athinë

Nikos Kacalidha, “Lumenjtë e pëllëmbës sime”

Nga Nikos Vlahakis (fq. 8)

Poezia e Ilirian Zhupës si përgjegjësi ndaj fjalës së zgjedhur artistike (fq. 12)

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

Ruzhdi Gole, begatia e poetit të heshtur

MSc. Albert Habazaj (fq. 13)

“Libri të ban të lirë” në Shkodër ku libri ka shtëpinë e vet

Nga Granit Zela (fq. 4)

Zhan Renuar, i biri i piktorit të famshëm impresionist, shkruan për babain e tij (fq. 20)

Pier Ogyst Renuar



### Gjeografia mitike dhe zhanret polivalente në opusin e Resul Shabanit

Nga Emin Azemi

Resul Shabani nuk i takon modelit tradicional të shkrimtarit që eksperimenton kalimthi në gjini të ndryshme. Sistemi i tij krijues dëshmon se kalimi nga një zhanër në tjetrin ka qenë një domosdoshmëri e vetëdijshme intelektuale. Siç e vërteton edhe trajektorja e tij (ku proza e shkurtër parapriu poezinë), ai përdori poezinë si shkarkim lirik e emocional, ndërsa prozën e gjatë dhe dramën si struktura të rrepta arkitektonike që kërkojnë pjekuri, kulturë të gjerë dhe fakte historike, duke refuzuar çdo lloj improvizimi. (fq. 10)

Historia e Dhespinës dhe djalit të Pashait të Janinës në një baladë të autorit rumun George Coșbuc

Nga Dr. Dorian Koçi (fq. 6)

Kristina Lugn, Shkrimtarja suedeze që u quajt shtrigë

Nga Shqiptar Oseku (fq. 18)

Zadie Smith: Të shkruash kur jashtë protestohet

The New Yorker (fq. 14)



#### BIBLIOTEKË

Klara Kodra (fq. 11)

*Samantës*

Anton Pappleka (fq. 16)

*Kuajt e verbër të fjalëve*

Kostandin Dhamo (fq. 17)

*Proteza e poetit*

Arben Meksi (fq. 15)

*Karikatura e së shtunës*

Gazmend Leka, revolucionari dhe universi i pashtershëm i ilustrimeve të “Tregime të moçme shqiptare”


Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)

Libri shqip në SHBA & KANADA

Dërgesa të shpejta dhe të sigurt

www.alblibris.al



# THOMAS FRASHËRI:

## Mendoj se në Shqipëri kemi nevojë për një “revolucion të mendësive”

Bisedoi: *Andreas Dushi*

**Herë pas here, kur flitet për historinë e popullit tonë, sillet në vëmendje një çështje e ndjeshme, ajo e familjeve kryesore gjatë mesjetës. Meqë akoma nuk është përvijuar saktësisht një qasje e tërëpranuar dhe nuk e di a e ka historia një të tillë, në fakt, ka raste kur ndaj tyre mbahet një qëndrim si ndaj disa feudalëve paraotomanë ose otomanë dhe raste të tjera kur ato shihen me respektin e një familjeve fisnike. Dy studimet tuaja, i kthejnë një përgjigje kësaj dileme?**

Për dashamirësit e historisë çështja ka mbetur e ndjeshme, sepse për dhjetëvjetësha ajo ka qenë një çështje e ndaluar. Çdo gjë e ndaluar grish dhe të bën kureshtar. Kur lejohet qasja në të, vendin e grishjes dhe kureshtjes e zë shpesh magjepsja, glorifikimi, por edhe zhgënjimi dhe karikatura. Familjet që, siç thoshte Ekrem bej Vlora, kishin “vetëdijen se ishin diçka më shumë se të tjerat”, i flasin publikut gati si në nënvetëdije, të lidhura siç janë me fenomenin e vullnetit për pushtet, me kuptimin e autoktonisë, krenarisë kombëtare, përpjekjes për të vërtetuar barazinë cilësore mes qytetërimit shqiptar dhe atij të vendeve të tjera të kontinentit. Por familjet e mëdha, parësia ose paria, nuk i përkasin vetëm imagjinatës. Ato kanë qenë për shekuj, me gjithë larminë e besimeve dhe krahinorizmat, një realitet dinamik, kokëfortë dhe i qëndrueshëm. Dora d’Istria e konsideronte Shqipërinë një “vend epërsisht aristokratik”, kurse Mid’hat Frashëri pohonte se “kështu e do tradita dhe vetia jonë: tekdo ka një parësi, do në myslimanët, do në të krishterët, se këto vlera i kemi pasur që mijë vjet, që kur i ka bërë perëndia shqiptarët”. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar parimi i moçëm kanunor se në Shqipëri asnjë familje nuk është më e nderuar se tjetra. Ky parim, i rrënjësuar në tiparet e arbërorit krenar, të bën të jesh i kujdesshëm kur vjen puna te ndarja me thikë e “parësisë” nga “vegjelia”. E vërteta është se “parësia” nevojitet, në rastin shqiptar, një arsenal përkufizimesh polisemike për t’i kapur një thelb gjithmonë ikanak. Prej rrethanave që na lidhin gjatë në histori, qysh para periudhës osmane, me Orientin e ndërlikuar dhe botën e tij po aq të ndërlikuar të elitave, familjet

e mëdha nuk kanë qenë te ne asnjëherë strukturalisht sovraane, asnjëherë plotësisht feudale, rrallëherë zotëruese titujsh të mirëfilltë fisnikërie. E kanë thënë të tjerë para meje se kategoritë e aristokracisë dhe fisnikërisë (*nobilitas*), që na e bëjnë me sy nga Perëndimi kur mendojmë për familjet e mëdha shqiptare, nuk janë natyrshëm të përkëmbeshme me realitetin tonë historik. Në këtë aspekt, parësitë shqiptare, të mpiksura në emra familjarë që kanë rrezatuar për këtë ose atë arsye, shfaqen më shumë si aristokraci-jashtë-sistemi (*aristocratie hors système*). Ndër emëruesit e përbashkët të dy studimet e mia është përpjekja për t’i tërhequr në hullinë e hulumtimit, përmes studimit

të shembujve konkretë, duke i shpëtuar ngasjes për soditje sipërfaqësore dhe për përgjithësime të sforcuara. Si pjesë e rëndësishme e antropologjisë së historisë, studimi i familjeve me ndikim dikton të kuptuarit e logjikave dhe kohezionit të brendshëm të një shtrese elitare, kameleone për shkak të historisë sonë dhe shndërrimeve identitare që në të kanë lënë dregëza, duke na dhënë një panoramë të pjesës më dinamike të shoqërisë shqiptare në periudhat e gjata të historisë. Vetëm në këtë mënyrë xhinset që kanë mishëruar parësitë, shpesh duke i trashëguar ato qoftë edhe përkundër së drejtës, shpërfaqen në dy dimensione historiografike domethënëse: si shtresa sunduese nga


njëra anë dhe si familje historike nga ana tjetër. Kështu, të qëruara nga ngarkesat emocionale dhe meritë politiko-klasore, nga ngutja për asgjësim ose nga ekstravaganca e glorifikimit, ato paraqiten të gatshme për diseksione shkencore dhe hulumtime të frytshme.

**Një bisedë për një studim historik është e vështirë pasi, duke u përpjekur të mos tregosh nga ajo çfarë ke lexuar, rrezikon ta nxisësh të intervistuarin të citojë veten në përgjigje.**

Studimi i historisë, për të qenë i dobishëm dhe pjellor, më ngjan se duhet të gjëllijë nga një formë mrekullimi filozofik. Është më interesante ta shohësh historinë si “shkenca e njeriut në kohë”, për ta thënë me fjalët e Bloch-it, sesa si një gjyq të përhershëm të ngjarjeve, të individëve, të opinioneve, përfshirë edhe ato të autorëve. Javier Cercas ka vënë theksin tek ajo që studimi historik, sado hetues, nuk mund të jetë një sëpatë xhelati. Vetëm duke ngjallur mrekullimin historia mund të bëhet një disiplinë tërheqëse, duke i vënë baras në bisedë intervistuesin dhe të intervistuarin, pa krijuar mes lexuesit dhe studiuesit një raport intelektual të hierarkizuar.

**Lexuesi i synuar, Thomas, kush është? Specialisti i historiografisë, entuziasti i historisë apo edhe dikush që ka një kureshtje dhe interes të singertë? Ju vetë, në cilin rrafsh gjuhësor besoni ta keni shkruar librin?**

Sapo ju thashë se historia duhet të ketë në bazë një mrekullim filozofik, një shkëndijë që vë në lëvizje qelizat gri dhe plotëson nevojat për njohje, duke çliruar nga paragjykime dhe opinione të kryera të mbyllura. Cilido që ia jep vetes mundësinë e kultivimit të këtyre elementeve mendoj se e gjen veten lehtësisht në librat që kam shkruar, sado të vështirë të duken ata në pamje të parë. Nuk e mohoj se duke shkruar mendoj gjithmonë për ata që do të vijnë më pas, të cilëve u duhet përgatitur terreni i hulumtimeve të mëtejshme, sidomos duke i nxitur të pasurojnë bagazhin e kulturës së përgjithshme. Unë shkruaj për këdo, sidoqoftë, por historia, e cila kërkon virtyt, përlësi dhe përkushtim



në të shkruar, nuk mbush shportat duke hedhur rrjetat; ajo peshkon me grep dhe me durim të madh.

### Si mendoni, familjet fisnike apo fisnikëria si tërësi vlerash, cila i ka paraprirë tjetrës?

Nga një pikëpamje materialiste, parësitë kanë lindur qysh me organizimet shoqërore fillestare. Më vonë, si tejçuese morali të caktuar ideologjik dhe shoqëror, ato janë legjitimuar, pra janë paraprirë, nga fisnikëria si tërësi vlerash. Si vlerë, fisnikëria është para së gjithash virtyti i qashtë si vullnet dhe forcë shtysë e veprimit të drejtë. Shkrimet e shenjta, për të përmendur vetëm ato, janë plot e përplot me narrativa virtyti që fisnikëron si hir i dhënë nga lart e që njeriu, përmes sakrificave vetëmohuese, duhet ta bëjë pjesë të zgjedhjes së tij të lirë. Kjo lloj fisnikërie, e cila është gjithmonë për t'u fituar individualisht dhe asnjëherë e dhënë njëherë e përgjithmonë, është teorikisht në antagonizëm me fisnikërinë e klasës e së sërës ku virtyti prezumohet nga trashëgimia e gjakut, e rangut ose e kamjes. Por, si çdo gjë te njeriu, virtyti i individit dhe fisnikëria e trashëguar nuk kanë mbetur pa u pleksur mes tyre, do si ideal, do si shembull i mishëruar në vijimësi. Makabejtë e periudhës së Hashmonaimëve u kthyen në familjen fisnike më shembullore, për shkak të virtytit të tyre që as vdekja e dhunshme nuk e lëkundti. Kalorësia europiane – *la chevalerie* – rrënja e fisnikërisë në Perëndim, justifikohet e tëra nga kërkimi i idealit të virtytit, vetëmohimit, shërbimit të interesit të përgjithshëm, mbrojtjes së vejjshës dhe jetimit e kështu me radhë. Në Shqipëri, asnjë *der'e madhe* gjatë periudhës osmane nuk do të ishte respektuar si e tillë nëse përveç përkundjes së udhëheqësve të ardhshëm nuk do të mbante të çelur portën ditë e natë për t'i dhënë strehë, ushqim dhe mbrojtje më anonim të ndër kalimtarëve dhe më të përlurur mes të vobektëve. E kur një pinjoll i fisnikërisë shqiptare rezultonte “dru i shtrembër”, duke shpërfillur barrën e *noblesse oblige*, nga më i madhi te më i vogli kishin të drejtë ta tregonin me gisht e ta quanin: “Blozë prej oxhaku”.

### Sot, kur përdoret mbiemri fisnik, çfarë nënkuptojmë dhe çfarë duhet të nënkuptojmë? Fjala, pra, mbart dy kuptime? Apo më shumë?

Fisnikëri në shqip ka të njëjtën ngarkesë semantike si fjala latine *nobilis* që vjen nga *noscere*, të njohësh, të dallosh, të shquash. “Është fis”, “është soj”, pra është i dëgjuar, i përmendur, i njohur. Në Shqipëri themi natyrshëm “emër i dëgjuar”. Kjo lidhet jo dhe aq me prejardhjet mitike ose të zbuluara të farefisëve, por me emblematizimin e gjurmëve të tyre në histori. Për t'u shquar nga masa, por edhe mbi masën, janë krijuar stemat heraldike; për të lënë trashëgimi historike janë shkruar me mbiemra familjesh ngjarje të mëdha, qoftë edhe me koston e jetës dhe me gjakun e derdhur. Hyrja në histori e bën një familje të mëtojë shquarsinë ose fisnikërinë. E për t'ia arritur kësaj



duhen sakrifica dhe përpjekje të vetëdijshme në tre ose më shumë breza. Sa për prejardhjen, gjakun dhe të tjera paterica gjenetike që fisnikërinë e bëjnë aq misterioze dhe tërheqëse, ju kujtoj shprehjen e një edukatoreje të shquar dhe jo më pak fisnike, markezës De Sévigné: “Të gjithë kemi qenë bujq, por jo të gjithë e kemi lënë arën në të njëjtën kohë; dikush e ka lënë në mëngjes, dikush pasdreke e një tjetër sish nga darka; ka madje plot të tjerë që janë aty ende.”

U bë tejet semantike biseda, ndaj të kalojmë pak te një tjetër çështje: Helena, gruaja e Stefan Uroshit, më tërheq shumë si personalitet. Ju e trajtoni në “Princa të Lilit...”, duke e vështruar në tërësi personalitetin e saj. Kam përshtypjen se një libër aq voluminoz, ku trajtohen një larushi ngjarjesh e personash, e ka të domosdoshme të nxjerrë në pah disa personalitete kyçe për lexuesin, si një lloj ftese ndjellëse... Mendoni se Helena mund ta nxisë këtë kureshtje?

Libri që përmendet është plot me personazhe mbresëlënëse. Mendoj se ata janë edhe një nga prurjet e tij më interesante. Ta sjellësh bisedën tek ta është ta vësh kursorin të rëndësia e prosopografisë si pasurim i vazhdueshëm i tablosë njerëzore të historisë. Për të ardhur te Helena e Serbisë, por edhe e Arbërisë, sepse e konsideronte privilegj shoqërimin e Arbërisë me emrin dhe titullaturën e saj, duhet thënë se, më shumë se me një personazh, ke të bësh me një fenomen. Helena nuk ishte serbe nga lindja. Ishte një europiane përpara se të kishte Europë. Shartim i gjakut të perandorëve bizantinë Engjëllorë dhe i perandorëve latinë Courtenay, lastarë të Shtëpisë së Francës, Helena është cilësuar me të drejtë nga Aurel Plasari si “çelësmbajtësja e Arbërisë”. Është e para dhe e vetmja sovranë që, ndonëse e huaj, realizoi një *oikoumené* ku mund të lulëzonte, pavarësisht

ndarjeve konfesionale, një fisnikëri e emancipuar multietnike në fasadën adriatike dhe në brendatokën e rajonit që sot quhet Ballkani Perëndimor. Helena, katolike romane dhe bamirëse e ortodoksisë njëkohësisht, ishte kumbara dhe mëndesha e lules së fisnikërisë arbërore në shekujt XIII-XIV. Ajo ishte gjithashtu kushërira dhe bashkëpunëtorja e mbretit të parë të Arbërisë, Karlit I Anzhu. Trashëgimia e saj i ka mbijetuar kohës: rrënjësja e urdhrit françeskan dhe mbijetesja e katolicizmit në pjesën veriore të Shqipërisë së sotme i detyrohen shumë asaj, sikundër rrënojat, sot me interes turistik, të objekteve të kultit në Shqipëri e gjetkë. Por nuk i detyrohen pak, ashtu siç ma do mendja, edhe letërsia moderne dhe onomastika ndër familjet fisnike arbërore të mesjetës. Emri Helena Anzhu që Kadareja i ka vënë nënën së Karl Topisë tek *Ura me tri harqe* – emër i cili nuk konfirmohet nga asnjë burim historik – frymëzohet me gjasë prej Helenës për të cilën po flasim, e që sllavët e thërrisnin Helena Anžuska. Të njëjtin emër, kësaj here plotësisht të konfirmuar në burime, Karl Topia ia vuri vajzës së tij të dytë, Helena Topisë, personalitet historik, por personazh i denjë për seri Netflix, martuar me Marco Barbarigo-n dhe së fundmi, me fatkeqin Kostandin Balsha.

### Si ka mundësi që familja Frashëri akoma nuk ishte studiuar në secilin aspekt, ndonëse është një prej familjeve kryesore të historisë së Shqipërisë? Mosnjohja, indiferenca, keqleximi i qëllimshëm i fakteve...?

Nëse flasim për familjen e tre vëllezërve Frashëri, do të ishte e pasaktë të thuhej se nuk ka qenë e studiuar më parë. Problemi qëndron tek ajo që, për shkak të kufizimeve ideologjike, studimi i ka shpëtuar qasjes holiste dhe thellimit heuristik. Të tilla kanë qenë premisat studimore në të kaluarën, sikundër edhe mundësitë për t'iu shtruar një pune të

vështirë. Nuk më rezulton të ketë pasur qëllime të këqija ose shpërfytyrime me dashje. Mirëpo kufizimet ideologjike nuk kanë qenë pa pasoja. Ato kanë shpënë në izolimin dhe shkëputjen e kësaj familjeje nga ndërveprimet dhe ndërvarësitë brenda një rrjeti më të gjerë, i përbërë nga një sërë familjesh historike Frashëri të cilat bashkëndajnë lidhje gjaku, interesash dhe ç'është më e rëndësishmja, vizion politik dhe kombndërtues pothuajse identik. Vendosi në kontekst dhe përballja e të dhënave burimore mes familjeve historike Frashëri nxjerr veç më mirë në pah veçorinë, unikalitetin e vatrës së tre vëllezërve, jo përmes kumteve partizane, por përmes fakteve të dokumentuara. Për historinë e Shqipërisë është pastaj e rëndësishme edhe pjesa tjetër që korret nga ky ballafaqim: të dhëna të panumërta mbi ngjarje, personalitete me kontribute, vepra dhe gjurmë domethënëse të shumë pinjovje nga familjet historike, përfshirë këtu edhe të dhëna për Mehmetin, vëllain më të vogël të Abdylit, Naimit dhe Samiut, për të cilin rrallë është shkruar gjësend ndonjëherë. Të gjitha këto, e shumë të tjera mbi të cilat vazhdoj të punoj, më ngjan se nuk kemi luksin t'ia braktisim harresës.

### Përballë atyre që, me të drejtë, Ardian Vehbiu i quan përralltarë, të gjuhës sikurse thotë ai, por edhe të historisë, po shtoj unë, si duhet të sillen studiuesit? Pasi, sa më serioze puna e tyre, aq më e dhunshme përgjigjja e përralltarëve. Po t'i injorjnë, ato marrin zemër; po t'i sulmojnë, bëhen edhe më të egër. Sipas jush, cila është zgjidhja në këtë rast?

Nuk kam ndonjë recetë për sa më pyesni. Por po përfitoj nga rasti të them diçka. Mendoj se në Shqipëri kemi nevojë për një “revolucion të mendësive”, në çdo aspekt. Ky lloj revolucion tërësisht paqësor ka nevojë për shumë, shumë

kulturë. Të jesh i arsimuar dhe të dish që një dhe një bëjnë dy nuk mjafton për të hapur mendjen dhe për t'u ndriçuar e aq më pak për të ndriçuar të tjerët. Gjatë viteve të diktaturës u arsimuam me themel, por a u kultivua si një kopsht i mirë, siç do të thoshte Volteri? Nuk jam aspak i sigurt për këtë. Kultura e vërtetë dhe produkti i saj mund të ndërtohen vetëm mbi mrekullimin ndaj krijimtarisë së lirë dhe kërkimit të mundimshëm shkencor, mbi përvullimin në dialog dhe mbi respektin në debat. Polemikë, protagonizmat në emër të "qëllimeve të mëdha" kinse kombëtare dhe shoqërore, që synojnë asgjësimin e një ideje e që me raste degjenerojnë në thirrje për linçim të tjetrit, janë shenja të një mungese të thellë kulture, siç janë, anasjelltas, shenja të një teprie mllëfi dhe pamjaftueshmërie, mes shumë njerëzve të arsimuar. Rabelais ka pas shkruar se "shkencë pa ndërgjegje është veç rrënim i shpirtit". Në rastin tonë mund të thuhet se shkrim pa kulturë është përtharje e mendjes. Ndaj nëse duam zgjidhje lypset të mos humbet kohë me një fenomen kalimtar, por të predikohet një disiplinë: fikni portale dhe rrjete sociale dhe kthehuni tek themelet e kulturës. E në mundshi, shkruani vetë, sa më me kulturë dhe për hir të kulturës, pa të cilën Shqipëria, të cilën Konica me shumë art e ka quajtur "kopshti shkëmbor i Europës Juglindore", as mund të njihet, as mund të kuptohet dhe as mund të kultivohet.

**Dëshiroj të kthehem edhe një herë te "Princër të Lilit...". Pas studimit të hollësishtëm të tipareve fisnike të trojeve arbërore gjatë mesjetës, sa të bindur jeni që ndonjë tipar i asaj kohe është trashëguar edhe sot, pa harruar kurrësesi se familjet fisnike ishin shumë të pakta në krahasim me popullsinë si e tërë?**

Kam përshtypjen se tipari kryesor që na karakterizon, që e kemi të trashëguar, është aftësia mahnitëse për mbijetesë. Fisnikëria arbërore, oxhakësia shqiptare, por edhe vegjelia në gjithë dinjitetin e saj të admirueshëm, u janë aklimatuar hipostazave nga më të larmishmet në shekuj. Me raste na ka ndodhur të kapërcejmë ylberet e shndërrimeve identitare, por në thelb kemi mbetur një popull që nuk ndryshon, një monolit antropologjik. Në tonën, jemi një mrekulli e historisë. Mënyra sesi i formuam në kohëra trajtat e historisë sonë politike është një mrekulli; mënyra sesi u pavarësua e sesi ia dolëm mes mijëra vështirësive të tregojmë se jemi shtetndërtues e të denjë për komunitetin e organizuar të kombeve është një mrekulli. Ndaj ka pasur të drejtë dikush kur ka thënë, pas numërimit të të gjitha plagëve e brengave tona shekullore: "Është një mrekulli sot, që Shqipëria rron."

**A kanë qenë këto studime, apo të tjera, nxitje për rivlerësimin e situatës me urdhrat dhe medaljet e Republikës, pas një katrahure qesharake dhe të dhembshme që i shoqëroi nderimet shtetërore gjatë viteve të tranzicionit?**

Studimi i historisë dhe së drejtës së nderimeve publike në Shqipëri dhe në Europë është prej vitesh një tjetër fushë interesi në të cilën kam investuar kohë dhe energji. I formuar për të qenë në shërbim të shtetit, është krejt natyreshëm që aspektet honorifike, ceremoniale dhe protokollare, përmes të cilave sovraniteti i shtetit shpaloet brenda dhe jashtë kufijve të tij, të më tërhiqin kahershëm vëmendjen. Megjithatë jetojmë në një kohë përmbysjesh të mëdha, në aspektin simbolik, perceptimi i dinjitetit, besueshmërisë dhe respektueshmërisë së një shteti sovran vazhdojnë të varen në një masë jo të vogël nga mënyra sesi shtetet përdorin ose shpërdorin shenjat e tyre legale të lavdisë. Ky aspekt shumë i rëndësishëm humbi nga sytë gjatë tranzicionit të stërzgatur në vendin tonë. Me të rrezikoi të humbiste edhe kuptimi i vetë simbolit, i cili, larg të qenit një realiteti abstrakt, është një koncentrat unifikues vlerash që sendërton në vazhdimësi qytetërimin dhe qytetarin. Më lart fola për "revolucionin e mendësive" për të cilin kemi nevojë. Kodifikimi i sistemit të vlerësimeve honorifike sipas modelit europian, formimi i "ustallarëve" të fushës, siç do të kishte thënë i ndjeri Artan Lame, edukimi mbi urdhrat dhe medaljet dhe kushtet se si meritohej ato, përsosja estetiko-materiale dhe vlera pamore e shenjave përkatëse, janë pa diskutim pjesë e kësaj fryme të përgjithshme e të domosdoshme kthimi të disiplinës, respekti për veten dhe për të tjerët, dhe të vlerësimi i meritës.


**Në një artikull diku një muaj më parë, e shpjegoni qartë konceptimin e urdhrave dhe medaljeve që ndahen nga Kancelaria respektive, kancelar i së cilës jeni ju. Për mendimin tim, konsolidimi i Kancelarisë është një hap domethënës në rikthimin e seriozitetit të shtetit.**

Prerogativa e dhënies së dekoratave u përket autoriteteve të larta të caktuara nga Kushtetuta dhe nga ligji. Misioni i Kancelarisë nuk është dhënia e tyre, por shqyrtimi i ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së kandidatave të propozuara. Ky proces, që forcon si kurrë më parë shtetin ligjor në aspektin e nderimeve publike, bazohet mbi përgjegjshmërinë e çdo vendimi dhe veprimi të natyrës shtetërore, të paraprirë nga një mendim i specializuar, kolegjal dhe i pavarur. Një mision tjetër me shumë rëndësi i Kancelarisë është ai i ruajtjes dhe promovimit të kujtesës materiale të dekoratave dhe të të dekoruarve, i cili ka të bëjë me mbajtjen gjallë dhe vlerësimin e një pjese të konsiderueshme të trashëgimisë së Shtetit shqiptar, si edhe të të gjithë individëve që kanë kontribuar, secili në mënyrën e vet, në rrezatimin e tij. Më inkurajon perceptimi juaj i Kancelarisë si një hap domethënës në rikthimin e seriozitetit të Shtetit. Uroj që institucioni dhe gjithë sistemi i ri i nderimeve publike, sado jo i përsosur, sepse vepër e njerëzve, të lërë të bashkëqytetarët të njëjtën mbresë.



Thomas Frashëri është shpallur fituesi i Çmimit "Lumo Skëndo" për vitin 2025, për librin "Princa të Lilit, bij të Arbërit, familjarë të Sulltanit" (botimet Onufri), me motivacionin:

"Një vepër, e cila shquhet për originalitetin shkencor dhe qasjen metodologjike bashkëkohore në trajtimin e historisë shqiptare. E mbështetur në burime të pasura arkivore dhe në një analizë të thelluar, kjo vepër pasuron historiografinë shqiptare dhe forcon ndërgjegjen historike mbi trashëgiminë dhe rolin e elitave shqiptare".



Edicioni i dytë i Panairit të Librit “Libri të ban të lirë” më riktheu në Shkodër bashkë me kujtimet e viteve 1992–1994, kur, krejt i ri, isha nxënës i shkollës së mesme “Shejnaze Juka”. Shkodra e atyre viteve ishte e trazuar, por unë kisha mbërritur në të me nxitjen e tim eti, i cili na kishte rritur me një lloj adhurimi për këtë qytet, si kryeqendër e letërsisë dhe e njerëzve të mëdhenj të dijes. Ai mbart ende në kujtesë vitet e shkollës pedagogjike, 1984–1986, dhe më përmend me respekt e nostalgji emra si Shaban Arra, Shefik Osmani, Lutfi Hoxha, Luigj Franga, Drita Garuci, Terezina Testallari Gjyli, Eqerem Rushi, Shaban Abdullahi, Fadil Hoxha, Safet Spahiu, Safet Hoxha e Dhora Lloi. Vetëm disa prej tyre i kam dëgjuar, por Shkodra ka lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e tim ati, edhe pse sot ai është shtatëdhjetë e shtatë vjeç. Ky është një tipar identitar i këtij qyteti: nëse një pjesë e jetës tënde pikëtakohet me Shkodrën, atëherë ti shkodranizohesh një herë e përgjithmonë.

Ajo që më befaso i në Panairin “Libri të ban të lirë” ishte para së gjithash vendi ku zhvillohej ky aktivitet. Hapësira në oborrin e Katedrales, ai Odeon i hapur me pemë dhe gjelbërim, me karrige për rreth njëqind pjesëmarrës, krijonte një skenografi natyrore dhe një kontrast të fortë me mjediset e zakonshme të panairëve të librit që zhvillohen në qendra kongresesh apo pallate ekspozitash. Përveç Odeonit, Biblioteka “Zoja e Shkodrës”, Muzeu Dioqezan dhe salla “Kardinal Mikel Koliqi” ofronin hapësira të qeta e mikpritëse, të mbushura me simbolikën e librave dhe të një trashëgimie kulturore që vazhdon të frymëzojë.

“Libri të ban të lirë” mbledhi autorë, studiues, përkthyes dhe personalitete të jetës kulturore shqiptare e ndërkombëtare. Gjatë tri ditëve të aktivitetit, publiku pati mundësinë të dëgjonte dhe të takonte nga afër emra të rëndësishëm të letërsisë shqipe si Visar Zhiti, Ridvan Dibra, Stefan Çapaliku, Andreas Dushi, Gazmend Krasniqi, Fabio M. Rocchi, Primo Shllaku, Ledia Dushi, Lulzim Haziri, Vlora Konushevcit, Durim Taçi, Rozafa Shpuza, Arben Shala e shumë të tjerë. Panairi u pasurua gjithashtu nga prania e studiuesve dhe personaliteteve ndërkombëtare si Matteo Mandalà dhe Zuzane Finger, ndërsa ceremonia e hapjes u përshëndet nga Arqipeshkvi Mons. Giovanni Peragine, botuesja Anna Shkreli dhe vetë Mandalàs.

Programi dëshmoi një larmi të admirueshme temash dhe qasjesh. Krahas promovimeve të romaneve, përmbledhjeve poetike, studimeve dhe përkthimeve, vëmendje të veçantë morën diskutimet mbi përkthimin si urë kulturore mes Shqipërisë

# “Libri të ban të lirë” në Shkodër ku libri ka shtëpinë e vet

Nga Granit Zela



dhe botës, praninë e letërsisë shqipe në gjuhë të huaja, zhvillimet e poezisë bashkëkohore, raportin ndërmjet kujtesës historike dhe letërsisë, trashëgiminë arbëreshe, si dhe rolin e bibliotekave në shoqërinë e sotme. Ligjëratat dhe panelet trajtuan tema që shkonin nga ikonografia dhe tradita letrare e Shkodrës te studimet mbi Luftën e Parë Botërore, nga marrëdhënia mes besimit dhe politikës te sfidat e narrativës bashkëkohore shqiptare.

Ky panair pati vazhdimisht auditorë të mbushur, por më mbresëlënësi ndër ta ishte Odeoni i hapur, ku publiku mblidhej çdo mbrëmje për të dëgjuar me vëmendje dhe respekt ligjëratat e Visar Zhitit dhe Matteo Mandalàs, si edhe diskutimet rreth librave të Zuzane Finger, Ardian Ndreçës, Romeo Gurakuqit, Fabio Rocchit dhe autorëve të tjerë pjesëmarrës. Po aq domethënëse ishin radhët e lexuesve që prisnin pas promovimeve për një autograf, një shtrëngim duarsh, një fotografi apo disa fjalë me autorët. Në ato tri ditë, ajo që ndihej më fort nuk ishte thjesht atmosfera e një aktiviteti kulturor, por një frymë që buronte nga fjalët, librat dhe takimet njerëzore; një dialog i gjallë mes trashëgimisë dhe bashkëkohësisë, mes autorëve dhe lexuesve, mes kujtesës dhe së ardhmes.

Një nga veçoritë më të spikatura të këtij edicioni ishte dendësia dhe larmia e aktiviteteve. Programi nisi me takimin e shkrimtarit Xhahid Bushati me nxënës të shkollave të qytetit, duke vendosur që në fillim një urë komunikimi mes autorëve dhe brezit të ri të lexuesve. Paralelisht, rreth njëzet shtëpi botuese ngritën standat e tyre pranë Katedrales së Shën Shtjefnit, ndërsa në mjediset e Bibliotekës “Zoja e Shkodrës”, Muzeut Dioqezan dhe sallës “Kardinal Mikel Koliqi” u zhvilluan promovime librash, ligjëratat, tryeza diskutimi, punëtori krijuese

dhe seanca leximesh.

Përmasa e aktivitetit u reflektua edhe në shifrat e pjesëmarrjes. Rreth njëzet shtëpi botuese nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut ekspozuan afro një mijë tituj, ndërsa gjatë tri ditëve panairi u vizitua nga rreth dy mijë lexues e dashamirës të librit. Programi përfshiu njëzet e katër takime mes autorëve dhe publikut, si dhe mbrëmje leximesh ku morën pjesë poetë dhe shkrimtarë nga trevat shqiptare, duke e shndërruar panairin në një nga ngjarjet më të gjalla letrare të sezonit kulturor.

Promovimet sollën para publikut vepra të rëndësishme të letërsisë dhe studimeve shqiptare, nga “Droja” e Andreas Dushit, “Belle Époque” e Gazmend Krasniqit dhe “Triumfi i Dytë i Gjergj Elez Alisë” i Ridvan Dibrës, te “Në kohën e brimës” i Visar Zhitit, “101 tregime të shkurtra” i Stefan Çapalikut, “Shqipëria në Luftën e Madhe, 1914–1918” i Romeo Gurakuqit dhe “Martesa, valixhet dhe ngarkesa të tjera” i Vlora Konushevcit. Krahas tyre, përkthimi zuri një vend të rëndësishëm përmes prezantimit të romanit “Lojë dritash” të Daniel Kehlmann, sjellë në shqip nga Anna Kove, si dhe përmes diskutimeve kushtuar rolit të përkthyesit në komunikimin ndërkulturor.

Po aq të rëndësishme ishin ligjëratat dhe panelet tematike. Visar Zhiti solli një reflektim mbresëlënës mbi raportin mes ikonës, letërsisë dhe përvojës së dënimit, Matteo Mandalà ndriçoi lidhjet mes Martin Camajit dhe botës arbëreshe, Zuzane Finger trajtoi praninë e letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, ndërsa Ardian Ndreca hapi një debat të thellë mbi marrëdhëniet ndërmjet besimit fetar dhe politikës. Në të njëjtën frymë, paneli “Poezia bashkëkohore shqipe” mbledhi poetë dhe studiues për të diskutuar zhvillimet dhe sfidat e poezisë shqiptare sot.

Një nga të ftuarit më të rëndësishëm të këtij edicioni ishte Visar Zhiti, i cili jo

vetëm promovoi romanin e tij më të ri, “Në kohën e brimës”, por mbajti edhe ligjëratën “Ikona dhe letërsi nga Shkodra – absurdi i dënimit”. Në të, ai ndaloi te roli i Shkodrës dhe i klerit katolik në historinë e letërsisë shqipe, duke sjellë në vëmendje atë pjesë të trashëgimisë sonë letrare që ai e ka cilësuar si “realizëm i dënuar”, krijimtari e lindur në kushtet e përndjekjes, burgut dhe censurës. Prania e tij në qytet u shoqërua edhe me një vizitë në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, ku u prit nga rektori Tonin Gjuraj. Në shënime të tij të publikuara gjatë qëndrimit në Shkodër, Zhiti rikthehej te vitet e studimeve universitare dhe te kujtesa e një brezi që e kishte jetuar qytetin në rrethana krejt të tjera historike, duke e kthyer këtë vizitë në një takim domethënës mes kujtesës personale, historisë së institucionit dhe jetës kulturore të sotme.

Një kontribut i veçantë në dimensionin ndërkombëtar të panairit solli përkthyesja dhe studiuesja gjermane Zuzane Finger, një nga njohëset dhe promovueset më të rëndësishme të letërsisë shqipe në hapësirën gjermanofolëse. Në ligjëratën e saj kushtuar pranisë së letërsisë shqipe në gjermanisht, ajo ndau përvojën e gjatë të punës me autorët shqiptarë dhe sfidat e ndërmjetësimit kulturor ndërmjet dy gjuhëve e dy traditave letrare. Prania e saj në Shkodër ishte një kujtesë e rëndësishme se letërsia shqipe vazhdon të gjejë lexues përtej kufijve kombëtarë falë punës së përkthyesve, të cilët shpesh janë ambasadorët më të përkushtuar të kulturës sonë në botë. Në këtë kuptim, ligjëratat e Zuzane Finger ishte një dëshmi konkrete e dialogut që letërsia shqipe ka ndërtuar me kulturat europiane dhe e mundësive që ajo ka për të zgjeruar më tej praninë e saj ndërkombëtare.

Jehona e këtyre ligjëratave nuk mbeti e kufizuar në auditorët e panairit. Gjatë ditëve të aktivitetit, temat e trajtuara në diskutime e kumtesa frymëzuan edhe reflektime të botuara në media dhe rrjete sociale nga studiues e autorë të ndryshëm, çka dëshmonte se panairi kishte arritur të krijonte një hapësirë të vërtetë dialogu kulturor. Jehona e këtyre ligjëratave nuk mbeti e kufizuar në auditorët e panairit. Temat e trajtuara frymëzuan reflektime edhe në media e rrjete sociale, ndër to edhe një ese të Luan Ramës kushtuar Shkodrës si vatër kulture dhe kontributit shkencor të Matteo Mandalàs.

Një nga meritat më të mëdha të panairit ishte se arriti të bashkonte në të njëjtën hapësirë krijimtarinë artistike, mendimin kritik dhe dialogun kulturor. Në të njëjtat mjedise ku ligjëronin emra të njohur të kulturës shqiptare dhe arbëreshe, të rinjtë merrnin pjesë në punëtori krijuese dhe takime me autorë, duke krijuar një vazhdimësi të natyrshme ndërmjet traditës dhe së ardhmes së letërsisë shqipe.

Megjithatë, mes atmosferës festive dhe pasurisë së aktiviteteve, panairi solli në vëmendje edhe disa shqetësime që lidhen me jetën e librit në qytet. Në fjalën e hapjes, shkrimtari dhe studiuesi Stefan Çapaliku tërhoqi vëmendjen ndaj paradoksit të një Shkodre që zë një vend të veçantë në historinë e kulturës shqiptare, që ka njohur libraritë dhe bibliotekat e para të vendit, por që sot nuk disponon një librari publike ku lexuesit të mund të njihen me botimet e reja.

(Vijon në faqen 7)



Ndër veprat më interesante që ndëshmojnë praninë e motiveve shqiptare në letërsinë rumune të shekullit XIX është poezia “Baladë albaneze” (Baladë Shqiptare) e poetit rumun George Coșbuc, botuar në përmbledhjen “Baladë și idile” në vitin 1893. Kjo baladë paraqet një histori dashurie, xhelozie dhe nderi, të vendosur në hapësirën shqiptaro-epirote dhe të ndërtuar mbi motive të njohura të folklorit ballkanik.

Ngjarja zhvillohet pranë një lumi, ku biri i Pashait të Janinës po i jep ujë kalit të tij të zi. Në të njëjtën kohë aty mbërrin Dhespina, një grua e re që vjen për të mbushur ujë, duke mbajtur mbi krye një enë të bardhë. Skena idilike vëzhgohet nga larg prej Gjergjit, burrit të saj, i cili ndodhet në majën e një mali dhe sheh njëkohësisht gruan dhe të riun osman. Poeti ndërton gradualisht tensionin dramatik. Biri i Pashait nxjerr një lule nga kraharori dhe e hedh në ujë, duke e lënë të notojë deri te Dhespina. Gruaja e merr lulen dhe e vendos mbi kraharor, një gjest që në kodin simbolik të baladës përfaqëson pranimin e një ndjenje apo afërsie sentimentale. Nga maja e malit, Gjergji e sheh këtë veprim dhe zemërimi i tij shtohet. Ai shtrëngon grushtat, kaqshon buzën dhe përgatit karabinën. Kulmi i baladës vjen kur Gjergji qëllon. Por plumbi i parë nuk drejtohet as ndaj gruas, as ndaj rivalit të tij. Ai godet pikërisht zambakun e vendosur në kraharorin e Dhespinës. Ky veprim ka një ngarkesë të fortë simbolike: synon të dënojë tradhtinë e perceptuar dhe jo të marrë menjëherë jetën e personazheve. Më pas, biri i Pashait hipën mbi kalë për t'u larguar, por një plumb i dytë e arrin. Edhe ky nuk synon vdekjen. Ai e godet në krah, në mënyrë që, siç shprehet poeti, “me atë dorë të mos ledhatojë më gra të tjera”. Kështu, balada përfundon jo me vrasje, por me një ndëshkim simbolik të dyfishtë: lulja e dashurisë shkatërrohet dhe krahu i joshësit plagoset. Poezia u bë e njohur edhe për lexuesin shqiptar pas 60 vitesh më vonë përmes përkthimit të Prof. Vehbi Balës<sup>1</sup>, botuar në revistën Nëntori (nr. 5, 1954), i cili mesa duket u njoh me të gjatë studimeve të tij në Rumani. Në variantin shqip ruhen ritmi narrativ dhe ngarkesa simbolike e origjinalit rumun. Përkthimi i Prof. Vehbi Balës ruan edhe motivin e lules që noton mbi ujë drejt Dhespinës dhe reagimin e Gjergjit, duke e përcjellë me besnikëri atmosferën e baladës, ku nderi, xhelozia dhe dashuria ndërthuren në një rrëfim tipik të traditës ballkanike.

Profesor Vehbi Bala

Kjo strukturë narrative, e ndërtuar mbi simbolikën e natyrës dhe intensitetin e emocioneve njerëzore, e afron baladën me traditën e romantizmit në letërsinë rumune të shekullit XIX. Lumi që bart lulen drejt Dhespinës, mali nga ku Gjergji vëzhgon skenën dhe zambaku që bëhet simbol i pasionit dhe i tradhtisë së perceptuar, nuk janë thjesht elemente të peizazhit, por figura poetike që pasqyrojnë gjendjet shpirtërore të personazheve. Dashuria e ndaluar, xhelozia, nderi, hakmarrja dhe fati tragjik përbëjnë tema themelore të romantizmit evropian dhe ballkanik, duke e vendosur këtë baladë në një traditë letrare ku emocionet individuale fitojnë përparësi ndaj arsyes dhe normave shoqërore. Balada është karakteristike për stilin e


<sup>1</sup> Vehbi Bala (1923–1990) ishte poet, studiues, përkthyes, pedagog universitar dhe historian i letërsisë shqiptare. I lindur në Shkodër, ai kreu studimet e larta në Zagreb dhe Bukuresht (1948–1952), ku u specializua në gjuhë dhe letërsi neolatine. Pas kthimit në Shqipëri punoi si mësues në Gjirokastrë dhe Shkodër, më pas si pedagog i Letërsisë Shqipe në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe në Universitetin e Tiranës. Bala është autor i një sërë vëllimesh poetike dhe monografish kushtuar figurave të rëndësishme të kulturës shqiptare, si Jeta e Elena Gjikkës (1967), Fan S. Noli (1972), Migjeni (1974), Viktor Eftimiu (1978) dhe Pashko Vasa (1979). Ai dha një kontribut të rëndësishëm edhe në përkthimin e letërsisë rumune në shqip, veçanërisht të veprave të Mihai Eminescut dhe George Coșbuc-ut, duke shërbyer si urë kulturore ndërmjet dy traditave letrare.

## Historia e Dhespinës dhe djalit të Pashait të Janinës në një baladë të autorit rumun George Coșbuc.

Nga Dr. Dorian Koçi




George Coșbuc-ut, një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë rumune të fund shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. I lindur më 20 shtator 1866 në Hordou të Transilvanisë (sot fshati mban emrin e tij), Coșbuc u formua në një mjedis ku tradita popullore, folklori dhe historia kombëtare zinin një vend qendror. Këto elemente do të bëheshin më vonë themeli i krijimtarisë së tij poetike. Ai fitoi famë të madhe me poezitë kushtuar jetës fshatare rumune,



ku përshkroi me realizëm dhe ndjeshmëri botën e fshatit, zakonet, festat, vuajtjet dhe aspiratat e njerëzve të thjeshtë. Përveç veprimtarisë si poet, Coșbuc ishte edhe një përkthyes i shquar. Ai solli në gjuhën rumune vepra madhore të letërsisë botërore, ndër to “Eneidën” e Virgjilit, pjesë nga “Odisea” e Homerit dhe, mbi të gjitha, “Komedinë Hyjnore” të Dantes, një ndërmarrje monumentale që dëshmoi kulturën e tij të gjerë klasike. Në vitin 1916 u zgjodh anëtar i Akademisë Rumune, duke u njohur si një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës kombëtare.

Në veprat e tij, Coșbuc ndërthurte mjeshtërisht motivet popullore me një vëzhgim të hollë psikologjik, duke i dhënë personazheve një dimension njerëzor dhe emocional që tejkalonte rrëfimin tradicional folklorik. Përmbledhja “Baladë și idile” (1893), ku u botua edhe Baladë albaneze, konsiderohet një nga veprat më përfaqësuese të poetit. Në të, ai ringjall atmosferën e këngëve dhe legjendave popullore, por njëkohësisht u jep atyre formë artistike moderne, duke kombinuar lirizmin me tensionin dramatik. Megjithatë George Coșbuc zakonisht renditet ndër përfaqësuesit e realizmit dhe tradicionalizmit rural rumun, krijimtaria e tij ruan lidhje të forta me trashëgiminë romantike që kishte dominuar letërsinë rumune gjatë shekullit XIX. Poetë si Mihai Eminescu dhe Vasile Alecsandri kishin ngritur tashmë folklorin, historinë kombëtare dhe peizazhin natyror në rangun e burimeve kryesore të frymëzimit letrar. Coșbuc trashëgoi këtë prirje, por e pasuroi atë me një qasje më narrative dhe më afër jetës së përditshme. Në “Baladë Shqiptare”, ai ndërthur elemente të baladës popullore me ndjeshmërinë romantike për pasionin, fatin dhe konfliktin moral, duke krijuar një atmosferë që lëkundet midis legjendës dhe realitetit. Po aq domethënëse është edhe zgjedhja e një subjekti të vendosur



në Janinën osmane dhe në hapësirën shqiptaro-ballkanike. Romantizmi rumun, ashtu si shumë rryma romantike evropiane, ushqente një interes të veçantë për historinë, folklorin dhe kulturën e vendeve fqinje, të perceptuara si mbartëse të traditave autentike dhe të një ekzotizmi të afërt. Në këtë kuptim, figura e birit të Pashait të Janinës, peizazhi malor dhe kodi i nderit që drejton veprimet e personazheve nuk përbëjnë vetëm një rrëfim lokal ballkanik, por edhe një pasqyrim të shijeve estetike të romantizmit rumun të fund shekullit XIX. Kështu, “Baladë albaneze” shfaqet si një pikë takimi midis folklorit shqiptar, imagjinatës romantike rumune dhe trashëgimisë së përbashkët kulturore të Ballkanit.

Në rastin e “Baladës Shqiptare”, Coșbuc shfaq aftësinë e tij për të depërtuar në universin kulturor të popujve të tjerë të Ballkanit. Ai ndërton një histori të thjeshtë në pamje, por të mbushur me simbolikë: lulja që noton mbi ujë, mali si vendshkrimi i gjykimit dhe karabina si instrument i nderit të cenuar. Këto elemente e lidhin poezinë me traditën epike ballkanike, ndërsa trajtimi psikologjik i xhelozisë, krenarisë dhe pasionit e bën atë një vepër me vlera universale. Përmes kësaj balade, Coșbuc jo vetëm që dëshmon njohjen e folklorit rajonal, por edhe aftësinë e tij për ta shndërruar materialin popullore në letërsi të nivelit të lartë artistik. Edhe pse autori nuk jep të dhëna historike konkrete për personazhet, zgjedhja e Janinës, e Dhespinës dhe e Gjergjit e vendos rrëfimin në një mjedis të njohur ballkanik, ku bashkëjetonin shqiptarë, grekë, vllahë dhe osmanë. Megjithatë në baladë nuk përmendet drejtpërdrejt figura e Ali Pasha Tepelena, ka gjasa që sfondi historik i saj të lidhet me periudhën e lulëzimit të Pashallëkut të Janinës në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX. Janina e asaj kohe ishte shndërruar në një nga qendrat më të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore të Ballkanit jugperëndimor, duke tërhequr tregtarë, diplomatë, intelektualë dhe aventurierë nga një hapësirë e gjerë që shtrihej nga Adriatiku deri në Principatat Danubiane. Veçanërisht periudha 1806–1821 përbën një kapitull të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërmjet elitave shqiptare dhe rumune. Luftërat ruso-osmane dhe trazirat e shkaktuara nga epoka napoleonike transformuan ekuilibrat politikë të Evropës Juglindore, ndërsa Principatat Danubiane të Vllahisë dhe Moldavisë, të qeverisura nga regjimi fanariot, u bënë një urë e rëndësishme komunikimi ndërmjet Ballkanit osman dhe Evropës Qendrore. Në këtë kontekst, lidhjet midis Janinës dhe qendrave rumune si Bukureshti e Jashi u intensifikuan përmes tregtisë, financave, arsimit dhe lëvizjes së elitave intelektuale.

Gjatë sundimit të Ali Pashë Tepelenës, Janina përjetoi një zhvillim



**GJERGJ KOSHBUK**  
**Ballada shqiptare**

Biri i Pashës nga Janina  
kalit t'zi po i jep me pi,  
n'sa për ujë në lum ka arri  
me buljer' mbi krye Despina.  
Por në mal, në kreshtë ruen,  
drejt bregores Gjergji kqyr  
edhe turkun<sup>2</sup> edhe gruen.

Biri i Pashës nga Janina  
nga krahni i lule nxjerr  
dhe në valë e hjedh të bjerë  
që nga bregu ke Despina.  
Grushtat Gjergji n'mal shtrëngon,  
kafshon buzën egër ndhambë  
edhe idhtas turfullon.

Biri i Pashës nga Janina  
prej gëzimit krah't i shtrin  
kur kalon ngadalë e arrin  
at zambak mbi lum Despina.  
Dhe me të stolisi gjinë...  
Po edhe n'mal i vuni Gjergji  
plumbat mbrend' në karabinë.

Biri i Pashës nga Janina  
ambëlsisht miklon ke balli  
gruen e bukur, por nga mali  
vdekjen solli karabina.  
As të riut as kalit t'tij,  
por zambakut plumbi i vojti  
që e pabesa vuni ngji.

Biri i Pashës nga Janina  
mbërthen brezin, kcen mbi shalë,  
rreh marrisht me fre mbi kalë,  
por e arriti karabina:  
jo në gjoks me ar prarue,  
por në krah, që tjera gra  
me at dor' mos me miklue!

E përktheu: Vehbi Bala,  
Revista Nëntori Nr 5, Viti 1954.

**Bibliografi:**

Călinescu, George. Istoria literaturii române de la origini până în prezent. București: Fundația Regală pentru Literatură și Artă, 1941.  
Cornea, Paul. Originile romantismului românesc. București: Minerva, 1972.  
Coșbuc, George. Balade și idile. București: Editura Librăriei Socec & Comp., 1893.  
Fleming, Katherine E. The Muslim Bonaparte: Diplomacy and Orientalism in Ali Pasha's Greece. Princeton: Princeton University Press, 1999.  
Manolescu, Nicolae. Istoria critică a literaturii române. București: Paralela 45, 2008.  
Pop, Ion. Dicționar analitic de opere literare românești. Cluj-Napoca: Casa Cărții de Știință, 1998.  
Stoianovich, Traian. Balkan Worlds: The First and Last Europe. Armonk, NY: M.E. Sharpe, 1994.  
Todorova, Maria. Imagining the Balkans. New York: Oxford University Press, 1998.

Shënim: Ky shkrim i ka fillesat në një postim në rrjetet sociale të bibliografit dhe studiuesit Petro Mejdi, i cili herë pas here publikon materiale nga koleksioni i revistës Nëntori, ndër të tjera edhe poezinë "BALADË ALBANEZË", të përkthyer në shqip nga prof. Vehbi Bala me titull "Ballada Shqiptare".

<sup>2</sup> Në shumë burime letrare dhe publicistike të Ballkanit të shekujve XIX–XX, termi "turk" është përdorur shpesh si një etiketë e përgjithshme për popullsitë myslimane, përfshirë edhe shqiptarët myslimanë, duke reflektuar më shumë një kategori fetaro-kulturore në perceptimin e jashtëm sesa një identitet etnik të saktë. Ky përdorim lidhet me trashëgiminë e gjatë osmane në rajon, ku përkatësia fetare shpesh mbivendosej mbi atë etnike në diskursin administrativ dhe popullor. Në këtë kontekst, edhe në vargjet e përkthyer nga Prof Bala (duke i qendruar besnik origjinalit) ku shfaqet shprehja "edhe turkun", termi duhet lexuar si një gjurmë e këtij kategorizimi historik, i cili në shumë raste nuk dallon midis osmanëve si identitet politik dhe shqiptarëve myslimanë si komunitet etnik i veçantë. Ky pasqyrim gjuhësor tregon se si diskursi kulturor dhe letrar i periudhës ruan ende shtresëzime të vjetra osmane të identifikimit, duke prodhuar një "tjetërsim" të brendshëm të elementit mysliman në hapësirën shqiptare dhe ballkanike, i cili më pas u rishikua dhe u dekonstruua gradualisht nga historiografia dhe studimet moderne të identitetit kombëtar.

të jashtëzakonshëm ekonomik. Rugët tregtare që lidhin Epirin me portet e Adriatikut dhe me tregjet e Danubit favorizuan krijimin e një rrjeti të dendur shkëmbimesh tregtare dhe kulturore. Tregtarë shqiptarë, grekë, vllahë dhe rumunë lëviznin vazhdimisht midis Janinës, Bukureshtit, Braşovit dhe qyteteve të tjera të rajonit, duke krijuar një hapësirë të përbashkët ekonomike dhe intelektuale. Kjo lëvizje e njerëzve dhe ideve kontribuoi në formimin e identiteteve kozmopolite dhe në qarkullimin e motiveve folklorike, legjendave dhe rrëfimeve popullore nga një kulturë në tjetrën. Fakti që një poet rumun i fund-shekullit XIX zgjodhi ta quante këtë vepër "Baladë Shqiptare" është domethënëse. Ai tregon se në imagjinatën kulturore rumune të kohës, Shqipëria dhe trevat e Epirit përfaqësonin një hapësirë të pasur me legjenda, histori dashurie dhe kode nderi.

Po në këtë periudhë filluan të shfaqeshin edhe idetë e para proto-nacionaliste në Ballkan, të ushqyera nga Iluminizmi evropian dhe nga kontaktet e elitave lokale me qendrat intelektuale të Perëndimit. Shqiptarët dhe rumunët, ndonëse në kontekste të ndryshme politike, u përfshinë në procese të ngjashme të vetëdijesimit kulturor dhe kombëtar. Figura të lidhura me Janinën, si dijetarë, tregtarë dhe administratorë, kishin kontakte të vazhdueshme me mjediset intelektuale të Bukureshtit dhe të Principatave Danubiane, duke krijuar ura komunikimi që do të ndikonin më vonë në lëvizjet kombëtare të shekullit XIX.

Në këtë këndvështrim, "Balada Shqiptare" e George Coșbuc-ut mund të lexohet jo vetëm si një histori dashurie, xhelozie dhe nderi, por edhe si një jehonë poetike e një bote ballkanike të ndërlikuar, ku Janina e kohës së Ali Pashë Tepelenës kishte fituar një vend të rëndësishëm në imagjinatën kolektive të rajonit. Prania e birit të Pashait të Janinës në qendër të rrëfimit nuk është vetëm një zgjedhje ekzotike letrare, por pasqyron prestigjin dhe famën që Janina dhe oborri i saj gëzonin në hapësirën ballkanike gjatë dekadave të para të shekullit XIX.

Botuar në vitin 1893 në vëllimin "Balade și idile", "Baladă albaneză" mbetet një nga shembujt më interesantë të pasqyrimin të temave shqiptare në letërsinë rumune. Ajo dëshmon jo vetëm talentin poetik të George Coșbuc-ut, por edhe ekzistencën e një hapësire të përbashkët kulturore ballkanike, ku lidhjet midis shqiptarëve dhe rumunëve ishin të shumta, përmes tregtisë, emigracionit, arsimit dhe jetës kulturore dhe motive, personazhe dhe histori kalonin nga një traditë kombëtare në tjetrën, duke krijuar një trashëgimi të përbashkët letrare.

(Vijon nga faqja 5)

Në të njëjtën frymë, Dom Vlash Palaj kujtoi se qytetet, ashtu si vetë jeta, kanë nevojë për përmajtje më shumë sesa për fasada, duke e paraqitur librin dhe leximin si pjesë të domosdoshme të jetës shpirtërore dhe kulturore të komunitetit.

Ndërsa Andreas Dushi, një nga ideatorët e panairit, e cilësoi "Libri të ban të lirë" si një panair të vetë qytetit të Shkodrës, një nismë që synon të bashkojë autorë, botues dhe lexues përtej çdo kufizimi institucional apo formal. Këto tre këndvështrime, të shprehura që në ceremoninë e hapjes, përbënin në një farë mënyre boshtin ideor të gjithë aktivitetit: nevojën për më shumë hapësira kushtuar librit, për më shumë përmajtje kulturore në jetën publike dhe për një komunitet lexuesish që e sheh librin si pjesë të identitetit të vet qytetar.

Një nga momentet kulmore të edicionit të dytë ishte ceremonia e ndarjes së çmimeve letrare. Në sallën "Kardinal Mikel Koliqi", panairi mori një mbyllje dinjitoze përmes vlerësimit të autorëve dhe veprave më të spikatura. Çmimi për romanin më të mirë iu dha Ridvan Dibrës për veprën "Triumfi i Dytë i Gjergj Elez Alisë", çmimi për studimin më të mirë historianit Romeo Gurakuqi për librin "Shqipëria në Luftën e Madhe", ndërsa çmimi për përkthimin më të mirë shkoi për Durim Taçin për përkthimin e romanit "Portokall me kurdisje" të Anthony Burgess. Me një çmim mirënjohjeje u nderua gjithashtu Luçia Zorba për librin "Veç drita s'paska mbarim". Nuk ishte rastësi që një panair i cili gjatë tri ditëve kishte vënë në qendër dialogun mes krijimit, studimit dhe përkthimit u mbyll pikërisht me vlerësimin e një romani, një veprë studimore dhe një përkthimi. Kjo treshe çmimesh pasqyrore në mënyrë simbolike tri shtyllat mbi të cilat mbështetet jeta e librit: imagjinatën krijuese, kërkimin intelektual dhe komunikimin mes kulturave.

Pas programit të pasur dhe atmosferës së ngrohtë të panairit qëndronte edhe puna e qetë e dhjetëra organizatorëve, bashkëpunësorëve dhe vullnetarëve. Prania e tyre ndihej në çdo detaj të aktivitetit, nga mikpritja e autorëve dhe koordinimi i promovimeve deri te funksionimi i përditshëm i hapësirave që priten lexuesit gjatë tri ditëve.

Në qendër të kësaj përpjekjeje qëndronte një bashkëpunim i gjerë ndërmjet institucioneve, organizatorëve dhe komunitetit kulturor të qytetit. Merita për realizimin e këtij edicioni i takon Famullisë "Zoja e Shkodrës", Dom Vlash Palajt, Stefan Çapalikut, Andreas Dushit, Gjovalin Çunit, Jozefina Gurit dhe shumë bashkëpunësorëve e vullnetarëve që kontribuan në organizimin e aktivitetit. Një pjesëmarrje të gjerë pati edhe Forumi i Shkrimtarëve Shqiptarë – Forum 26, me autorë dhe përkthyes të përfshirë në promovime, ligjërata, panele dhe seanca leximesh gjatë gjithë programit. Panairi dëshmoi se kur energjitë individuale dhe institucionale bashkohen rreth një qëllimi të përbashkët, libri mund të kthehet sërish në qendër të jetës publike.

Në fund të fundit, ajo që e dallonte këtë panair nga shumë aktivitete të tjera kulturore ishte mënyra se si libri u rikthye për tri ditë në qendër të jetës qytetare. Në oborrin e Katedrales, në Bibliotekën "Zoja e Shkodrës", në Muzeun Dioqezan dhe në sallën "Kardinal Mikel Koliqi", libri nuk ishte vetëm objekt promovimi apo shitjeje, por pikënisje e bisedave, debateve dhe reflektimeve mbi kulturën, historinë dhe të ardhmen. Në këtë kuptim, "Libri të ban të lirë" dëshmoi se edhe në kohën e rrjeteve sociale dhe komunikimit të shpejtë, libri vazhdon të mbetet një nga format më të qëndrueshme të dialogut publik.

Ndoshta vlera më e madhe e këtij panairi nuk matet vetëm me numrin e aktiviteteve, të pjesëmarrësve apo të librave të promovuar. Ajo që e bën të veçantë është modeli kulturor që propozon: një panair ku libri nuk mbetet mall i ekspozuar në stenda, por bëhet qendër e një bashkëbisedimi të vazhdueshëm mes shkrimtarëve, studiuesve, përkthyesve dhe lexuesve.

Kur u largova nga Shkodra pas përfundimit të panairit, më erdhën sërish ndër mend rrëfimet e tim eti për qytetin që kishte njohur në rininë e tij. Ndër vite kanë ndryshuar njerëzit, rrugët, ndërtesat dhe brezat, por mbetet e pandryshuar ajo që e ka bërë gjithmonë Shkodrën të veçantë: besimi se libri, dija dhe kultura janë pjesë e identitetit të qytetit. Ndoshta për këtë arsye, edhe pas tri ditësh të mbushura me takime, ligjërata, promovime dhe biseda, ndjesia që mbetet nuk është ajo e një aktiviteti të mbyllur, por e një bisede që vazhdon.



“Dhe thashë: Më mirë ta shkruanin rruftët, dhe nga hiri i saj të rilindej, se sa të fshiheshin kukudhët degëve pjellore ku pikon gjithi i fikut qumësht të bardhë, gjak harrese... shtëpi -arkë Noe midis gështenjave ankoruar.”

(Çarjet e Romiosinit, f. 105).

Guri i Epirit është i ashpër, i fortë, por nuk është ngurtësuar, plot tinguj, ngjyra, jetë të fshehura në një buthim plot mite dhe mistere, dhe poezia që prodhon, është si uji gurgullues, që tekta buron dhe del në sipërfaqje, formohet si një lumë dhe në ecjen e tij vëllazërohet me lumenjtë të tjerë mbi pëllëmbën e një njeriu, si “lumenjtë e fallit”, tekta ngjan me gjethe rrafi që rrjedh bashkë me ujërat e tyre, si varkë me vela, si pëllëmbë dore me vijat e saj, mbi të cilën leximi i fatit, nuk zbërthehet me orakuj por me vargje -magjie, me yshtje stërgjyshore, me pëshpëritje grash, përzier me fëshfëritje plepash, si një shprese që ndihet butësisht: “... të rihapen rrugët mbuluar me push, të mugullojnë bajamet majë humnerave, të mbushen lumenjtë me borë, së mos gjejmë ujë gurgullues një ditë, të lajmë të vdekurit tanë” (Harta e vendlindjes, f. 104).

Kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë gjithmonë poezia e Nikos Kacalidas, një afresk i vendlindjes, i atdheut të tij të vogël dhe të madh, Epirit dhe Greqisë apo përsëri i dy vendlindjeve të tij të ndryshme, Greqisë dhe Shqipërisë, tekta ai vjen me një vëllim tjetër poetik nga njëzet e katër gjithsej në opusin e tij për të përmbledhur një rrugëtim të gjatë të jetës së tij krijuese në hapjen e një pëllëmbë metaforike, e cila ngjan me një hartë origjinale udhërrëfyese, një guidë rrugore me shumë stacione shenuar në të, dhe është kjo metaforë sikur “shthur fillin e kujtesës”, “sikur tregon me dorë universin e ekzistencës” siç do të thoshte Odiseas Elitis - i cili për Kacalidas është një nga fenerët udhërrëfyese të udhëtimit të tij, së bashku me shumë fenerë të tjerë të krijimtarisë orale dhe traditës së kultivuar letrare, që nga Kristalis në Palamas dhe shumë të tjerë shndërruar në një diskurs poetik modern antologjik. Këta janë personalitetet që Kacalidas ka absorbuar dhe zotëron mjeshtërisht në formë, stil, strukturë poetike dhe morfologjike, por ai është vet poet dhe rikrijon një sintezë me një gjuhë të pasur dhe të larmishme origjinale, që e çon poezinë e tij në një formë të re eliptike, në një abstraksion të ri, e cila herë ndërtohet me brume mitike, herë alegorike realiste e herë të tjera meditative, ekzistencialiste, një anatomi e simboleve dhe shenjave.

### Një gjeratore figuracionesh

Siç shkruan me të drejtë poeti Jorgos Markopoulos në kopertinën e pasme të librit të Nikos Kacalidas, me titullin e çuditshëm “Lumenjtë e pëllëmbës sime”: *Një gjuhë brilante, një thesar gjuhësor pa kallëpe dhe caqe, nga të gjitha lulet e kopshtit gjuhësor, homerike e lashtë, e kultivuar, e folur demotike veriore dhe jo si modë konjunkturale, po si domosdoshmëri e brendshme, që në thurjen dhe qëndisjen e fjalës dhe stofit poetik në lojën e imazhit metaforik lirik të kujton Lorkën dhe Elitis...*

Është e padiskutueshme se kuota më e lartë e poezisë së Kacalidas është gjuha e tij, jo vetëm se kombinon gjithçka nga pasuria e saj, siç e përmend Markopoulos, por se në tërësi ai artikulon një univers poetik me konotacione kozmologjike dhe ekzistencialiste në një lojë gjuhësore magjike rrjedhëse, e cila thuhet e ngre atë në një “gjuhë fiziologjike”, thuhet një kod të lashtë simbolesh, si orakujt e Dodones, do të thoshte dikush, kod i cili evoluon në një (continuum) detajesh poetike, midis “atriumeve mëngjesore”, shkrimeve të shpellave, “asteriseve që pikojnë ambrozi”

## Botimet Nikas, Athinë Nikos Kacalidha “Lumenjtë e pëllëmbës sime”

Nga Nikos Vlahakis

Niko Kacalidas sjell një krijimtarë dinjitoze që e shpalos mu në mes të ditës me diell në sheshmejdani letrar të shkrimtarëve më të shquar ballkanikë, në kalimin nga shekulli i 20-të në shekullin e 21-të. Aty është pozicioni i vërtetë i këtij poeti dhe aty ai do të klasifikohet nga studiuesit e mëvonshëm.

dhe kreshtave malore me pëllumba të egër, me shqiponja, me “frone të alabastra yjesh” dhe kryeengjëjt që duket sikur takohen dhe enden midis trumcakëve dhe zogjve të qiellit në një gjeratore imazhesh që - siç kam e pata argumentuar dikur në një shkrim tjetër - të çojnë në një “Realizëm magjik poetik”, duke pasqyruar një memorie shekujsh.

Nëse dikush shkërmoq a çmonton pasurinë gjuhësore të Kacalidas dhe e zbërthen atë në shprehje dhe fjalë me vete - të cilat në vetvete përbëjnë imazhe të pavarura të ngarkuara me mite dhe legjenda - dhe pastaj i grumbullon dhe i mbledh përsëri, duke i rigrupuar në bashkësi dhe struktura të tjera të vogla apo edhe më të mëdha, atëherë këto do të përbëjnë përsëri një univers tjetër të ri poetik. Dhe kjo është e veçanta e kësaj dëshmie dhe prurje të re poetike, se vargjet përmbajnë vargje të tjera brenda tyre, si një lojë matriuskash:

“Ku janë kryqet e gurta të gjyshërve të pagjumë, mijra fragmente të memorjes stërgjyshore dhe si t'i ringjishësh ato?”, do të shkruajë poeti (f. 27, *Kryqet dhe gurë varresh*) dhe kjo nevojë kaq e thellë është esenca e këtij vëllimi të ri përfaqësues, i cili për mendimin tonë përmbledh në miniatyre gjithë karakteristikat kryesore të krijimtarisë së tij, kuintencencë strukturuar në një Suma poetica që rrjedh si një lumë midis viseve të vendlindjeve, por edhe stacioneve onirike të një kthimi Odisean, i cili funksionon si një Nekia homerike. Sepse “në balloren e ngrirë prej stuhisë së borës të portës së lashtë stërgjyshore në mozaikun prej guri” (f. 31), Kacalidas nuk lexon fatin personal të vetvetes, por fatin e së tërës, në të cilin vendos veten, një fat i ndërthurur

me historinë dhe mitet, dhe ai vetë bëhet “shqiponja e orakujve okultë”, heremiti që i interpreton ato, tekta kundron stuhitë e dëborës, vetëtimat, bubullimat, rruftët e kohrave të trazura që bien në pragjet e harruara atërore dhe shtëpitë aristokrate, bujare të tokës amtare.

Në këtë mënyrë, Kacalidas arrin atë që Jorgos Seferis e përcakton në poezi si “formën supreme të përdorimit emocional të gjuhës” që ndryshon nga forma e saj e përditshme utilitare, dhe për këtë arsye arrin një poetikë të eperme, gurgulluese, plot pulse dhe ndjenja lirike, tekta gërmon dhe hululton thesaret në depozitimet shekullore të gjuhës greke, duke mbartur shpirtin e një populli të tërë. Ai shpesh herë të jep idenë se është tradicional, por është iluzore kjo se format e tij strukturore janë të kultivuar me kombinime rigorozë, ai është krijues mitesh, por rrëfen realitete, ai është narrativ por nuk e lë asnjëherë ritmin e brendshëm muzikor të përfundojë në prozaizëm. Ai është koherent, por në të njëjtën kohë poezitë e tij janë fragmente të gjera të një afresku të madh, një thesar kujtese me një elegancë shprehjeje të fuqishme gjuhësore, që përfaqësojnë trashëgiminë stërgjyshore përmes detajeve të gurit rrethuar prej barit, të vajeve historike dhe të një universi të magjishëm të natyrës që regëtin dhe dridhet në pëllëmbën e autorit, këtij poeti-vëzhgues.

### Një ‘Ekologji e heshtjes’

Rikrijim imazhivist i natyrës, përmes “ekologjisë së heshtjes”, do të guxojë ta karakterizojë si të tillë këtë vëllim të fundit të Kacalidas, që përbën kuotën më të lartë



të tij, por kjo heshtje është vazhdimësia e një rrëfimi poliedrik, pa u shndërruar natyralizëm steril, por një bashkëbisedim i gjallë me hapësirën natyrore të Epirit dhe “tokës pa caqe”: “Le të fishkëllenin dhe të dridheshin murlanet, duke nxjerrë brirët. Bredhat reshtuar mbi shtëpitë tona zinin pozicionet e tyre.” (Bredhat e Leshnicës, f. 119).

Përveç dimensionit imazhivist dominues të natyrës, karakteristikë tjetër e rëndësishme kryesore e Kacalidas, është e gjithë kjo gjenealogji pothuajse papadiamantike e formave arketipike të një mnemosyne strukturuar në vargje në një fshehtësi okulte, e cila përfundimisht i bën ato të shenjta përmes shenjtërimit poetik: “... gratë zbrisnin me radhë nën llambadarin e yjeve dhe herë gjyshja bëhej ikona e Shen Marisë, herë nëna e Isuit nëna ime dhe ngjiteshin e zbrisnin në ikonostas, si Virgjëresha Mari të veshura me të zeza”. (Tempulli, f. 118). Lexuesi ndjen se hyn në një galeri të madhe figurash stërgjyshore, mitesh dhe legjendash, duke alternuar përmes një rrëfimi ku imazhet kërcëjnë para syve të tij.

Korpusi letrar i Kacalidas është voluminoz, me njëzet e katër përmbledhje poetike, dy përmbledhje me tregime dhe pesë romane, një tregues ky që e bën atë zërin më përfaqësues të brezit të tij, i cili, duke u zhvendosur në Greqi, nuk kishte nevojë të përshtatej me mënyrat e të shkruarit të letërsisë bashkohore greke për të fituar identitet. Ai e kishte këtë identitet që nga gjeneza, e solli si trashëgimi shekullore të gjuhës greke që jo vetëm nuk ishte e tjetërsuar, por dhe nuk pati frikë të komunikonte me mjedisin më të gjerë gjuhësor dhe gjuhët e tjera, në këtë rast me gjuhën shqipe. Kacalidas nuk vjen në Greqi t'u lutet për njohje “qarqeve autoritare letrare”, në fund të fundit, këtë njohje e kishte nga vendi ku jetoi dhe u rrit, pasi solli me vete vlerësimet dhe nderimet e të madhit Ismail Kadare dhe personaliteteve të tjera të letërsisë shqipe. Ai nuk erdhi si një “zog ekzotik” për të treguar krahët me pendë zbukurose që të zgjonte interesimin e letrave neohelene urbane të Athinës. Nikos Kacalidas sjell një krijimtarë dinjitoze që e shpalos mu në mes të ditës me diell në sheshmejdani letrar të shkrimtarëve më të shquar ballkanikë, në kalimin nga shekulli i 20-të në shekullin e 21-të. Aty është pozicioni i vërtetë i Nikos Kacalidas dhe aty ai do të klasifikohet nga studiuesit e mëvonshëm. Në hapësirën e gjerë të kodikut letrar ballkanik dhe në diversitetin e tij, duke përfaqësuar kështu një cilësi exelente të shpirtit grek, ashtu siç e ka trashëguar jo vetëm nga të moshuarit e vendlindjes apo nga babai folklorist por edhe nga shkrimtarët përfaqësues modern grek që ai përktheu në gjuhën shqipe para ardhjes së tij në “Klinon asti- Qytetin e famshëm”.

Kjo është ajo që e bën veprën e tij të rëndësishme, e kompletuar me të gjitha tiparet e saj. Sa herë para se të marr në dorë përmbledhjen e re poetike të Kacalidas, pyes veten se ku do ta vendosë pikën e fundit në këtë prodhim imazhesh mjeshtërore... Mbase do të pyes veten derisa të përfundojnë ato “urdhërimet e mbrëmësore”...



Të premtën e të shtunën e kaluar, më 29 dhe 30 prill 2026, një kuintet harqesh që herë transformohej në kuartet, herë në trio, e herë në duo, dhanë dy koncerte në dy ambiente jo posaçërisht koncertorë, por duke i kthyer këto ambiente në një kupolë rezonance tingëllimi të mahnitshme. Pra nuk ishin sallat por loja e këtij ansambli mjeshtëror që bënë që ai publik i posaçëm të mos pipëtinte për gjatë gjithë ekzekutimit, madje edhe ndonjë e kollitur e veçuar që edhe pritej të ndodhte, në këtë koncert çdo gjë duke si e ngrirë. Ishte magjia e muzikës që përçoehej.

Programi i të premtës përmbante një repertor disi jo të zakonshëm për një mbrëmje me muzikë dhome. Jo të zakonshëm në kuptimin e ndërthurjes të programit mes muzikës barrok të Bach-ut dhe ato të hungarezit György Kurtág (lindur më 1926), amerikanit John Cage (1912-1992), greko-francezit Iannis Xenakis (1922-2001), dhe austro-çekut Erwin Schulhoff (1894-1942). Të katër këta kompozitorë janë emra të njohur të muzikës bashkëkohore të shekullit XX. Nuk kishte si të përzgjidhej më pëlqyeshëm për të përfshirë një gamë kaq të gjerë kompozitorësh perëndimorë, me stilet e tyre të veçantë, sa tipike për gjithsecilin aq dhe përgjithësuese për vendet që përfaqësonin. Në se Bach-u u prezantua jo me muzikën e tij përfaqësuese për harqe siç janë Koncertet Brandenburg-eze e të tjera vepra shumë të njohura të kësaj fushe, por me dy korale të përshtatura për kuartet harqesh, të cilat ishin arranzhuar me një profesionalizëm të shkallës së lartë, por që arranzhuesi kishte preferuar të mbetej anonim.

Ndërkohë, Kurtág me veprën e tij "Signs, Games and Messages" për trio harqesh, u transmetua me një delikatesë të skajshme nga ana e Abigél Králik (violinë), Timothy Ridout (violë) dhe Timotheos Gavriilidis-Petrin (cello) duke nxjerrë në pah jonet e Bartók-ut e Webern-it, vepër që u karakterizua nga loja e ngjeshur dhe forca e tingullit për t'i lënë vend frymëmarrjeve dhe pauzave aq shprehëse e aq të ndjera.

John Cage me kuartetin e tij "Quietly Flowing Along" luajtur këtë radhë nga Abigél Králik, Jonian Ilias Kadesha (violinë), Timothy Ridout dhe Timotheos Gavriilidis-Petrin, shpalosën, nga njëra anë, një lojë të ndezur deri në hipnozë që ndërkohë evokonte ndjesi të muzikës mesjetare, e pleksur kjo, nga ana tjetër, me nuanca filozofike të përcjella me një qetësi gati olimprike emocionale.

Dhipli Zyia nga Iannis Xenakis ishte vepra e shkruar më 1951 që u transmetua nga një duo instrumentale, violinë dhe cello, Jonian Ilias Kadesha dhe Vashti Hunter (cello). Është nga veprat e hershme të aq të njohurit Xenakis, aq shumë e frymëzuar nga tradita ballkanike dhe stilet folklorike të udhërrëfyesit Béla Bartók. Dhe nuk kish se si që Joniani dhe Vashti mos e ndjenin deri në qelizë këtë muzikë me modet e saj vendore dhe me ritmikën aq

## LOJË MAHNITËSE E NJË KUINTETI HARQESH NË TIRANË

Nga Dr. Eno Koço



përfaqësuese të gadishullit ku jetojmë. Loja e tyre u kthye në një ndjesi rrenqethëse.

"Pesë pjesë për kuartet harqesh" (1923) ishte vepra gjithplanëshe e Erwin Schulhoff, që me vetëdije instrumentistët e kishin lënë për në fund. Kuarteti u luajt nga Jonian Ilias Kadesha, Abigél Králik, Timothy Ridout dhe Vashti Hunter. Vepra të jepte një kënaqësi të vërtetë emocionale dhe intelektuale. Ndjehehin në të gërshetimet e vallëzimit barrok me muzikën folk të viteve 1920. Vepra i është kushtuar kompozitorit francez Darius Milhaud dhe shfaq një gjendje të veçantë pleksjesh mes modernizmit dhe gjuhës aq personale të Schulhoff-it. Kuarteti i instrumentistëve shpalosi tërë atë arsenal ndjenjash, larmie tingëllimi që nga pianissimo-t sugjestionuese deri tek fortissimo-t aq të fuqishme e madhështore.

Koncerti tjetër i një nate më pas, në një tjetër sallë e me një tjetër akustikë tingëllimi më pak rrethore (rotonde), shpalosi dy vepra

nga më të fuqishmet e muzikës për kuartet të kompozitorëve Anton Arenski dhe Franz Schubert.

Kuarteti Nr. 2 në La minor, Op. 35 (1894) i Anton Arenskit njihet të jetë homazhi me aq përkushtim ndaj mentorit dhe mikut të tij të ngushtë, Pjetër Iliç Çajkovski. Është kompozuar në mënyrë të pazakontë për një kuartet, kësaj për violinë, violë dhe dy violonçela (në vend të dy violinave). Ku më mirë se këtij ansambli muzikantësh i përshtatej ky formacion. Që të pestë tingëllonin si një qenie e vetme, me timbrikë të barabartë, me balancë të barabartë, me ndjesi të barabarta, një tingëllim të tillë kisha kohë që nuk e kisha ndjerë. Koha e parë, Moderato, përçoi më së bukuri tingëllimin e kuartetit, me atë atmosferë sa të zymtë aq dhe solemne. Një psalm karakteristik kishtar, me ton funerali, që Arenski qe aq i përkushtuar gjatë gjithë jetës së tij. Roli i dy violonçelave në këtë kuartet


ishte si për të theksuar ato baset apo tonet e thella aq karakteristike për korale ruse. Koha e dytë përbëhej nga variacione mbi një temë, Legjenda, të Çajkovskit. Kjo kohë, mund të thuhet, ishte qendra emocionale e të gjithë kuartetit. Koha e tretë, Finale (Andante sostenuto – Allegro moderato) të rikujton atmosferën e zymtë të fillimit, për tu shndërruar më pas në mënyrë dramatike në një atmosferë të fuqishme të një kënge popullore ruse. Loja e të katër muzikantëve ishte sa e gjallë e virtuozë aq dhe e kontrolluar në atë tingëllim të mirëfilltë simfonik orkestral.

Koncerti i dytë përfundoi më veprën aq madhështore të Franz Schubert-it, Kuintetin për harqe në Do maxhor. Këtë radhë që të pestë ishin pjesëmarrës me të njëjtën vepër, nisur nga Jonian Ilias Kadesha, Abigél Králik, Timothy Ridout, Timotheos Gavriilidis-Petrin dhe Vashti Hunter. Pesë muzikantë të një potence muzikore me të vërtetë të lartë, të standardeve europiane, botërore. Ky kuintet i Schubert-it njihet si nja nga kryeveprat më të mëdha të muzikës së dhomës. Vepra përshkohet nga shtjellimi i vazhdueshëm emocional dhe bukuria sublime lirike. Që të pestë muzikantët ishin sa në kontroll të tingullit aq edhe shpërthyes si për të krijuar atë gjendje emocionale diku midis ankthit dhe ekstazës. Që në Kohën e parë muzikantët dhanë një tingëllim sa të brendshëm aq dhe triumfues, ku akordet misterioze spikasin në mënyrë të veçantë. Koha e dytë, Adagio, u përçua me solemnitetin e natyrës së himnit, kaq i nevojshëm për këtë muzikë dhe që njihet si nga më të veçantat e muzikës klasike. Koha e tretë, Scherzo: Presto – Trio: Andante sostenuto, u përshkua nga një energji e pashoqe. Koha e katërt, Finalja, Allegretto, me një karakter të fortë hungarez por edhe cigan, u shqua nga shpërthime të befta e ritme nxitëse të vallëzimit. Ndjehej në të edhe sharmi elegant vjenez ku që të pesë instrumentistët shpalosën anën më të kultivuar të kulturës interpretuese duke qëndruar me aq shije në akordin aq të njohur disonant për të përfunduar qëndrueshëm në tonalitetin bazë të veprës.

Ndjesë për këtë shtjellim kritik tepër teknik muzikor të këtyre dy koncerteve por e gjeta të udhës të ishte e vetmja mënyrë të mund të evidentoja privilegjin e rrallë që patëm të dëgjoni një koncert të tillë.



Jonian Ilias Kadesha dhe Vashti Hunter



Abigél Králik



Timotheos Gavriilidis-Petrin



Timothy Ridout

Në historografinë e letërsisë shqipe në përgjithësi dhe në atë të Maqedonisë së Veriut, në veçanti, Resul Shabani përfaqëson një nga instancat më komplekse dhe më të konsoliduara të modernitetit estetik. I cilësuar shpesh si një krijues polivalent apo “katërdimesional”, Shabani refuzoi skematizmin linear të letërsisë së angazhuar ideologjikisht, duke ndërtuar një opus që shtrihet me të njëjtën peshë specifike në poezi, tregim, roman dhe dramaturgji.

Ndryshe nga bashkëkohësit e tij që i binden progresionit tradicional (nga poezia e rinisë drejt prozës së pjekurisë), sistemi krijues i Resul Shabanit funksionon përmes një inveri dhe ndërvarësie të zhanreve. Siç dëshmon vetë autori, kalimi nga një gjini në tjetrën nuk ishte çështje eksperimenti, por një domosdoshmëri e diktuar nga thellësia e vetëdijes artistike dhe shkalla e përpunimit të materialit jetësor.

### Memoria e ujit dhe shtrati i fëmijërisë

Zanafilla shkrimore e Resul Shabanit lidhet në mënyrë të pashmangshme me prozën e shkurtër. Debutimi i tij me tregimin “Bamirësia” (1963) në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, nuk shënoi thjesht hyrjen e një emri të ri në dyert e letrësisë, por fillesën e një gjeografie mitike që do të dominonte gjithë imagjinarin e tij: Kalishti i Strugës, Liqeni i Ohrit dhe lumi Drin.

Në vëllimet me tregime si “Liqeni” (1974), “Shën” (1978) dhe “Qerpik i lagur” (1994), Resul Shabani operon me atë që Ali Aliu, e quan “bosht tematik unik”. Për Shabanin, toponimia nuk është thjesht dekor gjeografik, por strukturë identitare. Lidhja e tij me Kalishtin merr përmasa ekzistenciale, e ngjashme me raportin e Gabriel García Márquez-it me Macondon apo të Ernest Hemingway-t me Kilimanxharon.

Uji në tregimet e tij nuk vjen si element pasiv, por si një personazh mistik, ruajtës i memories kolektive dhe dëshmitar i tranzicioneve të dhimbshme shpirtërore të njeriut liqenor. Në prozën e tij të shkurtër, realizmi i ngjarjeve shkrihet me reflektime të thella psikologjike, ku individit përballet me humbjen e të vjetrës dhe melankolinë e pakthyeshmërisë së kohës.

### Amalgama e lirikës dhe ironisë intelektuale

Nëse proza kërkonte shtrirje dhe strukturim të rreptë, poezia për Shabanin vjen si një “shkarkim emocional”, një ngacim i çastit dhe një “dhimbje dhëmbi për shpirtin”. Por, kjo lirikë nuk bie kurrë në klishe sentimentale apo në patos romantik, ajo ndërtohet si një amalgamë e brishtësisë njerëzore dhe ironisë apo protestës sociale e politike, siç mund ta vërejmë në vëllimet e tij politike: “Peshk” (1975). Kjo përmbledhje vazhdon linjën e frymëzimit ujqor. Përmes metaforës së peshkut, autori ndërton reflektime hermetike mbi izolimin, lirinë e kufizuar dhe mbijetesën e individit në një mjedis shtypës. “Hamleti me plis të zi” (1978). Përfaqëson një nga kulmet e poezisë shqipe në këto hapësira. Shabani realizon një gërshetim gjenial të mitit universal shekspirian me tragjedinë dhe dilemat historike të shqiptarit. Plisi i zi shndërrohet në një simbol të revoltës klandestine dhe të ruajtjes së identitetit nën sisteme asimiluese. “Ora e liqenit” (1983) dhe “Oh, Amerika” (1989). Shënojnë pjekurinë e plotë poetike. Ndërsa e para mediton mbi kohën dhe kalueshmërinë, e dyta pasqyron përplasjen kulturore të shkrimtarit ballkanik me botën e jashtme, duke sfiduar izolimin politik të kohës.

Në rrafshin e modelit jetësor dhe

# Gjeografia mitike dhe zhanret polivalente në opusin e Resul Shabanit

Nga Emin Azemi

Resul Shabani nuk i takon modelit tradicional të shkrimtarit që eksperimenton kalimthi në gjini të ndryshme. Sistemi i tij krijues dëshmon se kalimi nga një zhanër në tjetrin ka qenë një domosdoshmëri e vetëdijshme intelektuale. Siç e vërteton edhe trajektorja e tij (ku proza e shkurtër parapriu poezinë), ai përdori poezinë si shkarkim lirik e emocional, ndërsa prozën e gjatë dhe dramën si struktura të rrepta arkitektonike që kërkojnë pjekuri, kulturë të gjerë dhe fakte historike, duke refuzuar çdo lloj improvizimi.

poetik, Shabani pranon hapur se idhulli i tij është Lasgush Poradeci. Madje Zija Çela e quajti “nxënës i Lasgushit”. Kjo lidhje manifestohet jo vetëm në përpjekjen për t’i ngjasuar në poezinë liri-liqenore, por edhe në sjelljen e tij publike, që rezultojnë në një izolim të vetëdijshëm, një kursim i skajshëm nga daljet publike dhe zhurma mediatike, duke zgjedhur elitizmin përballë popullaritetit komercial.


### Romani modern dhe dendësimi i kohës narrative

Me romanin “Dashuria e kapitenit” (1983), Resul Shabani solli një model të ri të prozës së gjatë, larg linearitetit klasik dhe skemave të realizmit socialist. Romani, i cili pati një sukses të jashtëzakonshëm

(i ribotuar rreth tetë herë, i përfshirë në programe shkollore dhe i përkthyer maqedonisht), dëshmon aftësinë e autorit për të menaxhuar një kohë narrative tejet të dendësuar, të bazuar në reminishenca dhe monologë të brendshëm.

Në rrafshin tematik, romani operon mbi dy kontraste të mëdha brenda konfliktit filozofik të luftës. Përmes dy personazheve autentike – Profesorit dhe Kapitenit – autori ballafaqon dy koncepte mbi luftën për çlirimin e Strugës. Profesi mbron tezën se lufta bëhet kudo dhe me çdo mjet, ndërsa Kapiteni (një oficer mbretëror) beson se lufta duhet bërë në mënyrë të kufizuar, vetëm brenda hapësirës së Strugës.

Në rrafshin psikologjik, romani guxon të analizojë dhe të thyejë një tabu shoqërore të mjedisit ballkanik: mitin apo konceptin e ngurtë se dashuria merr fund me aktin



e martesës. Përmes një gjuhe të pasur, ku ndërthuren stili lirik dhe ai dokumentar, romani dëshmon se si proza e gjatë kërkon kulturë të lartë dhe strukturim, duke mos lejuar asnjë lloj “kamufli” apo improvizimi krijues.

### Dramaturgjia si rebelim

Vëllimi dramaturgjik “Anija e vjetër” (1982) shënon ndoshta pikën më të guximshme të karrierës letrare të Resul Shabanit, duke futur në teatrin shqiptar frymën e parë të modernizmit dhe pluralizmit të ideve nën një regjim totalitar. Libri, i ndërtuar mbi dy drama simbiotike, funksionon si një kritikë e ashpër ndaj sistemeve politike.

Për shkak të censurës dhe autocensurës së egër në Maqedoninë e asaj kohe, Shabani në dramën “Shi në Uertomonto”: përdori të ashtuquajturën “gjuhë të Ezopit”. Ai e vendosi ngjarjen artificialisht në Kili, gjoja për të kritikuar diktaturën e Augusto Pinoçetit dhe për të mbrojtur figurën e Pablo Nerudës. Megjithatë, aluzioni i vërtetë dhe shigjetat e dramës i drejtoheshin pushtetit absolut të kohës kur u shkrua drama.

Për t’u mbrojtur nga linçimi dhe arrestimi i mundshëm, Shabani përdori një strategji inteligjente: insistoi që regjisori i shfaqjes të ishte Vladimir Milçin. Inskenimi i vitit 1986 në Teatrin e Kombësive në Shkup pati një sukses monumental, duke u konceptuar si një shfaqje-film që triumfoi në Festivalin Federativ të Sarajevës.

Ndryshe nga makro-politika e dramës së parë, “Monotonia” zhvendoset në rrafshin mikro-ekzistencial. E ndikuar qartë nga Teatri i Absurdit (Beckett dhe Ionesco), drama trajton tjetërsimin e njeriut modern, rutinën si burg dhe paaftësinë e individëve për të komunikuar sinqerisht. Dialogët janë eliptikë, aksioni klasik mungon dhe koha duket e ngrirë, duke pasqyruar zbrastërinë shpirtërore të epokës.

### Dikotomia mes lirikës dhe dramatikës në prozë

Përtej ndarjeve klasike gjinitore, proza e Resul Shabanit funksionon si një hapësirë ku lirikja dhe dramatikja shkrihen organikisht, duke formuar një tekst të dendur ekzistencial dhe estetik.

Në rrafshin lirik, rrëfimi i tij ndërtohet mbi premisat e një “proze ujore” plot ndjeshmëri e nuanca lasgushiane. Gjuha e pasur me metafora, ritmi i brendshëm i fjalisë, melankolia e pakthyeshmërisë së kohës dhe evokimi i kujtimeve të fëmijërisë buzë Liqenit të Ohrit, e ngrenë tekstin narrativ në sferën e një poeme të pastër në prozë. Uji këtu nuk përshkruhet si dekor, por përjetohet si gjendje shpirtërore.

Në rrafshin dramatik, Shabani aplikon përvojën e tij si dramaturg duke injektuar tension, mprehtësi dhe peshë ekzistenciale brenda rrëfimit. Ky tension nuk buron nga aksionet e jashtme fizike, por nga konflikti i brendshëm filozofik dhe thyerjet shpirtërore të personazheve (siç dëshmohej në



dialogët eliptikë dhe monologët e mprehtë te “Dashuria e kapitenit”). Personazhet e tij ballafaqohen me ankthin e plakjes, dështimet e pariparueshme jetësore dhe tabutë e thyera intime në hapësira narrative tejet të dendësuar dhe të kufizuara.

Rrjedhimisht, kjo simbiozë inventive bën që proza e Shabanit të zotërojë shpirtin dhe ritmin e një poeti, por tensionin, konfliktin dhe strukturën e rreptë arkitektonike të një dramaturgu, duke u ofruar lexuesve një përvojë leximi thellësisht intelektuale dhe shumështrësore.

### Krijuesi si rob i iluzionit

Profilizimi i Resul Shabanit si poet, tregimtar, romancier dhe dramaturg zbulon një autor që refuzoi në mënyrë të prerë folklorizmin dhe rrugën e lehtë të artit populist. Filozofia e tij krijuese përmbledhet në konceptin e tij mbi shkrimtarin si një “rob i iluzionit”. Shabani e sheh shkrimin si një mallkim fisnik, një shtysë të brendshme që i ngjan një droge apo bixhozi shpirtëror.

Edhe pse me një skepticizëm intelektual ai pranon se arti nuk ka fuqi të ndryshojë vendimet e qeverive, bankave apo gjykatave, ai vazhdon të krijojë me besimin e palëkundur se letërsia ka një mision më të lartë: të fisnikërojë dhe të zbutë shpirtin e egërsuar të lexuesit. Përmes kësaj qasjeje elitare, opusi i tij mbetet një nga monumentet më solide të letërsisë moderne shqipe.

### Resul Shabani në dioptrinë e kritikës letrare

Receptiviteti kritik mbarëshqiptar i Resul Shabanit e përcakton atë si një autor të rretheve të larta intelektuale dhe akademike, i cili gëzon një njohje elitare kudo në hapësirën kulturore kombëtare. Në Shqipëri, ai vlerësohet si një mjeshtër i kanonit letrar, veprat e të cilit botohen nga shtëpi prestigjioze si “Onufri” dhe analizohen në media elitare si revista ExLibris. Për shkak të natyrës së tij të tërhequr dhe modelit të jetës lasgushiane, Shabani ka refuzuar me vetëdije popullaritetin komercial për t’i qëndruar besnik estetikës së kulluar. Ndërkaq, kritika letrare (Ali Aliu, Visar Zhiti, Zija Çela, Bujar Hudhri, Ramadan Musliu, Ymer Çiraku, Salajdin Saliu, Ahmet Selmani etj.) dhe shtëpitë historike si “Rilindja” e Prishtinës e kanë radhitur atë ndër pararojat e modernitetit shqiptar. Ndërkaq, në rrafshin e receptivitetit kritik dhe teatrogjik maqedonas, Resul Shabani trajtohet si një autor kanonik dhe integral, vepra e të cilit i kapërcen kufijtë e letërsisë së një komuniteti. Në sferën e skenës teatrore, korifejtë e kritikës si Liljana Mazeva, Ivan Ivanov dhe Petar Bagevski e vlerësuan dramaturgjinë e tij (të inskenuar nga Vladimir Milçin) si një thyerje moderne të klisheve teatrore dhe një pararojë të guximshme intelektuale. Paralelisht, akademikë dhe studiues të përmasave të mëdha si Mateja Matevski, Georgi Stardelov, Vele Milevski, Sande Stojčevski, dhe Natasha Avramovska kanë analizuar me admirim pjekurinë e tij zhanrore, strukturën moderne të romanit “Dashuria e kapitenit” dhe “metaforikën ujore” të lirikës së tij.

### Resul Shabani si ndërtues i “urave gjuhësore”

Në historinë e marrëdhënieve kulturore në rajon, Resul Shabani nuk u mjaftua me statusin e konsumatorit pasiv të gjuhës amtare, por e projekttoi përkthimin si një mision jetik strategjik, të orientuar drejt thyerjes së izolimit kombëtar dhe ndërtimit të urave të komunikimit estetik ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase.

Sipas të dhënave dokumentare, volumetria e punës së tij dypalëshe është mbresëlënëse: ai ka përkthyer dhe botuar mbi 20 tituj nga letërsia maqedonase në shqip dhe rreth 20 tituj të tjerë nga letërsia shqipe në gjuhën maqedonase. Kulmi i këtij angazhimi akademik konsiderohet përkthimi i dy teksteve themeltare të memories sonë estetike: “Antologjia e poezisë maqedonase” (me autor G. Todorovski) dhe “Antologjia e poezisë shqipe” (me autor akademikun Ali Aliu). Përmes këtyre botimeve, Shabani dëshmoi se nuk operon me një përkthim thjesht mekanik apo gjuhësor, por me një rikrijim artistik ku ruhen të paprekura ritmi, metafora dhe liria e brendshme e vargut origjinal.

Për më tepër, ky kontribut merr përmasa të diplomacisë kulturore ndërkombëtare përmes angazhimit të tij të kahershëm në Këshillin Drejtues të festivalit të madh “Mbrëmjet Strugane të Poezisë”. Shabani shërbeu si shtytësi dhe organizatori kryesor për ndërkombëtarizimin e zërave më të fuqishëm të letërsisë nga Shqipëria dhe Kosova. Puna e tij me përkthimet e poezive të Fatos Arapit brenda strukturave të festivalit i hapri rrugë këtij të fundit që më vonë të nderohej me çmimin e madh “Kurora e Artë”. Po ashtu, realizimi i “Natës së Poezisë së Shqipërisë” në vitin 1996 mbetet një stacion historik i unifikimit shpirtëror mbarëkombëtar. I nderuar me titullin “Mjeshtër i Përkthimit” nga Shoqata e Përkthyesve Letrarë, Resul Shabani konfirmohet në rrafshin e përgjithshëm si një arkitekt i shquar i dialogut ndërkulturor në Ballkan, duke vërtetuar se arti i vërtetë mund të shpërbëjë muret politike përmes fuqisë së fjalës së përkthyer.

### Një begati e palëkundur vlerash

Opusi mbi gjysmëshekullor i Resul Shabanit qëndron si një nga shtyllat më solide dhe më elitare të letërsisë moderne shqipe në rajon. Përmes një vetëdijeje të lartë estetike, Shabani arriti të operojë si një shkrimtar plotësisht katërdimensional: si poet subtil i dritëhijeve njerëzore, si tregimtar i lidhur organikisht me gjeografinë mitike të ujit, si romancier i modelit modern të thyerjeve psikologjike dhe si dramaturg i guximshëm që sfidoi klisheet teatrore dhe censurat e egra politike. Si autor ai ka arritur të përmbushë misionin më të lartë të letërsisë – të kapërcejë kohën, të thyejë kufijtë politikë dhe të fisnikërojë shpirtin njerëzor, duke lënë pas një begati të palëkundur vlerash për brezat që vijnë. Në koordinatat e përgjithshme të letërsisë së gjithmbarshme shqipe, Resul Shabani vendoset me dinjitet si një nga përfaqësuesit më të konsoliduar të modernitetit estetik, duke e kapërcyer kornizën e një autori rajonal për t’u integruar plotësisht në kanonin letrar kombëtar. Pozicioni i tij përcaktohet nga një “katërdimensionalitet” i rrallë, ku ai kontribuoi njëkohësisht në mbajtjen gjallë të frymës avangarde përmes botimeve historike në Prishtinë e Tiranë, duke shërbyer si urë unifikuese e hapësirës sonë kulturore. Si vazhdues i traditës së madhe të “letërsisë ujore” të nisur nga Lasgush Poradeci, Shabani e universalizoi kultin e liqenit, ndërsa në dramaturgji u shqua si pionier i Teatrit të Absurdit dhe gjuhës aluzive, duke shkruar disa nga tekstet më të guximshme antifataliste të shekullit XX. I vlerësuar nga figura të shquara (Visar Zhiti) si një udhëtar i thellë shpirtëror, Resul Shabani zë një vend nderi si “shkrimtar i shkrimtarëve” në historinë e letërsisë shqipe, duke mbetur një dëshmitar i lartë i estetikës së kulluar dhe një diplomat strategjik i urave ndërkulturore në Ballkan.

Shkup, fillim-qershor 2026

# KLARA KODRA

## Samantës

Poezi

Në 20-vjetorin e lindjes

Ti je në një vend larg  
Që i thonë Rumani  
Që flet një gjuhë latine,  
Po ti anglisht veç di.

Anglishtja është gjuhë zogjsh.  
Kush e ka thënë? S’e di.  
Jona veç është gjuhë shqipesh.  
Ma thanë në fëmijëri.

Jona është veç gjuhë shqipesh,  
Po e rrallë për çudi.  
Është e bukur dhe e lashtë.  
Këtë gjë mirë e di.

Si zogj kanë fluturuar  
Nga vendi ku je ti  
Njerëzit flatratrishtuar  
Dhe lanë pas mërzi.

Ti po mëson shumë gjëra,  
Po se ç’ke një mërzi.  
Mos u mërzi, o shpirt.  
Ke një thesar.....S’e di?

Ke një thesar të çmuar.  
Çfarë? Tënden rini  
S’duhet ta prishësh kot.  
Pra, vlerësoje ti.

Ti s’ke pse të mërzitësh,  
Ke rininë flori  
Çdo çast është një monedhë.  
Mos e shpenzo kot ti.

Për ditëlindje dhuratë  
Të çoj këtë poezi.  
Valët e internetit  
Po e çojnë tek ti.

Është një dhuratë e vogël,  
Veçse nuk ka kufi  
Diçka që e shtrydh nga zemra  
Dhe e quajnë dashuri.



Emri i poetit Ilirian Zhupa u shfaq në horizontin letrar, në vitet '80 të shek. XX, kur ai, së bashku edhe me poetë të tjerë si: Petrit Ruka, Qazim Sheme në Jug, apo Hamit Aliaj, Skënder Buçpapa në Tropojë, Visar Zhiti në Lushnje, sapo kishin kryer studimet e larta, në Institutin Pedagogjik të Shkencës dhe atë të Tiranës.

Krijimtaria e tij poetike e begatë përfshin në gjirin e vet vëllimet poetike: **"Diell mbi kaskadë"** 1978, **"Poezi"** 1985, **"Mos më pyet ku kam qenë"** 1988, **"Pema e ëndrrës"** 1990, etj, por edhe mjaft cikle poetike të botuara në gazetata "Zëri i Rinisë", "Drita", revistën "Nëntori", por edhe në Prishtinë, Shkup, Ulqin e Tetovë.

Ashtu si poezia e poetëve tanë të shquar, Migjeni, Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapi, por edhe ajo e Xhevahir Spahiut, Ndoc Gjetjes, Bardhyl Londos e Hiqmet Meçes, edhe poezia e Ilirian Zhupës dhe brezit të vet, u bë vazhduese e këtij moderniteti, duke sjellë një frymë ekzistenciale për poezinë bashkëkohore shqipe.

Ilirian Zhupa është një zë origjinal në poezinë bashkëkohore shqipe, me një vetëdije estetike të hollë dhe vargu i tij është i qëruar nga tepritë, një varg i derdhur, i gdhendur, i cili reflekton edhe një strukturë të ngjeshur të poezisë së tij. Poezia e tij sjell në spikamë gjithashtu, një kujdes të natyrshëm për fjalën e mençur, e cila ngjiz vargun me fuqinë e saj që ndihet menjëherë. Ilirian Zhupa nuk e tepron me kërkime formaliste, ai gjithmonë formën e shikon si përsosmëri të fjalës dhe të strukturës së vjershës, ndaj poezia e tij bie në sy menjëherë, duke na treguar një poet të pjekur që nuk e tepron, qoftë edhe me sasinë e botimeve të tij, të cilat nuk janë të shumta, po të llogarisim një periudhë të gjatë mbi dyzetvjeçare që ai shkruan.

Ky kujdes dhe kjo mosngutje nuk është e re në poezinë tonë. Mjeda dhe Lasgushi nuk u ngutën të botonin, përveçse një apo dy libra, ata ishin ekzigentë ndaj artit, ndaj fjalës poetike dhe ndoshta kishin parimin se cilësia mbetet sasi dhe jo e kundërta. Në këtë klasifikim poetësh, hyn edhe emri i poetit Ilirian Zhupa, i cili është kujdesur në dekada të botojë pak, por të mbetet një emër me peshë në poezinë e sotme shqipe. Ky refleksion të imponohet menjëherë teksa lexon edhe vëllimin e tij **"Mos më pyet ku kam qenë"** -një libër prej 130 faqesh.

Libri i çdo poeti është në njëfarë mënyre edhe një pasqyrë ku shihet jeta e tij, karakteri, përvoja, mençuria, formimi apo prirjet e tij intuitive. Ilirian Zhupa, si poet i viteve '80, siç e thotë vetë, i shpëtoi "morsës së socrealizmit", duke iu bindur vetëm zërit të brendshëm të tij dhe duke e pasur të qartë se poezi e mirë nuk mbetet poezia e rrethanave apo e jehonave të kohës ideologjike, por poezia që i këndon atdheut, dashurisë, lumit, detit, natyrës, njeriut, bukurisë së shpirtit njerëzor, pasi modat e kohërave ndryshojnë, por vetëm këto fjalë nuk vishen me modë, ato vishen vetëm me hijeshinë e shpirtit dhe filozofinë e zbrërthimit të kuptimit të jetës, që e mbartin vetiu në indin e tyre.

"Mos më pyet ku kam qenë" është një titull provokues, ai mbart vetiu bredhjen e poetit nëpër zonat e bukura të imagjinatës, faktin e krijimit të poezisë në një kohë, në të cilën ajo u krijua, dhe ja, poezia mbetet krenare se, pavarësisht nga koha kur u krijua, ai mundi ta ruajë identifikimin e saj human dhe estetik në pëlqyeshmërinë e këndshme të kohës së mëvonshme. Për poezinë e Ilirian Zhupës, Sadedin Mezuraj, shprehet: **"Subjekti lirik zbulon identitetin e tij"** (Gazeta ExLibris-21 shkurt 2026). Po në të vërtetë, si vjen dhe materializohet lirika në poezinë e Ilirian Zhupës, kjo të bën me dije faktin se ai ndërton një filozofi të jetës përmes ndjeshmërisë dhe fjalës së zgjedhur e të mençur. Kjo në këndvështrime të holla dhe në zbulime detajesh shpërfaqet si rezultat

## Poezia e Ilirian Zhupës si përgjegjësi ndaj fjalës së zgjedhur artistike

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe



i përvijës poetike dhe intuitës artistike të poetit.

Siç e kanë theksuar kritikë dhe studiues të tjerë, poeti Ilirian Zhupa është një krijues i kërkimeve ekzistenciale dhe kjo, përcakton një fakt të dukshëm, që vetiu i imponohet çdo lexuesi apo studiuesi, që merret me poezinë e tij. Ai e vendos qenien e njeriut (të tij) në raport me atdheun, me vendlindjen (Baladë për Vjosën dhe për vete), me njeriun e punës, me rritjen (kalimin e kohës si proces), me dashurinë. Qenia që zbrërthet nëpërmjet vargjeve të tij dhe njëkohësisht trajtësohet e përmbajtësohet, është një qenie që vazhdimisht mbushet me dashuri dhe admirim ndaj atdheut, ndaj dashurisë, fëmijërisë, ndaj bukurisë së vajzës, me vlerat e fjalës.

Kjo botë perceptuese e poetit është e gjallë, e fortë, e butë, e përmbajtur, e arsyetuar pa rënë në cerebralizëm dhe ftohtësi, duke shpalosur aspekte të të përmbajturit shpreh tek ky poet autofrenimin e lavdërueshëm për të mos thënë gjëra pa vlerë. Duke e parë botën me sytë e poetit, ai lartëson të bukurën e saj, por edhe evidenton përmes këtij syri atë çfarë nuk shkon, çfarë është e ftohtë, e zgavërt, jo njerëzore, jo përfshirëse siç është, për shembull, poezia antologjike "Manekinet".

Si poet me një un poetik të thellë e me fjalë të kulturuar, ai kërkon kuptime të ndryshme për të ngritur lart ato vlera të njeriut që e lidhin atë me të bukurën, me botën, me njerëzit, sepse asgjë njerëzore nuk mbetet e huaj për poetët, veçmas për poetët e mirë. Për të, fjala ka shumë rëndësi, ajo nuk humbet kur evidentohet saktësisht, ajo shpërdorohet kur lëshohet rastësisht, prandaj, në rrjedhën e kësaj aksiome, këtë poet mund ta quajmë poet të fjalës.



Poezia e Ilirian Zhupës: **"Besomë dhe urremë te fjala"** mund të merret si kredo e fortë poetike, estetike, kredo që nuk është tronditur nga rendja dhe mania për t'u bërë interesant nëpërmjet zhurmës a lojës së fjalës. Si një gur i gdhendur, i vendosur në qoshe të rrugës së mendimit, ajo i bëhet pengesë këtij mendimi që të përmblihet te forca e tij dhe të mbahet mend: **"Nëse pe në të shkëndijën e zjarrit/kur nata s'ka yje dhe drita përreth/nëse t'u shfaq te mugullimi i barit/dhe pemën e ëndrrës ta veshi me gjeth./ besomë te fjala"**. Po kështu, te poema **"Qielli im"**, duke gdhendur me mjeshtëri fjalën, poeti shpreh një botë të thellë poetike ekzistenciale, e cila tashmë zë vend të nderuar në poezinë shqipe.

Fjala në poezinë e Zhupës nuk është vetëm njësi leksikore-semantike, por siç shihet në këto vargje, ajo mban në përbrendësi: gjallëri, identitet, rrezatim mirësie, njomësi natyre, begati, shpresë, afim e shumë të tjera, të cilat duke u shprehur përmes zgjedhjes së saj shkojnë deri te përkufizimi i artit të fjalës. Zhupa është një poet që e peshon fjalën mirë, sepse ia di rëndësinë dhe kjo prirje dhe ky kujdes ndihet gjithandëj në poezinë e tij të ngjeshur me mendim dhe të skalitur në gdhendje të fjalës, e cila rri komode në follenë kuptimore dhe ndiesore të saj.

Poezia e Ilirian Zhupës dallohet për përzgjedhjen elegante të elementeve të peizazhit. Natyra në poezinë e tij nuk përshkruhet siç shihet, por siç ndjehet, kuptohet, përmes një ndjeshmërie të hollë: **"Kaloi nëpër fusha e marr blerimin e qumësht të kallëzës/kaloi në shtigje e marr shëmbëllesën e gurit dhe cfakës/kaloi nëpër mbrëmje e marr fërgëllimën e shtatit të vajzës/që dridhet si gjuhëza e flakës"**. Poeti më tepër merr efektin e elementeve peizazhorë, jo si qëllim për t'i evidentuar ato, por si mundësi për të krijuar paralelizma figurativë që krijojnë gjendje.

Kështu këto elemente çojnë pastaj në mundësi për të krijuar asosacione apo për ta përhapur imagjinatën në shenjëzime të caktuara, që nganjëherë arrijnë të krijojnë ngjeshje sintetike si kjo: **"Një shpend këllthet nëpër erë/nuk është shpend, është njeri/ a sjemi të gjithë nga pak/në klithmën dhe vrullin e tij?"**. Kjo natyrë me pamjet e saj të zgjedhura me kujdes, me detajet, etydet, duket sidomos e superaktivizuar poetikisht në poemën **"Lumi im"**, poemë që përmbyll librin, ku natyra dhe lumi shndërrohet në rrjedhën kohore të nisjes, të ecjes dhe të rikthimit herë pas here, dhe lumi apostrofizohet heshturazi pa thirrje të hapura, duke rrjedhur damarëve të kujtesës. Lumi bëhet një tejbartje trandeshente, që përcjell vazhdimisht nevojën për reflektim. Një reflektim i thellë me qasje të ndryshme, të ëmbla dhe të bukura, duke sjellë paralelizmë në këtë qasje edhe ecjen e njeriut.

Si poet i dashurisë dhe brishtësisë njerëzore, krijuesi e shikon dashurinë edhe përmes perceptimit të shëndetshëm moral të saj, edhe si mësim, por më shumë si ndjesi. Dashuria për poetin mbetet e përjetshme, pavarësisht nga mosha, dhe është mosha ajo që na shmang nga rreziqet e saj. Ajo vjen si mall, si nevojë për afim, (Më thonë të nis një letër e dashur), herë si mungesë (Dhe ç'kishte mbetur në Shëngjin

nga dashuria), herë si hapësirë e madhe apo humbje të vëmendjes ndaj saj, që të fut në borxh, poezia "Borxhet e dashurisë".

Dashuria në poezinë e Ilirian Zhupës përmbajtësohet estetikisht, duke u poetizuar me elemente të jetës së përditshme, ajo nuk është konkrete - sensuale, as ekstazore, por më tepër si një përjetim personal me tentim të fuqishëm filozofik, duke gjykuar edhe unin, edhe dashurinë, pastaj paradokset e jetës që krijojnë vetiu distancë me të. Poeti i jep poezisë së tij një përmasë filozofike të natyrshme. Krahas manifestimit të hijshëm të ndjenjës së bukur, ai gjykon estetikisht raportet njerëzore me këtë ndjenjë, çastet e kaluara apo ato të ndodhura në të tashmen dhe çfarë e bën të bukur njeriun në vazhdimësi.

Poeti, në tërë krijimtarinë e vet, vendos raporte të caktuara me sende të thjeshta, me objekte apo njerëz që njeh dhe në këto raporte ndjesore -medituese, ai zbrërthen kuptime të ndryshme, duke përcjellë frymën poetike të tyre. Për krijuesin e vargjeve, jeta është e bukur kur është e thjeshtë, ai nuk rend të veçojë e thotë gjëra të mëdha, por, nga kuptimet e thjeshta, zbulon madhësitinë e jetës. Dhe ana më madhështore e thjeshtësisë është shqetësimi për njeriun, për realizimin e tij përmes kodit të së bukurës, që poezia e Ilirian Zhupës ta jep përmes vargjeve të ngjeshura me mendim e të njomura me ndjenjë. Poezia e tij nuk i përket një intimiteti të ngushtë, por një intimiteti të hapur e të ngrohtë, që kuptimësohet nga mendimi i pjekur.

Gjuha poetike e Ilirian Zhupës është e zgjedhur, e kursyer, apo siç thuhet, ekonomike. Poeti rend më tepër drejt mendimit të kulturuar e të mençur dhe e materializon atë artistikisht, por kjo nuk do të thotë se mungon figura, e cila në poezinë e tij është e pranishme në mënyrë të natyrshme. Metaforat, paralelizmat, personifikimet e të tjera figura, një shumësi e duhur efektive, të bëjnë të besosh se ato dhe vetëm ato janë të mundura në ato pozicione kuptimore. Struktura organike e poezisë së tij nuk mundëson heqje apo shtim, ajo është ndërtuar me mendje mjeshtërore, por kjo teknikë nuk e bën poezinë e tij të ftohtë, përkundrazi, verbi i tij mbart një energji ndiesore të thellë dhe të ngroh me dashurinë për vendlindjen, për jetën e për njeriun.

Krijimtaria e tij ndërton një tempull kujtese, që është fjala, imazhi i saj që ajo vetiu e ndërton, burimet shtesore kuptimore që përhap, duke u gjeneruar nga akti krijues si dhunti e autorit. Ilirian Zhupa di t'i ndërtojë e t'i mbajë ekuilibrat e duhura të krijimit. Poezia e tij lirike-meditative me sqimën e fjalës së zgjedhur dhe vetëpërmbajtjen e mosgjatjes, nuk e përjashton spontanitetin dhe natyrshmërinë. Poezia e këtij autori është një vlerë e rëndësishme e identitetit të tij intelektual dhe e njeriut të ndershëm e të ndjeshëm, që e di nga vjen dhe, me këmbë në tokë, e di ku shkon, me një mision që nuk ia ka ngarkuar kush, përveç vetëdijes së tij dhe intuitës së lindur artistike e talentit të spikatur, për ta bërë fjalën më të bukur, më të ngjeshur dhe lexuesin ta kthejë vështrimin me respekt ndaj emrit dhe poezisë së tij të arrirë me nivel artistik dhe estetik të admirueshëm.

Dua të shkruaj nja dy mbresa për një poet, për lirikun shqiptar Ruzhdi Gole, vjershat e të cilit i kam për zemër dhe më duket se më shtyn një ndjesi që më del së brendshmi si detyrim moral e letrar, pa më kërkuar kurrë ky poet i mirë. Pra po e nis si të vijë, ndoshta dhe në formën e një bashkëbisedimi shkrimor në distancë...

Me lirikun e njohur Ruzhdi Gole jam njohur përmes vargjeve. Me njëri-tjetrin kemi kuvenduar nëpërmjet qelqit dixhital. Para se të shpreh dy mendime për të, dëshiroj t'i këndoj një këngëz labe, me pak sherbet humor: "I dashur Ruzhdi/ ti je flori/ në jet' e letërsi./ Të jam borxhli/ merak kam, s'e di/ se mos shtij në hi...". Pasi ia këndova, ma kthen: "Mos shtij në hi...shumë e veçantë, e mençur, nëntekst". Dhe, si vrojtues i hollë i situatës sikur e pikas turbullimin tim dëshiror: "Kështu le të nisin mendimet e tua për mua... E ku ka gjetje më të vetvetishme se kjo. Mos mëno...". "Ja të shikojmë, o Ruzhdo, po tak ma bën nga kënaqësia, kur dëgjoj emrin tënd në pasqyrën e shtypit sidomos të përjavshmen letraro - kulturore, gazetën serioze "Exlibris".

Më kishin folur miqtë e mi Pali Shtembari, Meleq Kapllanaj e Hiqmet Mehmetaj me fjalët më të mira për Ruzhdi Golen, si poet i kahershëm i Vlorës. Dhe përditshmërisht më "bombardonin" mirësisht për poetin vlonjat me rrënjë nga Reka e Dibërës së Madhe, sot me firmë në Durrës: "Hë, pra, ende?! Gole është lirik i ëmbël, i thellë dhe modern...".

Unë, edhe pa e njohur ende fizikisht, ia kisha dëgjuar emrin qysh në vitet 1975, kur nisa studimet e mesme në gjimnazin ushtarak, që atëherë quhej Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", Tiranë. Firmën e Goles e kisha ndeshur në gazetën e asaj kohe, që nga "Studenti", "Zëri i Rinisë", "Drita" dhe deri tek revista e lartë "Nëntori", shpesh si letrar me lirika të bukura si zambakë maji, herë edhe si kritik letrar me vështrim, vlerësime apo recensione si fjala vjen "Fillimet e mbara të poetit të ri": "Pranvera e lumit tim" e A. Isakut [shih: "Nëntori": revistë e përmuajshme letrare artistike shoqërore politike/ organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, viti XXIII i Bot., Nr. 6, Qershor 1976, f. 207-209]. Dhe pikërisht në Tiranë, ku isha e kur sapo doli libërthi i tij i parë "Maji i zambakëve" - 1976, unë e bleva me dëshirë atë shpirt të kthjellët lirik me 36 poezi në 47 faqe vargje të ngrohta të atij peneli begatie shkrimore, mbushur me ndjenja të zjarrta e të fuqishme dhe mendim të thellë e të kthjellët. Dhe sot, mbas 49 vjetësh nga botimi i librit të parë të autorit, mendoj që mirë kam bërë, se me 24 tituj librash, ku autori shfaqet si bilbil i fjalës plot ligjërimi, qoftë edhe i mërziur me këpucë letre, liriku ynë në profilin e tij të dallueshëm ka gjuhë fluturimi me klorofil frymor. (Në fakt, nuk mund të themi një shifër të përpiktë të titujve poetikë të Goles, sepse ato përditësohen papritmas. Dhe nuk po bëj një lojë të thjeshtë fjalësh me disa tituj të librave të autorit, por tërheq vëmendjen e kritikës letrare (nëse ka sot në Shqipëri të tillë seriozë), që të jenë më të vëmendshëm ndaj vlerave të vërteta, të qenësishme, sa autentike, autoktone e po aq moderne, si këto të Ruzhdi Goles, që na mbushin me besim frymëzimtarie në letërsinë e mirëfilltë, që s'mund ta turbullojnë as parallinjët, as qejflinjët, as pronaro-majmunët e as hipokrito-firaunët.

Do të autoburrem pak vlonjatërisht... Kam dëshirë që ta shfrytëzoj mirësisht bujarinë e fisnikut të letrave të sotme, Arian Leka, i cili ka përgatitur për botim këto vëllimet e prame poetike të njërit prej lirikëve të mirë të Shqiptarisë, poetit Ruzhdi Gole. Që është vlonjat Ruzhdi Gole e kam ditur edhe më përpara si nxënës Halimxheloi në shkollën e mesme "Halim Xhelo" Vlorë dhe si mësues në Kaninë apo në Fushë Dukat. Ç' koincidence! Në shkollën e mesme "Hasan Mëhilli" kam dhënë edhe unë letërsi. Emrin e Goles ma kanë përmendur me nderim e vlerësim mësues e prindër, miq të mi, që e kishin njohur lirikun tonë...

Por që të të bëjë parathënie i ndritshmi i heshtur i vargut të madh Hiqmet Meçaj ..., kjo është një ngjarje për letërsinë dhe kulturën tonë, duke njohur sqimën e motivuar dhe shijen e hollë të poetit identitar të Vlorës

## Ruzhdi Gole, begatia e poetit të heshtur

MSc. Albert Habazaj

Hiqmet Meçaj, ngjarje që mund të ndodhë një herë në një shekull... Fati i bardhë i ra Goles, sepse poezia e tij është gjuhë dhe imazh. Këtë përcaktim ia bën Madhëria i vargut Hiqmet Meçaj Vlorë. Tejt shakasë së bukur që dhe shkon, Gole ka gjeografi e pasuri shpirti aq sa dhe gjeografi e pasuri vargu brilant.

### Nisja dhe vijimi i udhëtimit letrar të Goles

Ruzhdi Gole, lindur në qytetin e Vlorës më 10 Nëntor 1952, kreu arsimin fillor e të mesëm në vendlindje dhe studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Tiranës në Fakultetin Histori - Filologji për gjuhë dhe letërsi, atje ku kishte dhe pasionin e tij e shfaqte talentin letrar. Gjatë këtyre viteve, ka botuar cikle poetike në shtypin e kohës, si në gazetën "Drita" e "Zëri i Rinisë", apo në revistën "Nëntori". Është interesante, se qysh atëherë ai ka qenë i vetëpërbajtur në botimet e tij dhe larg mediave, cilësi e virtytshme kjo, që të bën më fisnik në krijimtarinë letrare.

Përveç librit të parë, që e kam blerë në Tiranë, të shtunën e 18 Shtatorit 1976, shënuar dhe në atë libërth të çmuar, të tjerat Golja m'i ka dërguar me përkushtim. Si duket, nga malli për Vlorën, i ishte bërë natyrë e, sa i gëzohej librit të sapobotuar, ma niste dhe mua një kopje. Gjithmonë m'i përmend vargje të poezisë së vjetër "Kur iki nga Vlorë: Me kokën të kthyer përgjysmë nga ti./ me një pjesë zemre nëpër rrënjë ulliri...".

Në atë vëllim me lirika ka edhe shumë vargje epiko-lirike të gdhendur me daltën poetike të shpirtit atdhetar të poetit, si poezia "Epikë", kushtuar 4 heronjve të Topanasë, me strukturë strofike 4 vargjeshe, 6-rrrokshe, me rimë të kryqëzuar ABAB, ardhur si motiv popullor, por lulëzuar me figura të shëndetshme letrare. Pikërisht Ruzhdi Gole ka shkruar dhe këto dy vargje gjysmë shekulli më parë e kusur: "Në të gjithë shekujt janë vetëtimat e tij./ kurse vdekja e tij në asnjë kohë", që për mua mbeten një motiv i dashur frymëzimi. Vëreni ndjesinë krenare dhe fuqinë e imazhit që na sjell autori në poezinë "Këngë labe për Zonja Çurren", tek e mbyll me vargun "ky flamur është gjoksi yt dhe kjo shkabë syr' i zi". Ja dhe strofa e parë e poezisë "Rapsodi", që vjen si motiv i vjetër. "Klithën erërat dhe thanë emrin tënd./ Të vranë në një natë vjeshte, të vranë./ - Nuse, moj nuse, - thirrën nënat, - i kuq t'u bëftë fustani i bardhë..."


Përse i përmenda këto shembuj nga libri i tij i parë? Nuk më kujtohet përse

kam qenë mikpritës i poezisë së tij qysh në rininë time të blertë tiranase, por patjetër, sepse më ka pëlqyer vërtetësia, dëlirësia dhe shumëkuptimshmëria e qartë e vargut lirik. Ndonjë mik i penës e quan poet hermetik. "Po jo, mor mik, nuk është Golja hermetik. Pa hë, ma gjej, ku e vëren ti? Më gjej jo një poezi, por një varg më gjej, të lutem..." Hajt, t'i marrim librat me radhë. Unë po i shfletoj lehtas e me kënaqësi. Janë poezi të mira, të arrira, kanë lëng poetik, kanë jetë, kanë art, kanë atë dritën magjike të fjalës së ngrohtë dhe të bukur letrare. Kuptohet që s'janë të gjitha sipër, se as Fatos Arapi, Dritëroi, Kadareja, Dhori Qiriazi, Shkreli e Podrimja apo deri tek Frederik Reshpja e Xhevahir Spahiu nuk i kanë të gjitha poezitë sipër, por, gjithsesi, ngelen lartësi letrare, piketa të dukshme të letërsisë shqipe. Disa nga poezitë e Goles më pëlqejnë aq shumë, sa që unë i fërshëllez si motive popullore, apo i këndoj si këngë labe, siç është poezia "Epikë", që e këndon Grupi i Grave të Tërbaçit "10 Shqiponjat e Tërbaçit", edhe për faktin se ajo i kushtohet yjeve të pashuar të lirisë Hajredin Bylyshi (nga Tërbaçi, nga jemi dhe vetë), Mumin Selamit nga Kallarati, Bajram Tushit nga Vermiku dhe Hiqmet Buzit (15 vjeçarit vlonjat me origjinë nga Buzi i Tepelenës...).

Pra, ku gjendet hermetizmi në poezinë e Goles? Aaaa, ai nuk është shkruar vargjeshe, as poet në proces, ai ka lindur poet, mbajti standardet e larta të poezisë me stilin e të shkruarit dhe frymën e re që futi, krahas të tjerëve, por me origjinalitetin e tij natyral të kultivuar, ku shndrit kontrasti tronditës. Vargu i tij është vërtet polisemantik, por aty qëndron e bukura, shija poetike, gjurma që le tek lexuesi. Nuk ta err leximin, i jep dritë atij, nuk t'i prish shijet, t'i zbukuron dhe hijeshon më fisnikërisht në rrafshin letrar dhe qytetar.

Poezia e Goles është një këngë lirike me lulëzim metaforik. Kujtoj, sapo u shfaq në botën letrare shqiptare, ai tërhoqi vëmendjen e kritikës dhe fitoi admirimin e lexuesve të letërsisë së mirë. Edhe pse i plotësuar me arsim universitar për Gjuhë - Letërsi shqipe, mendoj se Golja është poet i lindur, sa i kursyer në vargje, aq shpërthyes në çeljen e luleve shumëgjyreshme të kopshtit letrar, që e ka selitur me ndjenja fisnike të krenarisë kombëtare, qytetare dhe artistike.

Edhe pse u mirëprit qysh me librin e parë "Maji i zambakëve", të vogëlthin e vitit 1976 vetëm në numrin e faqeve, Gole nuk nxitoi të botonte, sepse donte ta hidhte hapin të sigurt



përpara, të mos ia rrëmbente era vargun, po të ndihej, të dëgjohej, të kuptohej e të ishte i dobishëm për shëndetin letrar të shoqërisë. Dhe kështu, mbas 8 vjetësh botoi vëllimin e dytë poetik "Emri yt" (1984), ndërsa librin e tretë "Vonoj të thinjem" e botoi mbas 12 vjetësh (1996). Pastaj, me një hap më ritmik e të sigurt në udhëtimit letrar vijoi botimet e librave me lirika: "Me zjarre fërkoj duart" (1998), "Kërcimtar pa kurm" (2000), "Njerk i askujt" (2001), "Pak terr dhe etje" (2003), "Mërgoj hijet" (2005), "Vetmia me gjeth" (2007), "Dihatje në livadhin e mbrëmjes" (2009), "Bir i vogël ajri" (2011), "Kureshtja për t'u rritur" (2011), me të cilin fitoi Çmimin Kombëtar "Letërsia për fëmijë e të rinj" (2012), "Vertebrat e shiut: antologji vetiake" (2013), "Vrapime mjedisi dhe gjuetie" (2015), "Gjuhë fluturimi" (2015), "Klorofil frymor", poezi, proza (2017), "Inde dhe ishuj", poezi, poe-proza (2018), "Bilbil plot ligjërimi" (skenari - film dokumentar), (2022), "Skulptura ujore" (2022), "Mërzi me këpucë letre" (2022), "Ajër plot kallëza" (2024), "Pylli me zemrë në gisht", poezi, poe-proza (2024), "Sol", trill violine & peneli (2024), "Vesë prindërore" (2025)...


### Hidrocentral i fjalës së bukur

Qysh në fillimet e tij shkrimore, ai shprehej: "Parathënie të zezikshme, pashënie...të mençura", duke zbuluar paksa vetveten dhe besimin poetik. Dhe kjo paradigme e profilit të tij letrar është mbushmëndëse për këdo që e njeh këtë poet lirik, që është, së pari, korrekt me standardin e masës në vjershërim. Populli ynë ka një fjalë të urtë: "Gjella me kripë e kripa me karar". Autori ynë e zbaton me rreptësi kriterin e masës. Ai shkruan në fund të vëllimit "Ajër plot kallëza" me vërtetësi dhe dëlirësi: "Poezia gjithçka e kërkon me masë: fjalën, vargun, figuracionin, kuptimësinë. Poezia nuk është zëri i masave të kuptohet prej kujtdo. Kërkon lexues të vëmendshëm dhe seriozë. Një poezi e mendimit nuk nënkupton që të jetë e errët, e mbyllur dhe hermetike. Lexim - këqyrja e poezisë do që lexuesi të jetë i kulturuar, lexues të saj nuk mund të jenë të gjithë", duke uruar kështu poezinë e tij për udhë të mbarë tek lexuesi. Hermetike cilësonin edhe poezinë e Fatos Arapit të madh, por unë nuk mendoj ashtu. Poezia e Fatosit tonë ka diell, ka ajër, ka qiell, ka det, ka frymëmarrje, ka të gjitha stinët dhe, po të kesh sy shqiponje në lexim dhe kuptim, ajo është e tejdukshme, e qartë dhe e mrekullueshme. Edhe poezia e Ruzhdiut ka brenda një Fatos Arap me identitet golian.

Ruzhdi Gole është zotëruar dhe studiues i vetvetes, pastaj shkruar i vëmendshëm i vargjeve zemërgjerë si "borzilokë yjesh". Në vargëzimin golian ndihet këndshëm gjelbërimi stilistik që na shijon gjatë leximit, sepse mënyra e të shprehurit, organizimi ritmik origjinal i krejt materialit gjuhësor të përdorur në lëndën letrare lulëzojnë ligjëratën poetike, duke lënë përgjatë rrjedhave të kohës firmën e motit libror të R. Goles në fenomenin artistik - gjuhësor, që na mbush me emocione të fuqishme dhe na zbukuron fytyrën letrare, shëndetin letrar, kulturor dhe qytetar, krahas poetëve të tjerë të mirë që ka Shqipëria.

Për lirikat e Goles kanë shprehur mendime të vyera personalitete të fushës si Xhevahir Spahiu, Hiqmet Meçaj, Visar Zhiti, Arian Leka, Ymer Çiraku, Çapajev Gjokutaj, Harallamb Fandi, Bardhosh Gaçe, Fatbardh Rustemi, Shpendi Topollaj, Yzedin Hima, Shpëtim Kodra, Enton Bido, Ilir Paja etj.

Vlorë, 28 tetor 2025



Arti i madh ka një shtrirje të gjatë pas vetes, kryesisht të padukshme për krijuesit e tij. E di se nuk do të ndieja kaq ngrohtësi ndaj njerëzve, për shembull, po të mos kisha lexuar Forster-in në një moshë kur ende po formohesha. Sigurisht, shumë gjëra të tjera mund ta kishin krijuar këtë ndjenjë afërsie. Arti nuk është në asnjë kuptim rruga e vetme. Por është një rrugë. Kur përfundoj *The Known World* — dhe kthehem në botën reale — kthehem me një vëmendje të përtërirë ndaj idesë së vlerës njerëzore. Dhe nëse mund ta shtrijmë dhembshurinë tonë te personazhet e vuajtura në një roman, sa kujdes e dhembshuri u detyrohem njerëzve të vërtetë të vrarë në Palestinë, në Sudan, në Ukrainë, në Iran dhe — tekta po e shkruaj këtë — në rrugët e Minneapolis-it?

Sigurisht, e dimë se nuk ka asnjë garanci që një bashkëndjesi e tillë, e nxitur nga arti, do të shfaqet në jetët tona shoqërore dhe politike. E dimë se empatia është një cilësi e gabueshme, e ndryshueshme. Por është gjithashtu e vërtetë se, në mungesën e saj të plotë, lindin ferre të reja. Ia vlen të vihet re, mendoj, se rryma e mendimit letrar që vitet e fundit ka flirtuar me një mospërfillje të rëndë — madje me një përbuzje të fryrë — ndaj konceptit të empatisë, rastis ta ndajë këtë përbuzje me të ndjerin Charlie Kirk, i cili tha për këtë koncept: “Në fakt, nuk e duroj dot fjalën empati. Mendoj se empatia është një term i sajuar, new-age, që... bën shumë dëm.”

Kjo është e pritshme. E djathta prej kohësh ka argumentuar se bashkëndjesia duhet të kufizohet ashpër, kombëtarisht ose gjenetikisht. Kundërshtimi nga e majta fillimisht duket më befasues, derisa ndër mend të vjen konteksti. E djathta, natyrshëm, dëshiron të mbrohet nga kërkesat e njerëzve të tjerë, sepse pikërisht njohja e këtyre kërkesave është hapi i parë drejt drejtësisë për të gjithë. E majta, ndërkohë, përbëhet në masë të madhe pikërisht nga “njerëzit e tjerë” që parashtrajnë kërkesa — dhe që shohin se si kërkesat tona dështojnë, që zhgënjehen vazhdimisht, që zemërohen. Zemërimi dhe zhgënjimi janë emocione potencialisht të dobishme. Përbuzja është diçka tjetër. Mund të rrëshqasësh aq larg në përbuzje sa ta gjesh veten duke bërë jehonë ndjenjave të kundërshtarëve të tu ideologjikë. Në atë pikë, mund të të vijë në ndihmë të ngadalësosh, të mendohesh dhe një herë.

Mund të pajtohemi se empatia nuk është ndonjë ilaç magjik për gjithçka, aq më pak empatia letrare, dhe se ajo, në vetvete, nuk do të ndryshojë ligje e nuk do t'i japë të drejta askujt. Kur erdhi puna te dhënia fund skllavërisë, për shembull, kryengritjet dhe veprimi i drejtpërdrejtë politik ishin përbërësit thelbësorë. Por *Kasollja e xha Tomit* e kreu funksionin e vet. Nuk është një libër i madh, madje as një libër i mirë. Megjithatë, e ndryshoi klimën e të menduarit. Por mendoj se do të ndalem këtu. Këto argumente të stërpërdorura për artin dhe empatinë më mërzhisin. Në vend të kësaj, dua të



## ZADIE SMITH: Të shkruash kur jashtë protestohet

*Mund të them, pa turp, se ndërsa amerikanë po vriteshin në rrugë, unë po shkruaja jo vetëm këtë fjalim, por edhe një roman. Një roman që në asnjë mënyrë nuk merret drejtpërdrejt me peizazhin skëterrë në të cilin po jetojmë. Në këtë kuptim, jam në anën e gabuar të historisë dhe do të jem gjithmonë, bashkë me çdo artiste që ruan të drejtën të bëjë art për hir të vetes së saj, për hir të vetë artit dhe për hir të bashkënjëzve të saj*

flas për një aspekt tjetër të artit që më intereson vërtet: autonominë.

Çfarë lloj autonomie ka arti? Do të ishte qesharake ta imagjinoje artin si një botë më vete, të shkëputur nga kultura, nga politika, nga epoka e tij historike. Por dy ide qendrore formësojnë çdo epokë, dhe unë besoj se arti është në një masë të rëndësishme i ndarë nga të dyja. Këto dy ide janë: pushteti dhe përparimi. Kjo ishte ajo që në të vërtetë doja t'ju thoja sot: arti nuk është i fuqishëm dhe ai nuk përparon.

Ideja e parë, jam e sigurt, është e njohur. Pafuqia relative e artit është një nga të paktat gjëra për të cilat të gjithë mund të bien dakord. Në një botë të pushtetit të zhveshur, ku forca quhet e drejtë, arti është qartazi pa fuqi. Artisti nuk ka armë, nuk bën ligje, nuk burgos askënd, nuk zhvillon luftë askund. As Shakespeare-i dhe as Edward P. Jones-i nuk mund të urdhëronin ekzekutime brenda apo jashtë vendit, kjo ishte prerogativa brutale e Jakobit I dhe e George W. Bush-it. Ndërkohë, të dy artistët e kaluan kohën duke bërë çfarë? Duke luajtur me gjasme. A pati ndikim arti i tyre? Patjetër. A krijoi empati? Ndonjëherë. Por a ishte i fuqishëm? Jo. Jo në mënyrën si shtetet, mbretërit dhe presidentët e kuptojnë pushtetin.

Po për përparimin? Epo, po ju them se *The Known World* nuk solli as përparim dhe as prapavajtje në raport me *Macbeth*-in, po aq sa muzika e Stevie Wonder-it nuk është prapavajtje nga, apo përparim ndaj, të themi, veprës së Beethoven-it. Ndryshe nga shkenca dhe teknologjia, arti nuk i

nënshtrohet logjikës së rritjes apo ligjit të Moore-it. Ai nuk do të bëhet domosdo më i vogël, më i shpejtë, apo më i madh e më vdekjeprurës. Ai krijohet si në ekonomi të forta, ashtu edhe në të dobëta, si gjatë luftës, ashtu edhe gjatë paqes. Kur është i mirë, siç vëren Forster-i, ka prirjen t'u mbijetojë çrregullimeve njerëzore që e rrethojnë, por nuk bëhet as më i mirë, as më i keq në këtë aftësi. Shanset për të krijuar një vepër arti që ka vërtet rëndësi nuk përmirësohen kurrë në të vërtetë. Një analogji për këtë është dashuria. A është dashuria që ndiej për fëmijët e mi një përparim ndaj, apo një prapavajtje nga, dashuria që ndiente një grua e shekullit të katërmëdhjetë për fëmijët e saj? Jo të gjitha përvojat njerëzore i nënshtrohen përparimit.

Një nga gurët e themelit të konceptit amerikan të përparimit është “komoditeti”. Gjërat konsiderohen të përparuara kur bëhen më të shpejta, më të lehta, pa fërkim, të padukshme. Sipas kësaj logjike, është përparim që darka të të silltet te dera nga një i panjohur i paguar pak dhe i paorganizuar në sindikatë, në vend që të jetë përgatitur nga një njeri që e njeh dhe e do, e që pastaj ulet ta ndajë atë vakt me ty. Përparim që një makinë të shkruajë një ese, në vend që ti vetë të kalosh nëpër çfarëdo mundimesh, gëzimesh dhe mjerimesh që kërkojnë kohë dhe që do të të sillte shkrimi i asaj eseje. Është padyshim e vërtetë se një makinë mund të marrë lehtësisht një grumbull romanesh për skllavërinë — të marrë *The Known World*, *Beloved* të Toni Morrison-it, *Cane Warriors* të Alex Wheatle-it, madje edhe romanin


tim *The Fraud* — dhe t'i përdorë ato pika të dhënash për të shkruar një roman gjithëpërfshirës, informues dhe ndoshta edhe estetikisht të këndshëm për “institucionin e veçantë”, dhe të gjitha këto brenda pak çastesh. Madje mund të bindë shumicën e njerëzve se libri është shkruar nga një qenie njerëzore. Por puna është kjo: nuk është shkruar nga një qenie njerëzore. Dhe kur lexoj, dua të jem në marrëdhënie me një qenie njerëzore. Prandaj lexoj. Po kështu, një makinë e udhëzuar të bëjë dashuri me mua mund të jetë teknikisht e shkëlqyer në këtë, por as kjo nuk mjafton. Unë dua të dëshirohem nga një njeri. Dua të jem në marrëdhënie me njerëz të tjerë. Kjo është ajo çka besoj se jam në këtë tokë për ta përjetuar. Mendoj se të gjithë e ndiejmë kështu në fund, edhe nëse na duhet gjithë jeta për ta kuptuar.

Që komoditeti duhet të jetë aspirata më e lartë e ekzistencës njerëzore është një nga supozimet e shumta të pashqyrtuara të ideologjisë kapitaliste. Kur e bindim veten se edhe arti duhet të ndjekë rrugën më të shkurtër drejt efekteve të tij, atëherë i jemi nënshtuar asaj ideologjie. Por arti mund të jetë jashtëzakonisht jokomod! Arti mund të harliset. Të endet. Mund të stolisë e të zbukurojë, ose të refuzojë të jetë i volitshëm, dogmatik, i gatshëm të kënaqë. Largësia e tij nga prerogativat e të fuqishmëve është pikërisht vendi ku qëndron forca e tij e rezistencës. Dhe nëse Forster-i mund të këmbëngulte në diçka të ngjashme me këtë vizion të artit mes rrënojave të Luftës së Dytë Botërore, atëherë kjo është gjëja më e vogël që mund të bëj unë tani. Mund të them, pa turp, se ndërsa amerikanë po vriteshin në rrugë, unë po shkruaja jo vetëm këtë fjalim, por edhe një roman. Një roman që në asnjë mënyrë nuk merret drejtpërdrejt me peizazhin skëterrë në të cilin po jetojmë. Në këtë kuptim, jam në anën e gabuar të historisë dhe do të jem gjithmonë, bashkë me çdo artiste që ruan të drejtën të bëjë art për hir të vetes së saj, për hir të vetë artit dhe për hir të bashkënjëzve të saj.

Edhe Edward P. Jones-i ishte po kështu në anën e gabuar të historisë, nëse arti duhet gjykuar vetëm nga urgjenca me të cilën i përgjigjet çrregullimit të tanishëm. *The Known World* nuk është një roman për pushtimin e Irakut. Është një kryevepër për ndikimin korruptues të një sistemi të korruptuar mbi të gjithë, përfshirë edhe viktimat e tij kryesore. Ka rend të brendshëm. Është i bukur dhe tragjik. Mbi të gjitha, është njerëzor. Leximi i tij më kujtoi çfarë janë njerëzit janë të aftë të bëjnë, për çfarë e bëjnë, pse i bëjnë gjërat që bëjnë dhe pse lënë kaq shumë gjëra pa bërë. Më nxiti të vija këtu sot dhe të flisja siç fola. Një art i tillë bëhet nga ne dhe për ne. Është për hirin tonë. Fuqia e tij nuk është e llojit që njeh ky president, por ka llojin e vet të forcës. Ai do t'i mbijetojë si atij, ashtu edhe regjimit të tij. Do të na mbijetojë të gjithëve.

Përktheu: ExLibris

*Karikaturë nga Arben Mexsi*



## KUVENDIM ME ILARIE VORONKËN

Sot duke lexuar poemat e tua Ilarie Voronca\*  
Kam përshtypjen se po kuvendoj me një mik të vjetër  
Që për mua është më i afërt sesa shumë bashkëkohës

Ndonëse kam lindur vetëm një vit para ikjes sate  
Dhe kështu nuk kemi pasur mundësi të takoheshim  
Ajo që më bën ta quaj veten si një nga miqtë e tu  
Nuk është vetëm dashuria jonë e thellë për poezinë  
Por edhe një tog gjërash që ne i kemi të përbashkëta

Si ti edhe unë mendoj se jeta njerëzore i ngjan një lumi\*\*  
Që bën lakadredha midis shkëmbinjve dhe rrjedh ngadalë  
Në rrafshinë për të sosur te deti që quhet vdekje  
Si ti edhe unë kam qenë i paduruar, edhe unë jam vërsulur  
Kundër brigjeve të mia që ishin caqet e mia.

Jam i prirur të besoj se në sytë e tu të veltuar nga trishtimi  
Ti ke bartuar me vete imazhet e lashta e pikëlluese  
Të rënies së Sarmizegetuzës e të vdekjes së mbretit Decebal  
Ashtu siç më kanë ndjekur mua imazhet e pashlyeshme  
Të rënies së Shkodrës dhe të humbjes së mbretit Gent  
Që eci në Romë i mbrehur në qerren e triumfit të mundësit të  
tij

Ashtu si ti edhe unë kam qenë i huaji  
Zëri i të cilit është si një spirancë e mbuluar me alga  
Dhe me guaska që këtu janë të panjohura.  
Ashtu si ti edhe unë mendoj se qenia njerëzore  
I ngjan një agaveje, e cila, siç thonë, çel çdo njëqind vjet.

Tashti që viti i tetëdhjetëditë më vështron përballë  
E ndiej veten fajtor që kam rrojtur sa dyfishi i moshës sate  
Fajtor që kam rrojtur më gjatë sesa të gjithë poetët  
Që e kanë humbur jetën ose e kanë vrarë veten të rinj  
Fajtor që nuk ia kam dalë mbanë ta shpoj murin e patundur  
Të mospërfilljes të padrejtësisë e të mediokritetit

Në këtë çast që jam duke kuvenduar me ty  
Nuk kam aspak ndjesinë se po flas me një të vdekur  
Asnjë poet në botë nuk ka vdekur  
Sa kohë që ende janë gjallë fjalët e tij  
Siç besoj se ndodh me poemat e tua

Ja përse sot Ilarie Voronca  
Të ftoj të lësh viset e Hadit  
Të shpërfillësh ekzistencën e Plutonit të Cerberit trikrerësh  
Të vish të shëtitësh nëpër rrugët dhe sheshet e Parisit  
Që na e ka rrëmbyer zemrën të dyve...

\*Poet francez me origjinë rumune (1903-1946)  
\*\*Vargjet me italiqe janë të Ilarie Voronkës

## PEMA EKZOTIKE

Në një park të Parisit  
U befasova nga harlisja e një peme ekzotike  
Me degë të gjata të ngarkuara me lule  
Që dukeshin sikur donin të përfaqonin atë ditë pranverë  
Dhe qiellin e rimitë ku shkëlqente dielli

Mendova se ajo pemë ekzotike  
Ishte në njëfarë mënyre një mërgimtare bimore  
E cila për arye që unë nuk i dija  
Kishte kapërcyer dete dhe hapësira kontinentale  
Për të hedhur rrënjë në këtë tokë mikpritëse  
Që ishte bërë atdheu i saj i vërtetë

E ushqyer nga trualli i pasur e pjellor i Parisit  
E favorizuar nga klima e tij e butë  
Ajo ishte rritur nga viti në vit  
Derisa ishte bërë një pemë madhështore  
Me rrënjë të thella e me trung të fuqishëm  
Me një floknajë të harlisur degësh e lulësh

U magjepsa nga ajo pemë ekzotike  
Nga të qeshurat e lulesave të saj që shpërthenin në qiell  
Dhe buzët e kuqe të gonxheve të saj të çelura  
Më dukej sikur thoshin : E dua Parisin  
Dhe ky qytet i ndritur e bujar  
Më fal dashuri

I nxitur nga imazhi i pashqitshëm i asaj peme  
Ëndërrova të isha si ajo...

## RIMARRJA E NJË MITI BIBLIK

Psalm distopik

Verseti 27 i Librit të Gjenezës thotë :  
« Zoti e krijoi njeriun sipas imazhit të tij, ai e krijoi sipas imazhit të Zotit. »



# ANTON PAPLEKA

## kuajt e verbër të fjalëve

Duke imituar Zotin krijues edhe Homo sapiens  
E krijoi robotin sipas imazhit të tij, ai e krijoi sipas imazhit të  
njeriut  
Pa dyshuar se një robot humanoid me pseudonimin Fridrih  
Niçe  
Do të shpallte « Muzgun e njerëzve »  
Ashtu siç kishte parathënë vdekjen e zotave  
Pararendësi i tij njerëzor

Sapo e ngritën shtetin e tyre totalitar  
Robotët vendosën të bënin tabula rasa  
Qytetërimin e Homo sapiensit  
Ata plaçitën të gjitha kryeqytetet e botës  
Dogjën bibliotekat shkatërruan muzetë

Me kalimin e kohës robotët shpikën  
Robotin-Homer Robotin-Shekspir Robotin-Hegel  
Robotin-Bethoven Robotin-Marsel Prust Robotin-Pikaso  
Robotin-Mikel-Anxhelo sulpturat e të cilit u ekspozuan  
në të gjitha sheshet e Tokës  
Për të zëvendësuar veprat e demoduara të Fidias  
të Mikel-Anxhelos njerëzor e të Rodenit

Ata shpikën Roboti-Ajnshtajn dhe sidmos Robotin-Elon Musk  
Falë të cilit raca ngadhënjimtare e robotëve u shtua aq shumë  
Saqë ata ia dolën mbanë t'i dëbonin qeniet njerëzore  
Nga kullotat nga arat nga uzinat nga laboratorët  
Duke i quajtur krijesa të vjetruara e të tepërta  
Krijesa po aq të ngathëta sa majmunët e quajtur përtacë  
Pastaj i nxorën nga skutat ku fshiheshin dhe i vranë mëni-  
shëm  
Duke i deklaruar si një lloj në shuarje e sipër  
Me qëllim që kultin edhe emrin e Homo sapiensit t'i mbulonte  
harresa  
Fjalët njeri dhe humanizëm u fshinë nga të gjithë diksionerët  
e robotëve  
Dhe u ndaluan të përdroreshin në bisedat e përditshme

## VDEKJET E MIA TË MUNDSHME

I lindur në fshatin e një vendi ballkanik  
Unë mund të kisha vdekur në moshë të njomë  
Nga zia e bukës nga ndonjë epidemi shfarosëse  
Më vonë mund të kisha fjetur gjumin e përjetshëm  
I mbuluar nga bora e një orteku  
Mund të isha bërë fli e demonit të ujërave  
Duke kaluar Drinin me argisht si Pjetër Budi  
Mund të kisha vdekur në kullën e ngujimit  
Ose mund të isha vrarë në pritë nga një gjakës

Pas ngritjes së Murit të Berlinit  
Mund të isha vrarë nga plumbat e kufitarëve

Gjatë një përpjekjeje për t'u arratisur nga atdheu  
Mund t'i kisha ngrysur ditët në një spital psikiatrik  
Ose në galerinë e shembur të një miniere  
I dënuar për veprimtari armiqësore  
Në bazë të dëshmisë së rreme të një kolegu  
Ose i akuzuar për gabime të rënda ideologjike  
Nga një kritik letrar zhdanovist

Pas rënies së Murit të Berlinit  
Mund të isha mbytur midis dallgëve të detit  
Duke lundruar me një gomone klandestinësh  
Mund të isha vrarë nga një plumb qorr  
Gjatë një përlëshjeje midis bandave rivale  
Mund të kisha qenë viktimë kolaterale  
E breshërisë së automatikut të një vrasësi me pagesë  
Që do të kryente në rrugë një atentat politik

Mund të isha goditur me sëpatë nga një fqinj  
Gjatë një grindjeje për çështje pronësie  
Mund të isha hedhur në greminë nga një shkëmb  
Mund t'i kisha shkurtuar ditët duke pirë koçifos  
Duke u varur në litar një natë me hënë të plotë  
I dëshpëruar nga humbja e parave në firmat piramidale  
I dëshpëruar nga nga varfëria nga padrejtësitë shoqërore  
Ose për shkak të dështimeve letrare

Pasi i hodhi poshtë versionet e mësipërme  
Regjisori që në gjuhën e përditshme quhet Fat  
Parapëlqeu të xhironte skenarin ku do të rroja  
Derisa ta kapërcejë kepin e të tetëdhjetave  
Duke më dhënë mundësi të isha figurant në një film  
Me protagonistë kontinentet oqeanet kupën qiellore  
Një shekull që po mbaronte e një shekull që po lindte  
Të përngjitur si pjesët e një sfinksit mitik...

## CODA

Pasi të rrjedhë një kohë e pallogaritshme  
Edhe Roboti do të krijojë një Postrobot sipas imazhit të tij  
E kështu me radhë  
Nëse Toka do të vazhdojë të ekzistojë  
Të sillet në orbitën e saj...

Paris, 16.4.2026

## SOT DUA TË HARROJ

Mos më thuaj të sjell ndër mend  
Çfarëdoqoftë

Sot dua të harroj  
Gjithçka

Gjithçka që ëndërrova të isha  
Gjithçka që nuk mund të isha  
Gjithçka që më detyruan të isha

Sot dua të harroj  
Gjithçka

Të harroj se çfarë jam  
Se çfarë kam qenë dikur

Në vend që të jem një kujtim  
Sot dua të jem  
Harresë  
Zbrazëti

Një mundësi për të qenë  
Ai që nuk kam qenë ndonjëherë...

## NJË GRIMCË E ARTË GËZIMI

Gërmoj thellë në veten time  
Për të gjetur aty  
Një grimcë të artë gëzimi

Të gjitha përpjekjet e mia  
Të gjitha kërkimet e mia të censhme  
Janë të paracakuara të dështojnë

Tashti unë i ngaj  
Një miniere të braktisur  
Me galeri të errëta  
Që shemben pareshtur  
Ku damarët e arit  
Kanë shterur kahe të

Pavarësisht nga kjo gjë  
Një dëshirë e pashuar  
Një shpresë e paçrrenjosur  
Më shtynjë të gërmoj

Thellë në veten time  
Për të gjetur aty rastësisht  
Një grimcë të artë gëzimi

Ajo do t'u jepte syve të mi  
Një shkëlqim diellor  
Për ta sfiduar dimrin që rri përballë meje  
Me maskën e tij të hirnosur...

## KALENDARI IM

Koha ime nuk është më një kalendar  
Festash gëzimesh ëndërrimesh  
Por një kalendar prapësisht  
Zhgënjimesh e dhimbjesh  
Që ndjekin njëra-tjetër  
Si gurët që rrokullisen  
Në shpatin e thiktë të një humnere  
Që lënë prapa zhurma të mbytura  
Dhe shtëllunga pluhuri  
Që shndërrohen në gonxhe të errëta

Përditë e më shumë  
Kalendar im i ngjan një lisi të moçëm  
Të zverdhur nga vjeshta  
Mbi të cilin vërsulen erërat e dimrit  
Duke u përpjekur të shkulin  
E të rrëmbejnë sa më shumë gjethe  
Derisa degët e zhveshura neçake  
Të zgjaten në zbrazëtiri  
Si duart eshtake të një plaku  
Që ëndërron të shtrëngojë midis gishtave  
Rrezet e diellit që zbret në zgrip të qiellit...

## I KËRCËNUAR NGA VDEKJA NË MËRGIM

I kërcënuar nga vdekja në mërgim  
Më erdhën në mend stërgjyshërit e mi  
Të cilët në rast mynxyre  
U luteshin maleve ku kishin lindur  
Të ndaheshin më dysh ose më katërsh  
Për të marrë një pjesë të dhimbjes së tyre  
Të cilën nuk mund ta përballonte  
Një njeri i vetëm

Përballë dhimbjes sime  
Sot ia ngula sytë horizontit  
Ku vështrimi im nuk takoi dot asnjë mal  
Dhe njerëzit m'u dukën aq të largët  
Sa malet që i sheh në ëndërr

Unë nuk munda t'u kërkoja ndihmë  
As maleve të vendlindjes sime  
Të cilat në vend që të shtegtonin me mua  
Kishin qëndruar pranë stërgjyshërve të mi  
Për të ruajtur kujtimet dhe gurët e varreve të tyre  
Të brejtura nga harresa nga erërat nga myshku

I kërcënuar nga vdekja në mërgim  
E mbërtheva me duar dhimbjen time  
Pastaj zura ta breja me mllef  
Siç bën kont Ugolini i uritur  
Që nuk resht së kafshuari kafkën  
E vrasësit të tij të kryepeshkopit Rugjieri  
Në rrethin e nëntë të Ferrit të Dantes...

## KUAJT E VERBËR TË FJALËVE

Ti i nget pareshtur  
Kuajt e verbër të fjalëve

I dëgjon trokëllimat e tyre  
Që kumbojnë në një kalldrëm të padukshëm  
Sheh xixat që ndizen në terr  
Kur potkonjtë përplasen pas gurëve

Ti i nget duke shpresuar  
Se do të mbërrish atje për ku je nisur  
Ose së paku do të mbërrish dikund

Duke parë diellin e hënën  
Që ndërrojnë vend në qiell  
Ti beson se do të kesh kapërcyer  
Hapësira të pamata  
Beson se do të kesh bërë shumë rrugë

Sa herë që shpreson të dallosh  
Vendin për ku je nisur  
Ti sheh vetëm vise të shkreta  
Ta zhytura në mjegull

Ti e kupton se kuajt e verbër të fjalëve  
Që ecin kuturu  
Nuk e dinë se ku venë...



# Proteza e poetit

Tregim nga

## KONSTANDIN DHAMO

Më mori QSh në celular, në një orë që s'para bëhej i gjallë, por sa mirë që e dëgjova zilen natë zallamahinë e rrugës, me bori makinash dhe rrapëllima motorësh.

- Alo, hë more poet, nuk je në klasë duke dhënë mësim?  
- Jo jo, po ti në rrugë qenke, me ç'po kuptoj nga zhurrmat që hyjnë në mikrofon ?

- Po po, kam dalë thjesht për të parë ç'bëhet jashtë shtëpisë sime dhe, të takoj rastësisht ndonjë të njohur ; ti ma di zakonin tim : s'bëj dot po s'dola në rrugë, me t'u ngritur nga tryeza, ku shkruaj palëvizur tri orë të mira. Ne prozatorët, ndyshe nga ju të ndritshmit, s'presim të na ngjisë frymëzimi në qiell, ulemi e shkruajmë edhe në të thatë ...

- Aman se e di; atëherë, a mund të takohemi te Killing Time, te kafa jonë pra, sa më shpejt të jetë e mundur ?  
- Poo, jam fare pranë, Killing Time – it, ja erdha ...

E sheh, s'ma tha ç'urgjencë kishte, në këtë orë, kur duhej të ishte me nxënësit në klasë ? Por, dale dale...

E gjeta të ulur në një tryezë pranë dritares, jo thellë lokalit ku rrinim rëndom dhe, po pinte cigare ; kafen dhe rakinë, siç duket e kishte porositur kamerierin , t'i shërbente kur të mbërrija edhe unë. Dhe, vërtet, pas pak , ai na i solli të dyve kafetë dhe gotat e rakisë.

- Të falënderoj një mijë herë që më erdhe, por mos le ndonjë punë pa kryer ?  
- Ta thashë përse kisha dalë ; ç'kemi ?

- Lëre, jam i tëri i mbërthyer nga gripi, siç edhe dukem : rrufë, kollë, sy të lotuar,, por ja të të rrëfej përse e ndërpreva orën e mësimi ; nuk ta ngjis gripin, jo !

- Fol ...

- Po shpjegoja Hamletin e Shekspirin, ashtu me shpirt ndër dhëmbë, tek qëroja zërin herë pas here që të më kuptoheshin fjalët, pavarësisht se, nga e gjithë klasa veçse tre nxënës te bankat e para më ndiqnin, duke më vështruar në sy ; të tjerët, e sidomos andej nga fundi i klasës, shkriheshin si gjithmonë, tek komentoni ato çka ndiqnin n'ekranin e celularëve, me gjasë video porno, apo tek putheshin të përhumbur në qejfin e tyre.

Ti miku im, asqë e ke idenë se ç'bëhet sot në orët e mësimi, megjithatë ca gjëra i ke dëgjuar.

Epo mirë, u tërhoqa vëmendjen nxënësve, ja t'ju deklamoj disa vargje nga tragjedia, sepse do t'ju mahnitin, për më tepër që tingëllojnë aktualë me ata mesazhet që përcjellin. Si mund të jetë ndryshe, përderisa i papërsëritshmi Shekspir i përket të gjitha kohëve ?

Për çudi u kthyen të më ndiqnin ! Mirëpo tani që po ta tregoj ty këtë moment, ke parë ti, që po më vete mendja të të them se ata të shkurdisurit, nxënësit e mi, të cilët gjithsesi i dua, më kanë marrë për të çmendur ; hihii...

Qeshi hidhshëm, tek mahiti veten, dhe më pas shtoi :

- Gjashtëdhjetë e tre vjeç unë tashmë, me fytyrë të fishkur, i shogët dhe, me gjyslykë me qelqe të trashë, pale si iu duka atë çast atyre, që janë o Zot, të bukur të bukur, plot freski e ëndrra ! Më thuaj, e si na dalka mësuesi gjatëdhjetë e pesë vjeç në pension ? Hajt t'i shty unë dhe dy vjet, sa ç'më kanë mbetur, uf !

- Epo...

- Por ç'më ndodhi ! Teshtiva papërmbythshëm , aq fort, sa më doli nga goja proteza dhe m'u përplas përtoke ! O Zot , sa zor më erdhi e sa ngushtë u zura ! Ata nxënësit e mi, indiferentë gjer para pak minutash, shpërthyen në të qeshura e s'mbaheshin !

Bëra të vë buzën në gaz, por jo ore, jo, s'ia dola dot; nxora kartopacetat, krejt i hutuar dhe, tek u përkula shtrembër – shtrembër, e mbështolla protezën me to dhe e ngjasha në xhep. Sakaq, dola nga klasa, i goditur pas shpine nga vështrimet e të qeshurat...

Më ra koka mbi gjoks dhe, mezi po çapitesha në korridorin e gjatë, ndërkohë që nxënësit, gjithë ç'ishin e lanë klasën, por nuk m'u avitën. Buzët m'u palosën me njëra – tjetërën, dhe po mendoja, a do të isha apo jo në gjendje t'i artikuloja siç duhej fjalët, kur të më lypsej të flisja, përse kohë e kisha protezën ende në xhep ?

Bobo ; por tek po e prekja me nervozizëm mes kartopacetave të zhubrosura, m'u nda dy copash ! Mesa duket do t'ishte krisur kur u përplas përtoke.

Dhe shih, ia behu drejtori i shkollës sonë, një shpifarak me tesorë partie në xhep ! Bisedoi me nxënësit së pari, pastaj nxitoi hapin dhe më zuri mua .

- Zoti mësues – m'u gërmush me ironi – ku vete, të kthesh ndonjë gotë raki në kafene, sepse ti sarhosh je, kush s'e di këtë ? Flet keq pastaj edhe për qeverinë andej nga përziesh me ca...

- Zoti drejtor, - iu ktheva i përmbajtur, duke përdorur enkas po atë ndjashtim që përdori ai – më ndodhi diçka e papritur ; teshtiva rëndë dhe m'u shkëput nga nofulla proteza, e më ra përtoke, ja e kam ende në xhep, tashmë të ndarë më dysh ! Si ta vazhdoja mësimin, pa të në gojë nuk flas dot, ja ti po e sheh vetë mesa vështirësi po i shqiptoj fjalët !

- Ktheu në klasë dhe, bëj si të bësh, mos i lër nxënësit pa mësim, ç'justifikim është ky ? Mos na hapni probleme, ju lutem, na duhet ta ruajmë kreun midis gjithë gjimnazëve të kryeqytetit ; nxënës, futuri në klasë !

- Nuk iu binda ; ndërkohë e përmblodha veten dhe thashë ta ndalja atë numërorin e partisë, me një luzmë të sharash, eh, por hoqa dorë aty për aty, shpërfille më mirë, arsyetova. A e di ti se, ky farë drjtori vdes të më qesëndisë : e mo ju poetët, na ndritët ...

O , po s'ta kam thënë : ky tartakuti, edhe kur nxehet e ngre zërin, ia del të flasë pa lëvizur buzët, si një ventrilokuist i njëmendtë, poo !

- Shiko shiko !

- Ktheu, - më urdhëroi përsëri në fund - mos e braktis mësimin, do të propozoj menjëherë të të përjashtojmë nga puna, ku vete, flet njeriu edhe pa dhëmbë në gojë, si kanë bërë t'ururarit prindërit tanë, kur nuk ishin shpikur këto t'uruarat proteza...

- Ke orë tjetër mësimi për sot ?

- Jo . Ato të qeshurat më përzunë nga shkolla, ik ore, më shtynë fyeshëm, mos të të shohim më në klasë...

- Ç' thua kështu ? Ktheu në shkollë, po të porosis edhe unë, ndonëse pa u bërë paullë me drejtorin ; je tepër i ndërkryer . Takoj drejtorin, dhe thuaj : me dhëmbë – pa dhëmbë, nesër do të paraqitem në shkollë .

- Jo të lutem, kursesi jo !

- Atëherë, çfarë s'po vlerësoj unë aqsa ç'duhet nga e gjithë kjo dramë që më rrëfeve ? Ta kishe vazhduar mësimin ; s'kishe nevojë ta ndërprisje Hamletin. Ja, i fusje një të qeshur sarkaztike prej loloje thumbues, prej loloje shekspirian pra, dhe vazhdoje; komiken tragjedia e pranon dhe e do. Përftove ca impulse goditëse, me ç'po kuptoj nga monologët e Hamletit : kjo botë u shtur, o prapësi, o dreq, që unë paskam lindur të të ndreq ...

- Shkove ca larg në fund, unë s'ndreq dot veten time , hehe !

- Mirë , mirë, po nervin e tragjedisë e përftove pavetëdijshëm, me gjithë zotimin sublim të Hamletit. Harold Blumi ka thënë se, pas Krishtit, Hamleti është figura më e cituar në koshicën perëndimore ! Hë mo, se dua të të ngas ca.

- S'kam mik si ty , por dëgjo tani, ky episodi i protezës, ishte si të thuash, ajo pika e ujit, që derdh kupën e mbushur tej e majë . Askush s'na ndjek ne mësuesve, kur shpjegojmë lëndën përkatëse, lëre ç'ke dëgjuar lart e poshtë ; eja ndonjë ditë me mua në shkollë dhe, pastaj llafosemi, ehu, nuk kthehem më në klasë !

- Dakord, atëherë, a do të takohemi, po këtu pasdite ?

- Si s'do të takohemi, kam shumë nevojë ...

- Mos pandeh se harrova, qoftë edhe për një çast të vetëm që ju poetët keni ndjeshmëri të lartë...

Kështu i thashë, por e keqja është se, nuk u kujtova asfare që mikut tim të talentuar i ka vdekur sakaq bashkëshortja, e cila e donte dhe e përmblidhte . Dhe ja, ai tashmë e tregoi veten se është nga ata burra që nuk e përballon dot vejërimin...

Mendo, ç'sinkronizim i përsosur ! Pasdite sa s'bëmë bam me njëri – tjetrin, që në krye të rrugës, ku ndodhet Kafe Killing Time ! Pa shih pa shih, poeti dukej i gëzuar, por më lejohet të them : i lumtur ! Hehe, si po e pinte cigaren, a thua se po aktronte tallshëm.

- Çfarë më ndërmende paradite – m'u ktheje – se lolua shekspirian është therës, pikë helmi është, tek qeshengjesh kur aludon për kurvëritë e mbretëreshave, apo për brirët e mëdhenj mbi kokën e mbretit ?

- Eh, ca të tilla të thashë afërsisht ; pa më thuaj, ke pasur ndonjë herë më parë ti portret më interesant se sot : buza e sipërme të lëpin mjekrën, e ajo e poshtmjatë lëpin përkëdhelshëm majucën e hundës. Ç'bërë, e çove protezën të ta ngjisin e të ta shkurtojnë pak, që të të mos lëvizë më në nofull ? Ashtu ? Mirë paske bërë që e çove, o, e merr që pasnesër të ndrequr ? Mrekulli !

- Do të kisha dashur të porosisja një të re, por ja që kushtonte shumë, unë bëj pjesë te të varfërit.

- Kemi dymijë vjet, që mes predikimeve na thonë se, varfëria është një virtut, jo një fatkeqësi, kështu që ti je për t'u admiruar, o mësues poet dhe përkthyes i Kiplingut, Pushkinin dhe haikut e Basho - s ! Nesër në mëngjes hyr në klasë dhe, shpjegojua Shekspirin nxënësve nga e para, sipas këndvështrimit të Lolos ; ke për të parë sesi do të të ndjekin të përgjendruar, më në fund, ata nxënësit e tu të pashëm, por edhe të mirë ! Si the, po drejtori ? Hahaha ; kur t'i shfaqesh përpara si Lolo, me atë surrat të përvjelur, do të të duket i përdhosur, hahaha...

"Unë jam e bazuar mbi persona të vërtetë"  
-Kristina Lugn

Në vjeshtën 1989, po pastroja tavolinat si kamarier diku në jug të Suedisë, kur në ekran të madh të restorantit shfaqet një grua jashtë konteksti. Më kujtohet që reagoja, pse ajo dallonte nga figurat e tjera në tv. Leshkuqe e pakrehur, me sy të enjtur, me një veshje eklektike dhe një të folme të ngathët, me fjalë që i dilnin ngadalë si rob lufte, e me një shikim të hutuar që sikur kërkonte shpëtim diku në tavan, a ende më lart. Shihej qartë se ajo grua u kish hyrë gabim në studio. Suedishten s'e dija ende mirë, por kaq po arrija të kuptoj, se po flisnin ose për pemën e ahut, ose për një libër: të dy e ndajnë të njëjtin homonim, bok. Do të jetë pema e ahut, më kujtohet tek mendoj. Agronome qenka, shkrimtarët vishen mirë. Kur dua ta konfirmoj njohurinë e suedishtes me pronarin e restorantit, një zdad ulqinak që kish jetuar me vite në Suedi, ai ma bën me dorë që të mos e çaj kryet. Është një shkrimtare e trentë, më thotë, si shtrigë; ik mbaro tavolinat. Kohë më vonë do të kuptoja se ajo gruaja e hutuar paskësh qenë Kristina Lugn. Ata të ftuarit tjerë në studio ishin shkrimtarë e kritikë letrarë, të ftuar aty për të diskutuar përmbledhjen e saj më të radhës me poezi, të botuar në tetor 1989.

Disa shkrimtarëve u duhet që të vdesin, pa të bëhen të pëlqyeshëm. Kristina Lugn, një ndër emrat më të njohur të letërsisë suedeze, poete, dramaturge, eseiste, autore 55 librash të botuar dhe fituese e një sërë çmimesh letrare, bën pjesë pa dyshim në këtë çetë të profetëve. Ajo dikur quhej "gruaja më e vetmuar në Suedi"; një eufemizëm ky, sa për të mos thënë gruaja më e urryer. Është çudi se sa i provokon gjindjen dikush, sidomos një grua, që refuzon të krehet e të ndjekë rregullat. Por me kalimin e viteve, urrejtja kaloi së pari në respekt, e pastaj në adhurim. Tek po i afrohej ditëlindjes së gjashtëdhjetë, Kristina Lugn u zgjodh nga Të tetëmbëdhjetët e Akademisë Suedeze si një ndër ta, një nder ky që konfirmonte publikisht vendin e saj tashmë të pranuar në letërsinë suedeze. Sot Kristina Lugn vlerësohet *post mortem* si një nga zërat më origjinalë të kësaj letërsie, e është e përkthyer në dhjetëra gjuhë.

Gunhild Bricken Kristina Lugn, si qe emri i saj i plotë, u lind më 1948 në Tierp, një qytezë kjo e vogël jashtë Upsalës. Babai i saj, Robert Lugn, ishte gjeneralmajor, nëna Britta-Stina lektore në Universitet të Upsalës. Në kujtimet e veta Kristina Lugn tregon se, kur ish e vogël, i jati i lexonte para gjumit biografi burrash të shquar. E ëma, ndërkaq, i thoshte që ta presë moshën e shkollës për të mësuar germat. Kristina e vogël kureshtare mëson që të lexojë për inat të së ëmës, para moshës pesë vjeç, nga revista të animuara për fëmijë – "më dukej sikur po zbërtheja një sekret magjik të botës së të rriturve", do të thoshte ajo më vonë. Por prindërit ndihen të brengosur. Vajzës së tyre të vetme i ka ëndja të lexojë "shkrime koti", poezi e tregime.

Idoli i Kristinës së vogël është gjyshja mizantropë, që lëçit njerëzit dhe izolohet në nënkulm për të lexuar. "Prindërit e mi e quanin sakate, thoshin se plaka s'di të shoqërohet me njerëz ndaj shoqërohet me libra; por mua më dukej sikur bota e tyre ishte sakate, e se gjyshja kish sajuar një botë më të mirë në papafingo". Gjyshja e Kristinës, Gunhild Henschen, kish dalë asokohe në pension si drejtore e Muzeut të Egjiptit. Jetëshkruesit mendojnë sot se kjo lidhje e hershme me gjyshen, si dhe afiniteti që kishte Kristina Lugn për të lexuar herët, do të kenë qenë ndër ato shtysat e hershme që ushqejnë genin e shkrimtares. Kur rritet, Kristina i ngjan gjyshes edhe në pamje. I njëjti stil leshkuqesh të pakrehura, pa grim, në devijim demonstrativ nga çdo modë e veshjes dhe nga çdo ide për kultivim imazhi. Ku ta dish? Gjenitë mbase kanë nevojë për një shembull çlirues se si të ndjekësh rrugën tënde, pa ia varur fort pritshmërive të botës.

Një tjetër shtysë për krijimtarinë e Kristinës së vogël është biblioteka e shkollës. "Në rastin tim, ishte bibliotekarja e shkollës fillore, qoftë e bekuar aty ku është, që më ngjalli kureshtjen për librat e të rriturve. Nga letërsia për fëmijë, drejt e te Selma Lagerlöf",

# Kristina Lugn, shkrimtarja suedeze që u quajt shtrigë

Nga Shqiptar Oseku



thotë Kristina Lugn, në një intervistë dekada më vonë. Në Suedi, puna në bibliotekë kërkon specializim universitar, me 3 vjet studime e diplomë të veçantë, 180 pikë akademike në sistem të Bolonjës. Kristina Lugn punon vetë me vite në bibliotekë pas diplomimit në Universitet të Upsalës. Ajo thekson në shumë ese të veta rolin vendimtar që ka biblioteka publike për t'i udhëzuar fëmijët kureshtarë kah letërsia cilësore dhe shija e mirë estetike.

Gjatë studimeve universitare, Kristina Lugn provon, si duket, t'i japë një mundësi jetës konvencionale. Ajo martohet dy herë, por ndahet në afat rekord, e bën fëmijë me një burrë të tretë. Dardha nën dardhë, si thonë: vajza e saj e vetme, Martina Montelius, është sot shkrimtare dhe dramaturge e njohur në Suedi. Ajo ka përshkruar shpesh dritëhijet e rritës me një nënë kreative, e cila besonte në edukim të lirë, e jo në "kurthet" e sigurisë ekonomike.

Përkundër dramave personale – ose ndoshta falë tyre? – dhuntia letrare që ka Kristina Lugn buis. Më 1972, ajo merr një magjistraturë në letërsi, gjuhë nordike dhe histori të artit, si dhe boton përmbledhjen e vet të parë me poezi; për të vazhduar pastaj me nga një përmbledhje të re poezish çdo dy a tri vjet. Suksesi i parë publik quhet një përmbledhja me poezi të cilën e boton më 1983. Aty Kristina Lugn shtjellon me vetironi personazhin e një gruaje të mpakur për dashuri të sinqertë, e cila kërkon njohje me burrë të përshtatshëm përmes një njoftimi anonim, nga ato anonset që botoheshin dikur në gazeta. Në përkthim shqip, titulli do të ishte, përafërsisht, "Kërkoj njohje me një burrë të edukuar dhe në moshë". Poezitë në atë përmbledhje janë një sërë skenash tragjikomike ku kryepersonazhi grua, që vuan nga ankthi e depresioni, kërkon shpëtim në pilula, alkool, seks, e trope poezish; skenat janë të interpuntuara nga intermezzo në trajtë përsiatjesh të ndjera për gratë, burrat, fëmijët dhe natyrën e gjërave.

Gjuhën risimtare që ka Kristina Lugn te kjo përmbledhje, e të cilën e ka ruajtur edhe

në shkrimet e tjera, është quajtur më vonë vetërrëfyese, e është krahasuar me atë nga Anne Sexton. Por ndërsa Anne Sexton ka gjuhë neo-simplistike, e skena nga realizmi i përditshëm, stili që ka Kristina Lugn anon më fort kah absurdi. Kristina Lugn ka vetironi dhe një humori të zi absurd, pothuajse morbid, që gërsheton artin me banalitetin e të përditshmes. Pikërisht ky efekt i mprehtë kontrasti midis së lartës dhe së ultës ia bën poezitë, por dhe tekstet e mëvonshme teatrale, tejet goditëse. Në vitet 1980 dhe gjer në vitet 2000, Kristina Lugn ajo e lë poezinë dhe shkruan vetëm ese dhe tekste dramash, që i inskenon në një skenë të veten në Stokholm. Por dashuria e vjetër s'ndryshket kurrë, thotë një proverbë suedeze. Kristina Lugn i kthehet poezisë, me një përmbledhje më 2003, e cila quhet event i letrar i vitit në Suedi. Dy botimet e saj të fundit, më 2020 dhe 2022, janë po ashtu përmbledhje me poezi. Në këtë kohë ajo është e kudondodhur në media, në shtyp, në radio e në tv.

Karriera letrare dhe paraqitjet publike e kanë bërë shkrimtaren Kristina Lugn ikonë të letërsisë suedeze. Mirëpo, stili i saj ka ngjallur ndër dekada edhe reagime urrejtëse. Mund të tingëllojë e habitshme kjo sot, që një grua shkrimtare në Suedi (!) të provokojë aq fort urrejtje e distancim nga burra, por edhe nga gra, thjesht pse ndjek një rrugë të veten në shkrime e në paraqitje publike, pa i shkrepur në kokë se ç'mendojnë të tjerët për të. (Apo ndoshta jo aq e çuditse, po të shikosh reagimet që bëjmë edhe sot ndaj disa autoreve tona gra.) Ai zdapi ulqinak tek i cili punoja në vjeshtën 1989 s'është se kish ndonjë interes të tepruar për letërsinë. Idenë se Kristina Lugn qenkësh një shtrigë e trentë, do ta ketë marrë nga diskursi publik suedez. Kur lexon sot reagimet e kritikëve të saj të hershëm, të sajojnë një *cringe* tragjikomik, në nivel me atë tragjikomikë të cilën ta sajton vetë leximi i shkrimtares Kristina Lugn. Retorika pasiv-agresive delsheshit. Si mund të jetë dikush kaq e papërgjegjshme?! Si kërkuake një dashuri të

sinqertë, ndërsa mbytesh me pilula e alkool? A s'është kjo që shkruan Kristina Lugn veçse një hymnizim letrar i dekadencës dhe nihilizmit? Wfarë shembulli për rininë japin shkrimtarë si ajo? E si do të duhej bota sikur të silleshim të gjithë si ajo?

Them se shumë nga këto reagime janë shkaktuar pse gjindja e kanë pasur të vështirë të ndajnë shkrimtaren Kristina Lugn nga personi Kristina Lugn. Ajo vetë tregon në një intervistë se si nganjëherë nuk është ndier e sigurt në rrugë. "Një herë tek po shkoja në punë më kalon pranë një zotni i panjohur, i veshur mirë, tip drejtori. E ma fut një plloskë pështyme drejt e në surrat. Pa thënë asnjë fjalë. Ecën tutje, burri i botës, s'e kthen as kryet të shikojë", tregon Kristina Lugn në një intervistë. "Më duket se ai, e shumë të tjerë, mendojnë se unë jam personazh në tekstet e mia. Por unë s'jam figurë në libër. Jam e bazuar mbi persona të vërtetë".

Pikëkthesa në perceptim publik ndodh më 2006, kur anëtarët permanentë të Akademisë Suedeze e zgjedhin njëzëri që të trashëgojë stolin nr 14 të një kolegut të tyre akademik, i cili sa kish ndërruar jetë. "Kristina Lugn do të jetë një zë i shumëkërkuar rebel i poezisë në mesin tonë", shkruante Akademia Suedeze në një kumtesë për shtyp. "Humori i saj therrës dhe i errët dhe aftësia e saj për të eksploruar përditshmërinë e gruas dhe mangësitë e qenies njerëzore do ta zgjerojnë rrezën e Akademisë." Kristina Lugn ishte asokohe gruaja e pestë në mesin e tetëmbëdhjetë anëtarëve permanentë të Akademisë Suedeze. Ajo ka dëshmuar vetë më vonë se vendimi i kish ardhur në orë të zorit. "Atëbotë kisha vetëm 7 mijë krona pension (diku rreth 600 euro) dhe ai vendim më shpëtoi".

Ne s'mund ta dimë se si e pritën atë lajm tipat si ai drejtori, a ai zdapit prej Ulqinit. Por dihet se mbas pranimit në akademi, Kristina Lugn u shndërrua gradualisht në figurë të respektuar dhe, më vonë, në ikonë të idhuruar të letërsisë. Aty e tutje, gjindja do ta ndalnin vetëm për t'i kërkuar autograf. Një nga ata është edhe i nënshkruari këtu, një nga thesaret e vocra të bibliotekës sime personale është një përmbledhje me poezi nga Kristina Lugn me përkushtim të shkruar nga ajo dora vetë. Mbaj mend se si qeshi kur i tregova shkurt për zdapin nga Ulqini, që e kish quajtur shtrigë të trentë që shkruan libra. "Në përvojën time", më tha, "burrat e gjatë shohin gjithmonë më larg." Koment tipik à la Kristina Lugn.

Kristina Lugn vdiq në maj 2020, sot varri i saj modest ndodhet në varrezat e Kishës së Mariës në qendër të Stokholmit. Në intervistën e vet të fundit, Kristina Lugn flet për fundin e afërt. "E kam shumë zët vdekjen, më duket fort e ligë. Gjindja thonë shpesh, të dua përgjithmonë. Por kjo është rrenë. Del për cigare dhe të shtyp makina, e u lë shëndën të gjithëve. Vdekja na bën të gjithëve kaq të pafuqishëm." Gazetari e pyet nëse beson në jetë të përtejme dhe Kristina Lugn i thotë jo. "Po të kish ekzistuar jeta e përtejme, gjindja do të lajmëroheshin që andej. Jo çfarë, s'besoj hiç në të tilla." Por Kristina Lugn s'do të ishte ajo që ishte pa një kundërtënie në fund. Ajo shton: "Unë kam hasur shpesh në të vdekur dhe gjithmonë në lagjen e jugut. Një herë ishte një shoku im i vjetër, e përshëndeta. Tek po flisja më të kisha harruar se kish vdekur. Kështu që vetëm folëm kot, s'është se thamë diçka të veçantë."



\*\*\*

Mos qaj më!  
Mos rënko!  
Mblidhe veten!  
Bëj vetullat!  
Zgjat qerpikët!  
Mbaj nervat!  
Ndreq flokët!  
Pastro hundët!  
Rruaj mustaqet!  
Merr një sedativ!  
Pse rri aty si e marrë  
Fikalle e kërrusur,  
Mos qaj më!

\*\*\*

Ky Patriku është kaq i mrekullueshëm.  
Nga njëherë më duhet ta përplas kryet në  
derë frigoriferi dhe nga njëherë  
më duhet t'i prej thithkat me gërshërët e  
vjehrrës  
dhe nga njëherë më duhet të hidhem hopa  
nën makina mu në mes të ditës  
Por ai s'do të bëjë seks megjithatë.  
Në asnjë rrethanë.  
As seks oral, as gjenital, as anal.  
Absolutisht jo sa e kam këtë shprehje në  
fytyrë.  
Ai s'bën kurrë seks me gra që kujtojnë  
se mund të kenë një jetë të dytë pas  
menopauzës.  
S'ia ka ëndja, më thotë.  
As intelektualisht, as emocionalisht.  
Është çështje parimi, më thotë.

\*\*\*

Së pari përbiva njëmijë pilula  
pastaj preva damarët  
pastaj u futa flakën flokëve  
pastaj kërcëva theqafesh  
nga dritarja në kat të tetë  
pastaj u zgjova në shtëpi  
në dhomën e gjumit me lulka në mure  
dhe burri më ish ulur pranë  
e zgërdhihej si dash  
e po më thonte  
se gjithçka do të ndihej shumë më mirë  
sa të bëhej verë  
se do të kënaqeshim me njëri-tjetrin  
në Las Palmas

\*\*\*

Provo të kuptosh  
se për çfarë po të themi  
është shumë më vështirë  
se sa tingëllon  
se tingëllon bukur vërtet  
por provo të flasësh  
me ne, provo të tingëllosh  
sikur të ishe një nga ne  
mut i vogël  
ne dukemi aq të njerëzishëm  
të hedhim sheqer në çaj çdo mëngjes  
të ofrojmë çokolatë të ngrohtë çdo mbrëmje  
edhe të puthim nga njëherë  
mut i vogël  
por provo të kuptosh se çfarë  
të kemi mësuar!

\*\*\*

Njeriu me të cilin ndaj jetën  
vallëzon  
në dhomë të gjumit  
një njeri i poshtër  
po kënaqet atje tej  
atje në brendësi atje në largësi  
jashtë rrezes përjashta  
fushës së shikimit tim i ndryrë  
filli vetëm  
kërrusur  
më pret një qenie e gjallë  
durueshëm  
e pëshpërit

# POEZINGA KRISTINA LUGN

*Përktheunga suedishtja Shqiptar Oseku*



\*\*\*

Vajza e vogël  
nuk më njuh  
ime bijë e bukur  
s'është imja  
ky burrë i njerëzishëm  
që ia mban dorën  
në dorë të veten  
shihet se është  
i panjohur

\*\*\*

Në një shtëpi flakë të verdhë me qira  
përballë një pallati flakë të verdhë  
pranë një pallati flakë të verdhë

në një tridhomëshe moderne  
me kthinë flladi frigorifer friz me ngrirje të  
thellë  
dhe banjo me bidé

në një stol në kuzhinë  
rri ulur një burrë simpatik  
e lexon gazetën

ka veshur çorape të murrme  
ka veshur brekë flakë të kuqe  
mbi të cilat shkruan Las Vegas

prapa kokës së tij është një pikurë  
që shfaq një fëmijë tek e ndjek  
një brumbull

nëse i shtroj çarçafë të pastër  
në shtratin dysh nëse ia vendos  
një Coca Cola të ftohtë mbi komodinë

ai bëhet shumë qejfli ai shtiret  
se nuk m'i sheh  
qimet e bezdisshme në fytyrë

\*\*\*

I dashuri u lodh e u largua  
mori valixhen e u largua  
pasi i kish hapur lulet  
aq bukur mbi trup tim  
i dha fund e më la  
ndërsa isha ende shtrirë me lulet  
nderë në shtrat tek po i këndoja  
kërdhokulla llërë kofshë e buzë  
i këndonin, i ngrenin në qiell  
lulet e tij, shpirti tim, zemra ime  
dridheshin e i këndonin oda  
e policë në parzmore antiplumb  
ruajnë tashti  
hyrjen e daljen time

\*\*\*

në një çast të pavërejtur  
qëllova mbi të në fakt  
në një qast të pavërejtur  
i dhashë zjarr më në fund  
në një sekond krejt të bardhë  
ku ishte krejt vetja ime  
e bëra copash të tërin  
e i urdhërova tërë kujtimet e tij  
që të zhbëheshin  
ashtu që të miat të rronin

\*\*\*

Netët janë bërë më të mëdha  
e vazhdonë të rriten  
së shpejti s'do të ketë më vend  
për to në kokën time  
e pra ka kaluar shumë kohë  
qyshkur janë ndier fëmijët  
ka kaluar shumë kohë  
qyshkur isha vajzë e prapë  
e shumë e lastuar  
në shtëpinë e prindërve me tulla të kuqe  
gjithçka që prekja me dorë  
i takonte dikujt tjetër  
dhe prindërit e mi ishin të bindur  
se më donin fort

\*\*\*

Nuk jam përdhunuar kurrë  
në një mapo vërtet ekskluzive me zonja  
në lejla e me shishe të vogla e pasqyra  
me korniza ari e kuti rozë  
e detektivë tmerrësisht diskretë, me yje  
mbi qepalla, dritë hëne mbi sutjene, me  
çizme  
e makina me luks të hatashëm e me ulëse  
ku njeriu fundoset  
e vdes

\*\*\*

Kryet plot  
me qetësi artificiale  
e Mpirë dhe e Lumtur  
një puthje e prehjes e paqes e  
dashamirësisë  
një Kiss of Fire dhe një Fuck Forever  
dhe shumë zanafilla të lumtura  
me qeshin në bark

\*\*\*

Tashti shtrihu këtu  
e mos shqetëso më  
shtrëngo duart fort  
rreth fshehtësive e buzëve tua

ato duhet të heshtin  
– fëmijët flejnë dhe nata ka rënë  
si në përralla vdekja është këtu  
e ti duhet të mbash gojën

\*\*\*

Në zgjohesh  
edhe mund të vdesim  
por nëse të rri pa luajtur  
e shtirem se s'di  
sa e vetmuar që jam  
por nëse mbyll sytë fort  
e s'lëviz fare  
nën trupin tënd  
ndoshta ti kujton  
se jam grua e mirë  
nëse s'lëviz fare  
përfundi gjumit tënd

\*\*\*

Gra të shëmtuara  
heroina të përgjumshme të së përditshmes  
nëna që duan dhembshurisht  
përpiqen e mundohen e bien copë  
heshtin e heqin sa munden  
mëmëgjyshe tatëgjyshe vjehrra  
nënqeshin të kënaqura në fotele  
në divane në ulëse me rrotë në arkivolë  
babai s'është as sot në shtëpi  
babai ka ikur me punë edhe sot  
fëmija e ëmbël si sheqerë rozë  
është e nderë e gjëmon  
në dhomën e vet të bardhë dhe fqinjet  
punonjësit socialë ndihmësit  
mësuesit priftërinjtë infermierët  
vrasësit profesionistë piromanët  
e presin të gjithë çastin  
atje në dhomë të ditës

\*\*\*

Gratë zhvendoseshin më afër Burrave  
të cilët vinin krahët  
mbi supe të Grave  
dhe Gratë i mbronin Burrat  
me flokët e buta, i hapnin  
flokët mbi fytyra të Burrave dhe Burrat  
i hapnin trupat e vet të fortë  
mbi trupa të Grave  
e rrinin aty të shtrirë pa u ndier të gjallë  
në heshtje të plotë, të puthitur,  
ndërsa unë, me vëmendje të madhe  
u shkoja përskaj

\*\*\*

Kam lyer muret në dhomën tënde  
rrobat tua i kam dhënë, librat t'i kam shitur  
shtratin ta kam fshehur në qilar  
ta kam ngrënë ushqimin  
ta kam ngushëlluar plakën

Mungesa jote po nis të zbutet  
Uroj që edhe ti të ndihesh mirë  
mos u mërzit pa nevojë!

\*\*\*

Si ishim më së miri  
duke shetituar nëpër rrugë fshati  
kolegu im e unë dhe errësira  
po rritej disi përreth nesh  
kur atij befasi mbaroi durimi  
e më përdhunoi  
unë ngela aty në tokë të ftohtë e po rënkoja  
rrobat copë e çikë  
menjëherë mbas krimi ai ia kish mbathur  
më kish lënë vetëm në errësi  
unë rënkoja villja qaja më dilte gjak  
pas disa orësh m'u ndal një Mercedes i zi  
pranë, një mësues në fillore 30 vjeç  
e uli dritaren e më bëri zë:  
a mund të të ndihmoj gjë  
unë iu ula ngjitur në ulëse të parme  
e pak kohë më vonë  
tingëlluan këmbanët e dasmës

(Vijon në faqen 21)

Në kopshtin tim në Kaliforni, pranë portës së kuzhinës, është një portokall. E shikoj dhe i ndjej aromën. Është gjithë lule. Nuk mund të shoh një portokall në lule pa menduar për Cagnes; dhe mendimi për Cagnes sjell menjëherë tek unë imazhin e tim eti. Aty ai kaloi pjesën më të mirë të viteve të tij të fundit; aty edhe vdiq. Në shtëpinë e tij, në Collettes, aroma e portokajve është gjithmonë e njëjta dhe ullinjët e vjetër nuk kanë luajtur. Ka shumë bar. Një bar i varfër, por i lartë dhe i dendur, gri edhe pse në mes të dimrit, i përbërë prej llojeve nga më të ndryshme e të përziera lulësh të egra që mund të merren me mend. Është diçka e thatë dhe e harlisur, e hirtë dhe me ngjyra njëkohësisht, siç janë shpesh gjërat në Jug të Francës. Aroma e saj nuk të përplasat vullshëm në flegat e hundës si bari në rrethinat e Aix-en-Provence. Është më e hollë, por e paharrueshme. Po të më çonin në Collettes me sy të lidhur, do të më mjaftonte të ndjeja atë aromë për ta njohur vendin.

Hija e ullinjve të dendur është ngjyrë mullage; është gjithnjë e lëvizshme, e ndriçuar, plot shend e jetë. Po të kalosh andej, ke përshtypjen se Renuari është akoma aty dhe për një çast mund ta dëgjosh duke kënduar tekta ia shkel syrin telajos. Ai është pjesë e peizazhit. Nuk duhet shumë fantazi për ta parë kapelën prej kanavace të bardhë të vendosur në mënyrë të çuditshme mbi kafkën e lartë. Fytyra e tij e dobësuar ka shprehjen e një ngacmimi të dashur. Gjatë javëve që i paraprind vdekjes, trupi i tij aq i dobët dhe krejt i paralizuar, nuk i bënte fare përshtypje as Gabrielit, as mua apo vëllezërve të mi dhe të gjithë atyre që ishin përreth. Ishin mësuar, aq sa edhe Renuari vetë. Tashti, nga largësia e kohës e shoh akoma më mirë. Më vijnë në mendje krahasime të lehta: në Algjer, evropianët i quanin pleqtë arabë "trungje fiku"; në Francë, shkrimtarët që linin pas dore sjellje të shtirura fshatareske përdornin shpesh shprehjen "rrënjçe hardhie" për të përcaktuar një fshatar të dobët e të shtrembër. Imazhe të tilla shkrihen mbi analogji të pastra fizike. Për sa i përket Renuarit, mendimi mund të shtyhet përtej krahasimit, për të sjellë në mendje frutat e mrekullueshëm dhe bujarë që fiku dhe hardhia nxjerrin prej një toke shkëmbore.

Im atë kishte diçka prej një plaku arab dhe shumë prej një fshatari francez, me ndryshimin se lëkura e tij, e mbrojtur përherë prej diellit nga nevoja për ta mbajtur kanavacën jashtë reflekseve mashtruese, kishte mbetur e çelët si ajo e një adoleshenti.

Ajo që befasonte të huajt që takoheshin me të për herë të parë ishin sytë dhe duart. Sytë ishin ngjyrë kafe të çelët, që anonte nga e verdha; kishte një shikim shumë të mprehtë. Shpesh na tregonte në horizont një grabitqar që fluturonte mbi luginën e Cagnes apo një mollëkuqe që kacavarej gjatë një fijeje bari fshehur prej fijeve të tjera të barit. Me gjithë sytë tanë prej njëzvetjçarësh, ishim të detyruar të kërkonim, të përqendroheshim, ta pyesnim, ndërsa ai e gjente menjëherë gjithë çfarë i interesonte, larg apo afër goftë. Kaq për sa u përket karakteristikave fizike të syve të tij; ndërsa për shprehjen e shikimit të tij, imagjinoni një përzjerje të ironisë e të butësisë, të ngacmimit e të argëtimit. Dukej sikur sytë e tij qeshnin gjithmonë, që vërenin para së gjithash anën zbavitëse të gjërave, por ishte një qeshje e dashur, e mirë. Apo mos vallë ishte një maskë; në fakt ishte tejet modest dhe nuk donte që tjetri t'i vinte re emocionin, një emocion që njerëzit e tjerë ndjejnë kur prekin apo përkëdhelin, që e kapte vetëm duke parë lulet, gratë apo retë në qiell.

Duart i kishte të deformuara në mënyrë të frikshme. Reumatizmi ia kishte shkatërruar artikulationet, duke ia përkulur gishtin e madh drejt pëllëmbës dhe gishtat e tjerë drejt nyjës së dorës. Vizitorët e pamësuar me këtë gjymtim nuk ia ndanin sytë; reagimi dhe mendimi që nuk guxonin ta formulonin ishte ky: "Nuk ka mundësi. Me këto duar nuk mund të pikturohen këto piktura; këtu ka mister!" Misteri ishte vetë Renuari. Një mister pasionant që në këtë veprën time mundohem, jo ta shpjegoj, por ta komentoj. Edhe po të shkruaja dhjetë, njëqind libra mbi misterin Renuar, nuk do të arrija ta shteroja këtë gjë.

Nga çasti që po flas për fizikun e Renuarit, më lejoni ta plotësoj menjëherë. Para se të paralizohet ishte i gjatë një metër e gjashtëdhjetë e gjashtë. Së fundi, po t'i duhej të ndreqej për t'u matur, duhej të ishte patjetër

## Zhan Renuar, i biri i piktorit të famshëm impresionist shkruan për babain e tij

# PIER OGYST RENUAR

Përgatiti Zija Vukaj



më i shkurtër, për shkak se kolona vertebrale i qe shkurtuar paksa. Flokët, dikur ngjyrë gështenje të çelur, ishin të bardhë, më tepër mbi zverk, ndërsa maja e kokës tashmë ishte krejt e shogët, por nuk i shihej sepse kishte marrë zakonin të mbante përherë kapelë në kokë, edhe në shtëpi. Kishte një hundë shqiponjë dhe energjike. Mjekra e tij e bardhë ishte shumë e bukur dhe e kuruar me kujdes nga njëri prej nesh; një palë e çuditshme i detyrohej faktit se i pëlqente të flinte me mbulesat e tërhequra shumë lart nën mjekër, i varej majtas.

Veshja zakonisht përbëhej nga një xhakëtë me grykë të mbyllur dhe pantallona të gjatë që i lodronin përreth këmbëve në ngjyrë gri me vija. Kravata *lavalier*, e kaltër me pika të bardha, ishte lidhur me kujdes rreth jakës së këmishës prej fanellate. Nëna ime i blinte kravatat në një dyqan anglez, sepse francezët kanë lejuar që pak nga pak e kaltra të shndërrohej në ngjyrë guri, "një ngjyrë e trishtë; dhe e bukura është se askush nuk e vë re, sepse njerëzit nuk kanë sy. Dyqanxhiu thotë: Është e kaltër, dhe ata besojnë." Në darkë, megjithëse në mes të verës, ai shtonte mbi supë një mantel. Vishte shapka prej feltri, të gjera e të larta, ngjyrë gri me kuadrate kafe, me mbyllje metalike. Kur ishte jashtë, mbrohej prej diellit nga një kapelë e lehtë prej cope të bardhë; në shtëpi i pëlqente të mbante një beretë cohe me anë të përkulshme, të atij tipi të lashtë që katalogët e dyqaneve paraqitnin në fillimin e shekullit me emrin "kapelë shoferi". Natyrisht, nuk kishte pamjen e një njeriu të kohës sonë; të sillte në mend një murg të Rilindjes italiane.

Një ditë Sezan po i ankohej babait për mendjemadhësinë e një borgjezi të pasur nga Provansa: jo vetëm ai individ kishte stolitur sallonin me një telajo të Besnard, "ai zjarrfikës

që vë zjarr", por ia lejonte vetes të këndonte pranë Sezan-it e të stononte. Renuari, i zbavitur, i kujtoi mikut se të gjithë të krishterët janë vëllezër. "Vëllai yt ka të drejtë ta dojë Besnardin madje edhe të stonojë. "A nuk do ta takosh në qiell" "Jo?", u përgjigj Sezan. Dhe mes seriozitetit e shakasë shtoi: "Në qiell e dinë shumë mirë se unë jam Sezani!" Nuk ngulmonte se ishte më superior se borgjezi i Provansës, por e dinte se ishte ndryshe "siç është lepuri i egër nga lepuri i butë!..." Dhe vazhdoi: "Nuk jam i zoti as t'i shpreh vëllimet siç duhet... Nuk jam agjë!..." Kjo përzjerje e lavdisë madhështore me përluljen jo më pak madhështore mund të shpjegoheshin vetëm tek Sezan. Gjashtëdhjetë vjeç, nuk kishte arritur ta njihnte ndonjëherë suksesin e madh të shitjeve; nuk ishte pritur asnjëherë në sallonin "Monsieur Bouguerau". Renuari, në fundin e ekzistencës së tij, aq sa kishte qenë i kritikuar, i nënçmuar, shpesh i sharë, kishte arritur të imponohej. Tregtarët e artit debatonin për veprat e tij; muzetë e mëdhenj të botës i kishin hapur dyert; të rinj nga të gjitha vendet, nga të gjitha racat shkonin në Cagnes me shpresën t'i afroheshin mjeshtrit për pak sekonda. Ai i pranonte këto nderime pa e ngritur kokën. Kur biseda që bëhej kthehej në lëndat për personin e tij, Renuari i vinte gjërat menjëherë në vendin e vet: "Unë gjeni? Çfarë budallallëku! Nuk pi opium, s'kam pasur kurrë sifiliz dhe nuk jam pederast! Atëherë?..."

(...) Renuari e njihte nevojën e qenësishme në botën moderne ta ndante punën mes specialistëve, por nuk e pranonte për vete. Dhemb këmba: thirret specialisti; dhemb dhëmbi? Shkohet tek dentisti. Të zë trishtimi? I rrëfesh një psikanalisti. Në fabrikë një punonjës shtrëngon vidat, një tjetër rregullon karburatorët; një fashatar kultivon mollë, vetëm mollë, ndërsa një tjetër mbjell grurë.



Auto portret nga Pierre-Auguste Renoir (1841-1919), rreth 1875, vaj në kanavacë

Rendimenti është shumë i mirë. Miliona karburatorë, kuintalë grurë. Mollat janë të mëdha si pjepra. Plotësohen me cilësi ushqyese, nuk kanë gjigantizëm për shkak të vitaminave që përftohën. Dhe gjithçka funksionon shumë mirë. Njerëzit hanë më shumë, shkojnë më shumë në kinema, dehen më shpesh. Jetëgjatësia e njeriut rritet dhe gratë lindin pa zor. Gjithë vepra e Renuarit, e mbushur me vitamina natyrale, është një thirrje proteste kundër këtij sistemi; edhe jeta e tij ashtu ishte.

Bota e Renuarit përbëhej nga një terësi. Ngjyra e lulekuqeve mbizotëron qëndrimin e gruas së re me ombrellë. E kaltra e qiellit mbështetet vëllazërisht mbi lëkurën e dashit që mbulon bariun. Pikturat e tij janë demonstrime të barazisë. Sfondet kanë të njëjtën rëndësi me planet e para. Nuk ka lule, fytyra, vende njëri pranë tjetrit, por një bashkësi elementësh që shkrihen, të ngjitur prej një dashurie më të fortë se dallimet e tyre. Kur mendojmë Renuarin, i kthehem gjithmonë kësaj. Në botën e tij shpirti çlirohet nga lënda, duke mos e mohuar, por duke e depërtuar. Lulja e blirit dhe bleta që dehet prej saj duke ndjekur të njëjtën rrymë që përshkon gjaku që qarkullon nën lëkurën e vajzës së ulur mbi bar. Është e njëjta rrymë e ndjekur edhe nga "tapa" e famshme, të cilën e njohim mirë. Bota është një. Ai bli, ato bletë, ajo vajzë, ajo dritë dhe Renuari bëjnë pjesë në të njëjtin çast. Dhe me to, oqeanet, qytetet, shqiponja mbi mal, një minator në minierë, Aline Charigot (modelja, pastaj gruaja e Renuarit) që i jep gji Pierrit të vogël. Çdo veprim i yni, çdo mendim i yni gjen jehonë në këtë terësi kompakte. Djegia e pyllit do të shkaktojë përmytjen. Druri i shndërruar në letër e pastaj në fjalë, do t'i çojë njerëzit drejt një lufte ose drejt njohjes së asaj që është e bukur dhe e madhe. Renuari besonte në ndodhinë e mandarinit kinez që, edhe pse gjendej mijëra kilometra larg vritej nga gjesti i vrasjes së pavetëdijshme të kryer në Paris. Pak para luftës së parë të 1914-ës, në një kafe të Montparnasit, dy emigrantë rusë shkëmbejnë idetë e tyre; në 1960 gjithë sistemi shoqëror, që edhe pse dukej i fortë, u tund nga rezultatet e bisedave të këtyre dy burrave. Nën Çezarët, shumë larg prej Romës, një agjitor i Galileës u dënua në kryq. Dhe kjo shënoi rënien e Perandorisë Romake, revolucionin universal, këngën gregoriane dhe katedralen e Shartres. Si mund të besohet që Renuari të refuzonte të ishte dëshmitar, më mirë, të merrte pjesë në një botë që ishte më e lidhur se brendësia e një veze? Të mund të mbyllte kanatet e dritares, të ngulej përballë një muri të zhveshur dhe të prodhonte gjithçka vetëm, të pikturave në të cilat çdo prekje ngjyre është saktësisht një pohim i një varësie të tillë. Fakti është se stomaku i tij ishte si i një struci. Gëlltiste gjithçka, subjektin, temperaturën, presionin atmosferik, ftohjen, ngërçin e këmbës, muskujt, barkun dhe kockat, urinë dhe më vonë dhimbjet. Gjithçka tek ai dhe jashtë tij, përfshirë mësimin e mjeshtërive të vjetër, kontribuonte për t'i dhënë një formë sekretit të tij e për ta ndarë me ata që donin ta shihnin pikturën e tij. Edhe inteligjenca e tij ishte pjesëmarrëse në gjithë këtë, përderisa ai nuk zinte besë dhe e vinte nën perceptimin shqisor. Përsa i përket kujtesës, ai e konsideronte një veti shumë të dëmshme.

Po ta zëmë se ekziston diçka absolute që përmbledh në vete atë çfarë ekziston, duhet të besojmë se kushti themelor i këtij entiteti është ekuilibri. Është ekuilibri i rrotullimit të një sateliti rreth planetit të panjohur dhe psherëtimës së kënaqësisë së dashur në një vajzë, mes therorisë së thertoreve dhe ca notave të Mozartit, mes shtegimit të lejlekëve dhe një



Pierre-Auguste Renoir, *La Grenouillère*, 1869.

veprimi të pastër matematik, mes zbërthimit të atomit dhe ekstazës së San Françeskut të Asizit. Disa njerëz të mëdhenj e kanë prekur gjendjen e ekuilibrit mes materies dhe shpirtit dhe i janë afruar pikës ku thellësia e njohjes së materies lejon t'i iket materies vetë, edhe pse jo krejt, në rast të kundërt, do të dalim nga humania. Do të përsërisim aventurën e Luciferrit. Këtë kanë tentuar ta bëjnë jo pak intelektualë, që kanë thyer kokën për të harruar që jemi bërë pak nga balta. Renuari thoshte se ka njerëz që preferojnë më shumë masturbimin se çiftëzimin. Të gjitha shkaqet e jashtme kombinoheshin tek ai për të vënë në lëvizje mekanizmin e krijimit; mes atyre shkaqeve duhen pranuar edhe preokupimet e karakterit teknik. I kthehem problemit të teorive të tij nga i cili jam larguar, për shkak të shmangieve, për të cilat nuk më dhemb; këto teori, baraz me tentativat e tij teknike, i shërbenin edhe si trampolinë. Kërkonte të arrinte përmes kontrasteve një tonalitet të së kuqes? Apo, duke i shpallur luftë të zezës së fildshit tregonte hijet me kobalt? Ajo hije e kaltër mbizotëronte kompozimin e pikturës së tij. Ai zgjidhte një pikë dominuese në fshat, sepse aty hijsa ishte e kaltër dhe mesazhi që në fund kjo pikturë drejton, nuk ka qenë lëvizja fillestare e veprës; mesazhi ishte pikërisht ajo e kaltër kobalti.

Për ta kuptuar më mirë procedimin artistik që ndodhte tek Renuari, po citoj një prej frazave të tij: "Nuk jam Zoti i gjithëpushtetshëm. Ka qenë ai që e ka krijuar botën, që mua më mjafton ta kopjoj" Dhe për ta saktësuar më mirë se në fakt nuk ishte fjala për ta kopjuar në kuptimin e ngushtë të fjalës, na tregonte anekdotën e piktorit grek Apel: në një konkurs në Akropol, një artist, rival i mjeshtrit athinas kishte paraqitur një pikturë që dukej se do t'ua kalonte të gjitha veprave të ekspozuara. Piktura paraqiste disa bistakë rrushi të imituar kaq mirë sa zogjtë, duke i marrë për të vërtetë, shkonin t'i çukitnin. Apel-i me një shikim që donte të thoshte: "Do të shihni tani!" paraqiti kryeveprën e tij. "Është fshehur pas kësaj perdeje të valëzuar." Gjykatësit morën të ngrinin perden, por më kot; ai ishte subjekti i pikturës.

Më vjen keq që nuk mund të dëgjoni të qeshurën me të cilën mbyllet kjo anekdotë. Ajo e këpucarit e argëtonte më pak. Edhe këtu heroi është Apel-i. Gjatë ekspozimeve mjeshtri fshihej pas pikturave të tij për të dëgjuar kritikën. Kur një këpucar vërejti se sandalja e njëres prej figurave nuk ishte e saktë, Apel-i u shfaq, falënderoi këpucarin dhe ndreqi gabimin. Të nesërmen, po ky këpucar gjykoj se këmba e së njëjtës figurë ishte e dobët. "Këpucar", i tha Apel-i, "rri te këpuca jote" Renuari shtonte se grekët me gjasë njihnin vetëm pikturën murale dhe atë të statujave dhe aspekti argëtues i atyre historive është se ishin shpikje të letrarëve. Përveç kësaj thoshte se ditën që piktorët të arrinin të jepnin iluzionin e një nënpylli, një blacë, përfshirë aty edhe myshkun dhe murmurimën e përroit,

nuk do të ishte më pikturë: në vend që të blinte pikturën, amatori do të shkonte të shëtiste në një nënpyll, blacë të vërtetë.

Pak më sipër përmenda dy emigrantët politikë rusë që patën folur me njëri tjetrin. Është fjala për Leninin dhe Trockin. Im atë nuk i njohu. Do të na fliste shpesh Gabrielle. Në fillim të 1914-ës ajo ishte martuar me Konrad Slade. Kishin ngrënë të dy te Rozalia në Montparnas, një lokal i frekuentuar nga Apolineri, Modigliani, Picaso, Braque, Zhan Marchand, Léger e shumë të tjerë. Sladët rrinin shpesh në të njëjtën tryezë me dy rusët. "Nuk flisnin shumë, kishin rroba të ngrëna, hanin pak dhe nuk pinin. Por dukej se ishin persona 'chic', sidomos biondi." Biondi ishte Lenini.

Pohimi im në lidhje me rëndësinë e fakteve të jashtme në pikturën e Renuarit shtrihet në të gjithë artistët e mëdhenj, përfshirë këtu Picasson-n, Breque apo Klee. Kjo shfaqet në kundërshtitë e dukshme me ngjarjen e Toulouse-Lautrec; unë nuk e besoj dhe ngul këmbë se incidenti i tij djaloshar ka pasur një pjesë të dytë, mbase jo krejt inekzistente në botën e të shprehurit të atij piktori. Trampolina e hedhjes së tij qe para së gjithash personaliteti i jashtëzakonshëm i modeleve të tij; atij personaliteti ai u shtonte natyrisht të vetin, në shkallën më të lartë, pastaj rimerre vërejtjet e tij duke i mbyllur në cikël dhe duke pohuar në mënyrë indirekte se kjo botë nuk është një bllok banesash borgjeze ku qiraxhinjtë e apartamenteve të ndryshme bëjnë sikur nuk njihen. Edhe pa telashet e ndodhura, do të gjente njësoj modelet e nevojshme të frymëzimit të tij. Do t'i gjente në kafe Tolosa apo në Moulin Rouge, ku dukej se e çonte fati i tij, "hiri" më shumë se deformimi i tij. Dua të them se, pa ato fytyra patetike do ta kishte pasur shumë më të vështirë ta gjente veten.

Për mendimin tim, kalimi nga beqaria në gjendjen e burrit të martuar, qe për Renuarin më e rëndësishme se teoritë. Ai burrë vazhdimisht në lëvizje, që s'dinte të rrinte kurrë, që kërcente mbi një tren me shpresën e vagullt t'i gëzohej dritës së mbytur të Guernsey apo të përhumbej në reflekset e kuqërreme të Blidas, kishte harruar, që kur kishte braktisur rrugën Gravijer, kuptimin e fjalës "vatër". Dhe ja tek gjendet befaz në një apartament së bashku me një grua; ngrënie në orë të caktuara, një shtrat i ndrequr me kujdes dhe çorape të rregulluara. Dhe të gjitha këtyre të mirave po u shtohet edhe ardhja e një djali. Ardhja e vëllait tim Pier do të paraqiste një revolucion të madh në ekzistencën e Renuarit. Teoritë e novelave athinase po tejkaloheshin nga një kukë e formuar prej një rrudhe në këmbën e vogël të foshnjës. Në vizatimin me rrëmbim të djalit dhe për t'i qëndruar besnik vetes, në nisjen e preokupimit të jashtëm për të përkthyer në pikturë atë lëkurë të kadifjetë të krijesës së sapolindur, Renuari po rindërtonte botën e tij të brendshme.

(Vijon nga faqja 19)

\*\*\*

\*\*\*

Gjithçka është më e rrezikshme se ç'mendon  
është koha e fundit  
që t'i shpesh fëmijët në vend të sigurt  
jashtë rrezeveprimit tënd  
duhet ta kesh mendjen fort  
duhet të jesh shumë e kujdesshme  
qenie të shfrenuara  
të fshihen  
në garderoba pas perdesh nën shtrat  
nën sqoll pas tapetash në shkallare  
në anën tjetër të gjumit  
-duhet të ruhesh fort  
të mos ua zbulosh emrin tënd!

S'do mend se ka fenomene të cilat  
as janë komerciale për treg  
as janë interesante në të tjera aspekte.

S'do mend se ka probleme të cilat  
as ua ngarkon dot të tjerëve as pretendon  
t'u kërkosh vëmendje.

S'do mend se ka një pikëllim  
që është aq i ndjerë  
sa të ngjall neveri.

\*\*\*

\*\*\*

ty që më thua Dashuri  
unë ta kthej Gënjeshtër  
ndonëse do të doja shumë  
të të mbese e brishtë në krahë  
por rrugët e mia po ikin tash gjithmonë  
larg prej poezive tua  
as unë s'po kam më vend për folklorin tënd  
brenda netve të mia

Duhet ta gjej veten para se të shkoj.  
Do të kem këpucë.  
Këpucë shetitjesh.  
Me sholla kauçuku.  
Them se do të quhet martirizim.

Më shiko tashti.

E shoh se po vi me thikë.  
E shoh se po vi me litar.  
Një herë do të shkrehet kjo armë.  
Kam llaforur për të pesë dekada.  
E do të marrë një gjysëm sekondi.

Pse më shikoni tashti?

Dashuria s'është përgjithmonë.  
Vdekja, ndërkaq.  
Vdekja, ndërkaq, është e përjetshme.

Lamtumirë, qofshi mirë!

\*\*\*

\*\*\*

Tashti që të Dashuroarit  
kanë lënë shtëpinë  
një nga një  
tashti fëmijët  
janë ngjitur nëpër pemë  
dhe janë bërë të sjellshëm  
tashti gjithçka është e këndshme  
nën qiell  
në igloon e babait  
koleg i dashur  
tashti që lamë rrobat  
një nga një  
i kemi adresuar letrat e dashurisë  
dhe jemi shtrirë  
një nga një  
me duart mbi mbulesë

Tashti po flej  
në një qytet shumë të bukur  
shumë të lashtë.  
Tashti po flej  
për herë të parë  
me duar të mbërthyer.  
E dikush që s'e njoh  
më ka hequr flokët  
nga fytyra.  
Tashti s'jam më  
goca e askujt.  
Ndaj tash s'kam më pse  
të ndihem e braktisur.  
Kur njeriu të vdesë  
ka vdekur përnjëmend  
e s'i ha më palla sa keq ndihej  
ndërsa endej nëpër botë  
e dukej si e marrë.

\*\*\*

\*\*\*

Vdekja e ka  
një veti të habitshme  
që kujdeset për të vegjlit e vet  
ua ha ushqimin  
e ua tremb shokët  
e kur ata ankohen ajo e shpërfaq  
dorën e vet të ftohtë  
dhe ua shkruan  
emrin e vet të ftohtë  
mbi buzë që u ngelin përherë  
të paputhura

(poezi e lënë amanet për në varrim)

Mbi të vetmuar e të dashur  
po i njëjti ligj sundon:  
do të ndahemi nga vetja  
një ditë të bukur si rëndom  
kur I Panjohuri të vijë  
afshin nga sytë të na fshijë  
e t'u mëshojë vizë me harresë  
skenave me mua e ty.  
Por ai s'ma heq këtë gëzim  
që më vjen nga ti, përsëri,  
teksa hyj në atë errësim  
ku këndoj për mikun tim  
ia them natës anekënd  
të bukurin, të fortin emrin tënd  
e ky malli im lubi  
bëhet fëmi' në krahun tënd.

\*\*\*

Vdekja e ka një veti të habitshme  
që të ulet befaz në divan nga IKEA  
e të duket si çlirim  
kur janë mbyllur të gjitha shitoret  
edhe vajza ime e vogël do të jetonte më mirë  
te një amvise e urtë  
jashtë katundit Mankarbo

Shpeshherë revolucioni apo risia përkufizohen gjerësisht si gjetje apo ndodhi të bujshme të cilat si me ceremoni globale ndryshojnë botën dhe njerëzimin, por historia na mëson se e vërteta qëndron ndryshe. Revolucioni dhe risia nisin me perceptimin. Zbulimi i një qasjeje të re ndaj kornizimit mendor kolektiv. Rilindja revolucionoi botën me zbulimin e perspektivës (thënë fare thjeshtë: pema që është më afër duket më e madhe se ajo që ndodhet larg, apo rruga duket më e gjerë kur e shohim nga afër ndërkohë që shfaqet thjesht një pikë kur është larg.) Isak Njutoni zbuloi gravitetin. Forca e gravitetit ka ekzistuar gjithmonë por iu desh rënia e një molle nga pema që t'ia ndriçonte mendjen e shkenca të mos ishte me e njëjtë. Kështu edhe me ndarjen e atomit apo me teorinë e relativitetit, e shumë të tjera.

Në vitet e fundit të regjimit diktatorial komunist në Shqipëri, në vitin 1986, Gazmend Leka, me bojë e penë, shpërtheu kornizimin skllavëror të injektuar prej gjysmë shekulli, përmes ilustrimeve të tij të "Tregime të moçme shqiptare" të Mitrush Kutelit. Aq i fuqishëm ish ai shpërthim konjitiv sa shumë e shumë shqiptarë nga brezi i asaj periudhe, përfshirë edhe mua, u formësuan më të çliruar, më të ethshëm për të përtejmen metafizike, më krijues, më kërkues dhe mbi të gjitha më të lirë, edhe pse të rrethuar me gjergje fizike, artistike dhe politike. Shumë e shumë intelektualë, artistë e mendimtarë të sotëm, janë kultivim i atij universi të pashtershëm të ilustrimeve të Gazmend Lekës, që jo vetëm përmbushi e pajtoi mrekullueshëm penën e Kutelit, por solli një dimension të ri nga përbrenda individit. Leka u bë pikënisja e një çlirimi të brendshëm kombëtar duke thyer vargonjtë mendorë që do shoqërohej më pas me lirinë fizike përmes rrëzimit të regjimit.

Në traditën e ilustrimit të librave folklorikë shqiptarë, imazhi ka shërbyer

## Gazmend Leka, revolucioni dhe universi i pashtershëm i ilustrimeve të "Tregime të moçme shqiptare"

*Dr. Bledar Kurti*

zakonisht si shoqërues narrativ i tekstit, duke riprodhuar skena, personazhe dhe episode sipas një logjike përshkruese. Kjo qasje, edhe kur ka qenë estetikisht e suksesshme, ka mbetur e lidhur me idenë e ilustrimit si pasqyrim. Ilustrimet e Gazmend Lekës për "Tregime të moçme shqiptare" shënuan dhe vazhdojnë të përfaqësojnë një kthesë të qartë nga kjo traditë: këtu ilustrimi nuk pasqyron rrëfimin, por e problematizon atë.

Në një periudhë kur librat e artit ishin privim për shqiptarët, Leka integroi perspektivën atmosferike të Botiçelit. Shihni kokën, duart dhe këmbët e vogla të figurave, të cilat me masat e mëdha apo të tejzgjatura trupore, shfaqen madhështore, ndërkohë edhe pse rrëzojnë rregullat epokale të porpacionit trupor, artistikisht paraqiten fuqishëm dhe kanë zë kushtrimi. Ilustrimet janë teatrale, ftuese në veprim, dramatike, me pozicionim natyral e jo të stisur pors kompozimet e Karavaxhos. Kuajt me kalorësit në fluturim thyjnë rregullat e

normales e përthithin të pandërgjegjshmen brenda një realiteti përrallor. Kontrasti i ekzagjeruar mjeshhtërisht i masës midis heroit dhe një shkëmbi apo sfondi të sfumuar integron si Velaskes ashtu edhe Zhak Lui David. Figurat që shpërthejnë nga pikat këndore të poshtme shpalosin atributet e El Grekos. Ndërkohë gjarpërinjtë apo përbindëshat qasin pëmes një koncepti të ri veprën skulpturore antike "Laokondi dhe bijtë e tij". E dukshëm kemi edhe një "La Pietà", te ilustrimi "Rina dhe Radhavan".

Te të gjitha ilustrimet e Lekës janë të mishëruara misteret dhe risitë e artit të kulluar. Shikojini me kujdes e do kuptoni që herë do gjendeni një obzervues i shtrirë përtokë si te "Skënderbeu dhe Ballabani" apo "Turku rrëmbeu një arbëre", herë në anën këndore si te "Vasha e bukur dhe trimi i ushtrisë së Skënderbeut", herë i ulur në lozhën e një teatri, si te "Shega dhe Vllastari" e herë një vojer i fshehur nga terri i natën mbi një kodrinë si te ilustrimi "Ajkuna qan Omerin." Ilustrimet pluskojnë në kohë

të pakoha e po ashtu pluskon edhe shikuesi nga njëra skenë te tjetra. Udhëtim mrekullor skenik, dhimbshor, guximtar, dramatik, e padyshim besnor.

Pavarësisht elementëve epokalë të trashëguar nga kolosët e artit botëror, të cilët kanë ndërtuar qenien e çdo artisti apo krijuesi, Leka transmeton notat shqiptare, të moçmen e traditave dhe sentimentin tonë kombëtar, duke i bërë këto ilustrime të pakrahasueshme e të patjetersueshme.

Gjithashtu, te ilustrimet bie në sy një zgjedhje themelore estetike: figura njerëzore nuk është kurrë e vendosur në një hapësirë neutrale. Ajo është gjithmonë e rrethuar, e kërcënuar ose e mbingarkuar nga forca që e tejkalojnë. Te ilustrimi "Rozafati" figura femërore shfaqet e rrëzuar, e shtrirë në një pozicion të brishtë, ndërsa mbi të ngrihen masa trupash gjigantë, pothuajse pa identitet individual. Këta trupa duket sikur nuk janë personazhe konkretë, por mishërime të peshës kolektive, të fatit apo të dhunës mitike. Kompozimi vertikal



e shtyp figurën poshtë, duke krijuar një ndjenjë të fortë nënshtrimi ekzistencial. Këtu Leka ilustron një gjendje themelore të mitit: pafuqinë e njeriut përballë forcave që nuk i kontrollojnë. Pafuqinë, edhe pse të vullnetshme, të pikëmbërritjes së misionit njerëzor apo heroik.

Në ilustrimin “E bija e hënës dhe e diellit” heroi përballë me krijesa gjarpërore dhe hibride, dinamika vizuale ndërtohet mbi rrethimin. Trupat e gjarpërinjve formojnë një hapësirë mbyllëse, pothuajse klaustrofobike, brenda së cilës figura njerëzore mbetet e vogël, por jo e zhdukur. Heroi mban armën dhe mburojën, por qëndrimi i tij nuk është triumfues; është i tensionuar, i vetëdijshëm për disproporcionin mes vetes dhe së keqes që përfaqësojnë këto krijesa. Këtu risia e Lekës qëndron në faktin se miti nuk paraqitet si histori heroizmi linear, por si përballje e vazhdueshme me të panjohurën dhe me frikën.



Në këto ilustrime ka figura që lëvizin diagonalisht, duke thyer ekuilibrin e faqes dhe duke krijuar ndjesinë e një tranzicioni midis botëve. Këto nuk janë thjesht skena fantastike, por metaforë vizuale e kalimit nga e përditshmja në mitike, nga e njohura në të panjohurën. Leka përdor vijën dhe dritëhijen për të ndërtuar një hapësirë mendore, jo një realitet të besueshëm fizik.

Në ilustrimet ku shfaqen figura femërore të ndriçuara, shpesh të rrethuara nga aureola drite ose nga elemente rituale, vërehet një tjetër aspekt thelbësor i qasjes së Lekës: ambiguiteti. Këto figura nuk janë thjesht të shenjta apo të rrezikshme; ato qëndrojnë në kufi. Një fytyrë femërore e ndriçuar mbi një skenë dhune ose rënieje nuk ofron shpëtim të qartë, por vëzhgon, gjykon, ose thjesht ekziston si prani metafizike. Ky pozicion i paqartë i figurës femërore e çliron mitin nga leximi moralist dhe e zhvendos drejt një përvoje ekzistenciale.

Gazmend Leka nuk është zburues i “Tregime të moçme shqiptare”; ai i vuri në provë rrëfenjat. Ai i lexoi mitet tona me një sy bashkëkohor, por pa i çmitizuar, pa i ironizuar, pa i reduktuar në folklor dekorativ, por duke krijuar një marrëdhënie mes tekstit dhe ilustrimit në këtë libër përmes një raporti barazie. Imazhi nuk i nënshtrohet fjalës, as fjala imazhit. Ato ecin paralelisht, duke ndërtuar një përvojë estetike komplekse, ku lexuesi është i detyruar të ndalet, të vështrojë, të mendojë. E mbi të gjitha të udhëtojë në kohë e në dimensione. Kjo është ndoshta arritja më e madhe e Gazmend Lekës: krijimi i një koncepti të ri për ilustrimin në artin shqiptar, si hapësirë reflektimi dhe jo si instrument shpjegimi. E përmes kompozimit inovativ për artin shqiptar të kohës, kur figurat ishin ideologjike, statike dhe të pajeta, Leka solli një revolucion mendimi dhe perceptimi.

Në një kohë kur trashëgimia kulturore shpesh trajtohet ose me patetizëm, ose me thjeshtim banal, ilustrimet e Gazmend Lekës për “Tregime të moçme shqiptare” mbeten një alternativë serioze dhe e guximshme. Ato tregojnë se tradita nuk ruhet duke u imituar, por duke u rimenduar. Dhe pikërisht në këtë rimendim qëndron mrekullia e tyre.

Vepra “Tregime të moçme shqiptare” është ribotuar me vëllime të reja e së fundmi është botuar edhe në spanjisht. Por teksa tashmë lexuesit do njihen me tekstin e mrekullueshëm të Kutelit në gjuhë të huaj, ilustrimet e Gazmend Lekës flasin me një gjuhë universale që komunikon me çdo qytetar të botës, në çdo vendndodhje të globit, e në çdo kohë. Kjo është forca e artit të kulluar dhe transformues. Kjo e bën Gazmend Lekën një prej artistëve më me ndikim rrënjësor në të gjithë historinë e artit shqiptar.





**alblibris**  
Powered by Onufri

tashmë në

# KANADA



Libri shqip  
në shtëpinë tuaj!

**Porosisni tani**

[www.alblibris.al](http://www.alblibris.al)



Transport  
falas mbi  
USD 150

